



BULETINI ZYRTAR

NR.8, 2012

TIRANË, 2013

Buletini Zyrtar Nr.7, 2012

Përgatitur nga:
Autoriteti i Konkurrencës

Përpunimi grafik dhe printimi:
Erald Lamja
(Vignette Marketing Agency)

Botuar nga:
Autoriteti i Konkurrencës, 2013

Përmbajtja

- Fq.7 Vendimi Nr. 212, Datë 24.01.2012, Për “Një ndryshim në Vendimin Nr. 204, datë 14.11.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”
- Fq.9 Vendimi Nr 213, Datë 24.01.2012, Mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar ndërmjet shoqërive Euronuovo Sh.p.k dhe Euroteorema Sh.p.k me qëllim përfitim të kontrollit të shoqërisë Euro Investment Group Sh.p.k”
- Fq.13 Vendimi Nr 214, Datë 24.01.2012, Mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë BET-07 Sh.a”
- Fq.16 Vendimi Nr 215, Datë 10.02.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (TPL)”
- Fq.19 Vendimi Nr. 216, Datë 01.03.2012, Për “Vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes “INTERSIG” SHA”, për pengim të inspektimit”
- Fq.22 Vendimi Nr. 217, Datë 21.02.2012, Për miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2011 dhe synimet kryesore për vitin 2012”
- Fq.23 Vendimi Nr. 218, Datë 23.02.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës”
- Fq.25 Vendimi Nr. 219, Datë 16.03.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”
- Fq.28 Vendimi Nr. 220, Date 16.03.2012, “Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike”
- Fq.31 Vendimi Nr. 221, Datë 11.04.2012, “Për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes “Romano Port” SHA në tregun e ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare”
- Fq.46 Vendimi Nr. 222, Datë 11.04.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL)”
- Fq.50 Vendimi Nr. 223, Datë 11.04.2012, “Për përcaktimin e hapave të kryerjes së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj paleve të treta (TPL)
- Fq.52 Vendimi Nr. 224, Datë 09.05.2012, “Për zgjedhjen e Zëvendeskryetarit të Komisionit të Konkurrencës”

- Fq.53 Vendimi Nr. 225, Datë 28.05.2012, “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive të tregut sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për shërbimin e “Policës Kufitare të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”
- Fq.60 Vendimi Nr. 226, Datë 08.06.2012, “Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA për revokimin e vendimit nr. 222, datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës”
- Fq.62 Vendimi Nr. 227, Datë 28.06.2012, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të 100 % të kapitalit themeltar nga shoqëria Audi Aktiengesellschaft tek shoqëria Ducati Motor Holdings S.p.A”
- Fq.66 Vendimi Nr. 228, Datë 28.06.2012, “Mbi autorizimin e përqendrimit e realizuar nëpërmjet përthithjes së shoqërive Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a nga shoqëria Geci Sh.p.k”
- Fq.70 Vendimi Nr. 229, Datë 03.07.2012, Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë “Geci” shpk për njoftimin jashtë afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përthithjes së shoqërive Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a
- Fq.73 Vendimi Nr. 230, Datë 05.07.2012, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”
- Fq.78 Vendimi Nr. 231, Datë 05.07.2012, “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”
- Fq.83 Vendimi Nr. 232, Datë 16.07.2012, Për një ndryshim në vendimin Nr. 218, datë 23. 02 .2012 “Mbi hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës”
- Fq.85 Vendimi Nr. 233, Datë 16.07.2012, “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”
- Fq.87 Vendimi Nr. 234, Datë 19.07.2012, Mbi miratimin e Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”
- Fq.89 Vendimi Nr. 235, Datë 19.07.2012, Mbi miratimin e Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike”
- Fq.91 Vendimi Nr. 236, Datë 19.07. 2012, Për miratimin e Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”
- Fq.93 Vendimi Nr. 237, Datë 26.07.2012, “Mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet dy transaksioneve sipas të cilave shoqëritë Ost Holding GmbH dhe Media Holding Beteiligungs AG i japin kontrollin e plotë mbi shoqërinë Media Vizion”
- Fq.97 Vendimi Nr. 238, Datë 26.07.2012, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të plotë të kontrollit në shoqërinë V.D.M Invest

Comm. VA, nëpërmjet blerjes së 99.99% të aksioneve nga shoqëria Japan Tobacco International Holding B.V.”

- Fq.101 Vendimi Nr. 239, Datë 26.07.2012, Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë “Media Vizion” për njoftimin jashtë afatit të përqendrimit të realizuar
- Fq.104 Vendimi Nr. 240, Datë 26.07.2012, Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Nazëri – 2000” Sh.p.k, dhe “Dea Security” Sh.p.k për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike
- Fq.115 Vendimi Nr. 241, Datë 03.08.2012, Për një shtese në VKK Nr.225, datë 28.05.2012 mbi “Përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive në tregun e sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për shërbimin e “Policës Kufitare të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”
- Fq.117 Vendimi Nr.242, Datë 03.09.2012, “Për disa ndryshime në rregulloren e caktimit të shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”
- Fq.119 Vendimi Nr. 243, Datë 11.09.2012, “Për dhënien e disa rekomandimeve për rritjen e konkurrencës në prokurimet publike”
- Fq.123 Vendimi Nr. 244, Datë 20.09.2012, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfuturit 100 % nga shoqëria Ferreri International S.A të Business NAT dhe të 49% të Bussines SL (të zotëruara nga Grupi Stelliferi)”
- Fq.127 Vendimi Nr. 245, Datë 02.10.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”
- Fq.130 Vendimi Nr. 246, Datë 09.10.2012, “Mbyllja e hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL) dhe vendosje gjobe për kufizim të konkurrencës ndaj ndërmarrjeve “Sigal Uniqa Group Austria Sha (Sigal)”, “Sigma Vienna Insurance Group Sha (Sigma)”, “Atlantik Sha”, “Intersig Vienna Insurance Group Sha (Intersig)”, “Interalbanian Sha”, “Alb - Siguracion Sha (Albsig)”, “Instituti i Sigurimeve Sha (Insig)” dhe “Eurosig Sha”.”
- Fq.140 Vendimi Nr. 247, Datë 09.10.2012, “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL)”
- Fq.144 Vendimi Nr. 248, Datë 11.10.2012, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës”
- Fq.151 Vendimi Nr. 249, Datë 09.11.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit”
- Fq.158 Vendimi Nr. 250, Datë 20.11.2012, “Mbi hapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit si rezultat i transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë Viloil Sh.a, nga shoqëria City Investment Holding S.A, tek aksioneret z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”

- Fq.160 Vendimi Nr. 251, Datë 20.11.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës”
- Fq.163 Vendimi Nr. 252, Datë 26.11.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve, në qytetin e Tiranës”
- Fq.165 Vendimi Nr. 253, Datë 03.12.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të paketuar”
- Fq.168 Vendimi Nr. 254, Datë 06.12.2012, “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta”
- Fq.171 Vendimi Nr. 255, Datë 11.12.2012, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit (75% të aksioneve) të Eurobank Ergasias S.A nga National Bank of Greece S.A”
- Fq.175 Vendimi Nr. 256, Datë 11.12.2012, “Për disa rekomandime ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimeve”
- Fq.179 Vendimi Nr. 257, Datë 13.12.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës, ndaj ndërmarrjeve: “Alben 2 Security”, “E-Security”, “Vaso Security”, “Security Vaso”, “Ernisa S”, “Nisa Security”, “Hoxha”, “Korça Security” dhe “Hoxha Security”
- Fq.182 Vendimi Nr. 258, Datë 21.12.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”
- Fq.184 Vendimi Nr. 259, Datë 27.12.2012, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të vetëm të Emporiki Bank of Greece S.A nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit nga Credit Agricole S.A. tek Alpha Bank S.A.”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 212, datë 24.01. 2012

Për “Një ndryshim në Vendimin Nr. 204, datë 14.11.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.01.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shtyrja e afatit në lidhje me hetimin paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d); neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);

Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

Komisioni i Konkurrencës, pasi mori në shqyrtim informacionin dhe kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm për një shtyrje afati në lidhje me hetimin paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë,

VËREN SE:

1. Me anë të Vendimit Nr. 204, Datë 14. 11.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë.

2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.
3. Grupi i punës në ushtrim të detyrave të tij dhe me qëllim mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, ka kërkuar të dhëna dhe informacione nga ndërmarrje që operojnë në tregun objekt hetimi.
4. Për arsye objektive, disa prej këtyre ndërmarrjeve kanë kërkuar shtyrjen e afatit për sjelljen e të dhënave dhe informacionit të kërkuar në mënyrë të plotë sipas kërkesave të grupit të punës duke bërë të pamundur përpunimin e tyre brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 204 pika III.
5. Sigurimi i një informacioni të plotë dhe të saktë është i domosdoshëm për të siguruar një vendim-marrje objektive të Komisionit të Konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 204, Datë 14. 11.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë, pika II ndryshohet si vijon:

“III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 15.03. 2012”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr 213, datë 24.01.2012

**Mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar ndërmjet shoqërive
Euronuovo Sh.p.k dhe Euroteorema Sh.p.k me qëllim përfitim të kontrollit
të shoqërisë Euro Investment Group Sh.p.k”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|---|---------------------|---------|
| • | Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • | Servete Gruda | Anëtar |
| • | Koço Broka | Anëtar |
| • | Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 24.01.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar ndërmjet shoqërive Euronuovo Sh.p.k dhe Euroteorema Sh.p.k me qëllim përfitim të kontrollit të shoqërisë Euro Investment Group Sh.p.k. Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, 13 dhe neni 15, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit ” dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Euronuovo Sh.p.k dhe Euro Investment Group Sh.p.k dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet me anë të ‘Kontratë Shitje Kuotash’ të datës 26 Tetor 2011, ndërmjet shoqërive Euroteorema Group Sh.p.k dhe Euronuovo Sh.p.k me qëllim transferimin e të gjitha kuotave të shoqërisë target (Euro Investment Group Sh.p.k) nga Euroteorema

Group Sh.p.k tek Euronuovo Sh.p.k.

Shoqëria blerëse Euronuovo Sh.p.k nëpërmjet përfutimit 100% të kuotave në shoqërinë target Euro Investment Group Sh.p.k do të përftojë kontrollin direkt dhe të vetëm në këtë të fundit.

Transaksioni realizohet në formën e përfutimit të plotë të kontrollit i cili në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (Ligji) është përqendrim.

Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1) si dhe është njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në të (neni 12/2).

2. Palët në transaksion

- Euronuovo Sh.p.k në cilësinë e Blerësit është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në Komuna Kashar, Fushë Mëzez, Tiranë. Objekti i shoqërisë është import – eksport me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme ku përfshihen mallra ushqimore.

Blerësi nuk ka pjesëmarrje në shoqëri të tjera.

- Euroteorema Sh.p.k, në cilësinë e Shitësit është një shoqëri që vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar me seli në Tiranë. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është kryerja e punimeve ndërtimore .
- Euro Investment Group Sh.p.k në cilësinë e shoqërisë target me seli në adresën: Kashar, Tiranë . Objekti i saj është ushtrimi i ndërmarrjes ndërtuese për llogari të saj, ose të enteve publike ose shoqëri private.

Shoqëria target është nuk ka ushtruar asnjë aktivitet..

3. Xhiro për vitin 2010

- Xhiro totale në tregun e brendshëm: është rreth XXX miliard Lekë
 - Euronuovo Sh.p.k : XXXX Lekë
 - Euro Investment Group Sha: XXX Lekë
 - Euro Teorema Group : XXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

4. Tregu Përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- 1) tregu i produktit, dhe
- 2) tregu gjeografik.

I Tregu i produktit:

Euro Investment Group Shpk – Objekti i aktivitetit të shoqërisë është ushtrimi i ndërmarrjes ndërtuese, për më tepër duke marrë nga ente publike dhe private, sipërmarrje në koncensione punësh ndërtimore, rrugore, hekurudhore, hidraulike, elektrike, elektronike, të ngrohjes, kondicionimit, dekoracionit, bonifikimit për ndërtime urash tunelesh, vepra në beton etj.

Euronuovo Sh.p.k - Ushtron veprimtari në importimin dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme ushqimore dhe pijeve të quajtur ndryshe dhe fcmg (fast moving consumers goods) .

Euroteorema Group Sh.p.k – Vepron në sektorin e punimeve ndërtimore, rrugore, hekurudhore, hidraulike, elektrike, elektronike të ngrohjes, të kondicionimit, hidrosanitare, dekoracionit, ndërtime urash etj si dhe në sektorin e pasurive të paluajtshme.

II Tregu gjeografik

Tregu gjeografik: Tregu gjeografik për shërbimet e ndërtimit është Tregu i Brendshëm.

Në rastin në fjalë, përcaktimi i tregut përkatës së produktit apo përcaktimi i tregut gjeografik mund të lihet i hapur duke qenë se transaksioni në fjalë nuk çon në asnjë treg të prekur pavarësisht përkufizimit të përdorur.

Tregje të prekura; Palët në përqendrim veprojnë në tregje të ndryshme produkti. Në bazë të përkufizimit të tregjeve të prekura sipas seksionit 6(III) të “Formularit të Njoftimit të Përqendrimit”, nuk ka tregje të prekura nga përqendrimi i njoftuar

5. Konkurrentët në tregun e ndërtimit.

Sektori i ndërtimit, gjatë vitit 2010, ka zënë rreth 11 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Në këtë treg ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 1920 shoqëri (përfshirë këtu segmentet të tregut si : (i) ndërtimi i ndërtesave të banimit duke mbuluar blloqe banesash/apartamentesh, (ii) ndërtimin e ndërtesave jo rezidenciale (si psh. ndërtesa industriale, zyra, qendra tregtare dhe spitale) (iii) ndërtimin e infrastrukturës/ inxhinierisë civile (si psh rrugë, ura, hekurudha, sisteme kanalizimesh etj).

6. Struktura e tregut të ndërtimit pas përqendrimit

Ky transaksion nuk ndryshon strukturën e tregut të ndërtimit në Shqipëri si dhe nuk do të ketë efekte për konkurrencën në tregun e brendshëm, sepse nuk ka treg të prekur. Dy shoqëritë pjesë të këtij transaksioni operojnë në tregje të ndryshme të produktit. Aktivitetet ekonomike të palëve nuk mbivendosen as në nivel kombëtar apo nivel lokal. Transaksioni nuk ndryshon dhe nuk ndikon në përqindjen e pjesës tregut që zotëron Euro Investment Group dhe Euronuovo në Shqipëri. Për më tepër, shoqëria target e këtij transaksioni nuk ka patur aktivitet ekonomik që prej datës së regjistrimit të saj.

7. Konkluzione

Përqendrimi i referohet rastit të ndryshimit të qëndrueshëm të kontrollit në një shoqëri me aktivitet kryesor në tregun e ndërtimit dhe mes palëve të përfshira në transaksion nuk ka tregje të prekura pasi veprojnë në tregje krejtësisht të ndryshme të produktit.

Përqendrimi nuk pritet të sjellë ndryshim në strukturën e tregut pasi vjen si pasojë e një ndryshimi kontrolli dhe palët nuk kanë tregje të përbashkëta dhe për këtë arsye nuk krijon apo forcon pozitë dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqendrim.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese për shkak të përqendrimit ndërmjet shoqërive Euronuovo Sh.p.k dhe Euro Investment Group Sh.p.k.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar ndërmjet shoqërive ndërmjet shoqërive Euronuovo Sh.p.k dhe Euroteorema Sh.p.k me qëllim përfitim të kontrollit të shoqërisë Euro Investment Group Sh.p.k.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit, pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr 214, datë 24.01.2012

**Mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së
100% të aksioneve të shoqërisë BET-07 Sh.a”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.01.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë BET-07 Sh.a nga personi fizik z. Glendi Abdi. Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, 13 dhe neni 15, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit ” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit BET-07 Sh.a – Z. Genci Abdi dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të ‘Kontratës për Shit-blerjen e Aksioneve’ e lidhur më datë 7 Dhjetor 2011, ndërmjet palëve z. Glendi Abdi (Blerësi) dhe z. Gertian Sula, z. Drini Skënderi, z. Albert Leka z. Artan Gaçaj dhe z. Leonidas Sampanis (të cilët veprojnë

sëbashku si shitësit) me qëllim përftimin e kontrollit të BET-07 nga aksioneri i ri dhe i vetëm z. Glendi Abdi. Transaksioni përfshin blerjen 100% të aksioneve të shoqërisë target dhe si pasojë edhe kontrollin dhe menaxhimin e saj.

Përqendrimi shfaqet si një përftim kontrolli në formën e zëvendësimit të pronësisë nëpërmjet blerjes së tërësisë së aksioneve të shoqërisë target BET-07 Sh.a.

Transaksioni realizohet në formën e përftimit të plotë të kontrollit i cili në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (Ligji) është përqendrim.

Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1) si dhe është njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në të (neni 12/2).

2. Palët në transaksion

- Personi fizik z. Glendi Abdi, në cilësinë e blerësit, nuk zotëron asnjë aktivitet ekonomik dhe nuk është pjesëmarrës si ortak apo aksioner në asnjë ndërmarrje tregtare.
- BET -07 Sh.a, në cilësinë e shitësit, është një shoqëri e cila është themeluar dhe funksionon në bazë të Ligji nr. 10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” i ndryshuar, me seli në adresën: Rr. Gjin Bue Shpata, 3/2, Tiranë. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në fushën e lojërave të fatit-baste sportive.

3. Xhiro për vitin 2010

- Xhiro totale në tregun e brendshëm: është XXXX Lekë
 - BET 07 Sha XXXX Lekë

Shoqëria, objekt i këtij transaksioni plotëson kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 shkronja b) të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe si rrjedhojë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

4. Tregu Përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

4.1.a. Tregu i produktit:

- BET 07 SHA ushtron veprimtarinë e saj në një treg mjaft specifik sic është ai i lojërave të fatit – basteve sportive. Shoqëria ofron shërbimin e lojërave të fatit – basteve sportive. Këto shërbime iu ofrohen konsumatorëve sipas koeficientëve të përcaktuar paraprakisht dhe ky konsiderohet produkt i saj.

Bazuar sa më sipër si dhe në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet për përqendrimet: Treg përkatës të produktit do të konsiderojmë ofrimin e shërbimit të lojërave të fatit – basteve sportive.

4.1.b. Tregu gjeografik

Shoqëria BET 07 SHA ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet 155 pikave të shitjes të shtrira në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shoqëria nuk operon në tregun ndërkombëtar për shkak të barrierave hyrëse dhe mungesës së një plan biznesi për shtrirje në tregun e huaj.

5. Struktura e tregut para dhe pas përqendrimit

Vlerësimi madhësisë së tregut, i pasqyruar dhe në tabelën e mëposhtme është bazuar në të dhënat mbi xhiron e realizuar nga shoqëritë e basteve sportive për vitin 2010. Në këtë treg operojnë 12 shoqëri të licensuara ku tre konkurrentët më të mëdhenj me pjesë tregu mbi 14% janë Top Start me 25.65% të tregut, Bet 07 me 22.45% të tregut dhe Lotto Sport me 14.72%.

Hyrja në këtë treg rregullohet nëpërmjet ligjit Nr.10033, datë 11.12.2008 “PËR LOJËRAT E FATIT”, i ndryshuar dhe realizohet me miratimet paraprake të institucioneve shtetërore kompetente. Tregu është i hapur për konkurrencë. Barrierat e hyrjes në treg përbëhen nga marrja e licencës sipas një procedure gare në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj si dhe pagesën vjetore për ushtirimin e veprimtarisë për baste sportive, 2 000 000 (dy milionë) lekë pranë organit tatimor, ku është regjistruar shoqëria.

Transaksioni i realizuar konsiston në ndryshimin e strukturës së aksionerëve të shoqërisë BET 07 dhe nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut të produktit. Fuqia në treg e shoqërisë objekt i transaksionit si dhe konkurrentëve të saj nuk do të ndryshojë. Për pasojë, transaksioni nuk do të ketë efekte negative mbi konkurrencën dhe konkurrentët në Shqipëri.

Pas realizimit të përqendrimit pjesa e tregut e shoqërisë BET 07 nuk ndryshon, si rrjedhojë përqendrimi i tregut mbetet i njëjtë dhe nuk kemi krijim ose forcim të pozitës dominuese në tregun përkatës.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese për shkak të përqendrimit në shoqërinë BET-07 Sh.a.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë BET-07 Sh.a nga personi fizik z. Glendi Abdi.

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr 215, datë 10.02.2012

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (TPL)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.02.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapja e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (TPL), për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d); 26; 28, shkronja b); neni 4, pika 1; dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar)

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (TPL);

VËREN SE:

1. Nisur nga një artikull në gazetën Panorama të datës 09/02/2012 me titull “Nga 1 Shkurti dyfishohet tarifa e sigurimit të makinave”, si edhe në informacione të tjera dhënë në median televizive, sipas të cilave nga data 1 Shkurt 2012 midis operatorëve në tregun e sigurimeve është rënë dakord për të rritur çmimet e sigurimit të mjeteve

motorrike, më datë 09.02.2012, Inspektorët e Drejtorisë së Mbikqyrjes dhe Hetimit të Tregut realizuan një monitorim të çmimeve duke realizuar kontakte me agjentët e shitjeve në këtë treg.

2. Nga monitorimi rezulton se kompanitë e sigurimit, aplikojnë çmime të njëjta për primet e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta që prej datës 1 Shkurt 2012 sipas tabelës si vijon:

Kategoria	Kapaciteti motorik, pesha ose numri i vendeve	Totali, lek
Motocikleta	Kapaciteti Motorik	
	Deri në 150 cm ³	4.100
	Mbi 150 cm ³	7,000
Autovetura	Kapaciteti Motorik	
	Deri në 1600 cm ³	14 000
	Mbi 1 600 cm ³	14.600
Furgona, mikrobuzë	Nr i Vendeve	
	Nga 5 deri në 8 vende	20 300
	Mbi 8 deri në 15 vende	27 900
Autobuzë	Mbi 15 vende	44 400
Kamioncina	Pesha deri ne 3.5 Ton	19 500
Kamiona	Pesha deri në 3.5 Ton	32 600
Rimorkio	Te te gjitha llojeve	9 400
Mjete Bujqesore		7 300
Zjarrfikëse		16 800

3. Duke marrë parasysh që në bazë të Ligjit nr. 10455, datë 21.7.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Nenit 10, pika 2 “shoqëritë e sigurimit i përcaktojnë vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, rritja dhe fiksimi i çmimeve nga të gjitha shoqëritë e sigurimit(8 shoqëri) në mënyrë të menjëhershme dhe në të njëjtin nivel mund të ketë ardhur si pasojë e një marrëveshje të ndaluar kartel, e cila përbën shkelje të rëndë të nenit 4, pika 1, gërma a të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Të miratojë hapjen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (TPL), për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës.

- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraparak jo më vonë se data 22 .03 .2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 216, Datë 01.03.2012

Për “Vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes “INTERSIG” SHA”, për pengim të inspektimit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.02.2012 dhe 01.03.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi pengimin e inspektimit të realizuar në ndërmarrjen e sigurimeve “INTERSIG SH.A”

Baza ligjore: Nenet: 24, gërma (d); 26 dhe 73, pika 1, gërma (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi inspektimin e realizuar në ndërmarrjen e sigurimeve “INTERSIG SH.A”, Nr. 24/2 Prot., datë 27.02.2012.
- Pretendimet e paraqitura në seancën dëgjimore të organizuar me palën në datën 1.03.2012.

VËREN SE:

- 1 Komisioni i Konkurrencës i Autoritetit të Konkurrencës, me anë të Vendimit nr.215, datë 10.02.2012, ka hapur procedurën e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të

detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (TPL).

- 2 Në zbatim të neneve 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni, me anë të autorizimit nr.82 prot., datë 10.02.2012, ka autorizuar inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës për të kryer inspektime, në grup ose nëngrupe, pranë subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (TPL), “SIGMA” SHA, “SIGAL” SHA, “INTERSIG” SHA, “INSIG” SHA, “INTERALBANIAN” SHA, “ATLATIK” SHA, “EUROSIG” SHA DHE “ALBSIG” SHA, si dhe në organizatat ku ata janë anëtarë ose aderojnë.
- 3 Inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të autorizimit të mësipërm, nga data 10.02.2012 deri më datë 16.02.2012, kanë kryer inspektime pranë ndërmarrjeve të mësipërme, si dhe pranë Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë.
- 4 Më datë 16.02.2012, inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës u paraqitën pranë ambienteve të ndërmarrjes “INTERSIG” SHA, në zbatim të procedurave të hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (TPL). Grupi i inspektimit kërkoi nga punonjësi i sigurisë së kësaj ndërmarrje, të kontaktonte me drejtuesit e ndërmarrjes për të mundësuar hyrjen e grupit të inspektimit në ambientet e brendshme të ndërmarrjes për kryerjen e procedurës së inspektimit të parashikuar në nenin 36 të Ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- 5 Punonjësi i sigurisë i “INTERSIG” SH.A, pas kontakteve me drejtuesit e kësaj ndërmarrjeje, nuk lejoi që të realizohen procedurat e inspektimit në ndërmarrje të parashikuara nga Ligji Nr. 9121 datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- 6 Gjithashtu, nga ana e inspektorëve të Autoritetit të Konkurrencës iu shpjegua sanksioni ligjor ndaj subjektit që refuzon apo pengon kryerjen e inspektimit. Gjatë inspektimit u kërkuar nga ana e grupit të inspektimit edhe asistencë e Policisë së Shtetit, bazuar në nenin 35, pika 3, të Ligjit Nr 9121 datë 28.07.2003.
- 7 Edhe pas ardhjes së punonjësve të Policisë së Shtetit, nga ana e përfaqësuesit të ndërmarrjes nuk u lejua hyrja në ambientet e brendshme për të vazhduar procedurat që parashikohen në ligj për inspektimin.
- 8 Referuar sa më sipër, në kuptim të nenit 73, pika 1, germa (ç), e Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, kjo sjellje e ndërmarrjes “INTERSIG” SHA, pengimi i inspektimit të parashikuar nga neni 36, përbën kundërvajtje administrative, e cila cilësohet si shkelje e lehtë nga Ligji dhe sanksionohet me gjobë në masën jo më shumë se 1% të xhiros totale të vitit paraardhës financiar.
- 9 Grupi i inspektimit u paraqit përsëri pranë ndërmarrjes “INTERSIG” SHA më datë 17.02.2012, për të kryer inspektim dhe referuar procesverbalit datë 17.02.2012, “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit”, kreu procedurën e inspektimit, duke u lejuar nga ndërmarrja për të kryer këtë procedurë.

Komisioni i Konkurrencës, duke patur parasysh se:

- 1 Kryerja e inspektimeve nga ana e Inspektorëve të Autoritetit të Konkurrencës, në kohën dhe momentin e caktuar, është shumë i rëndësishëm për punën e Autoritetit të Konkurrencës, për zbulimin e shkeljeve dhe kryesisht të marrëveshjeve të ndaluara nga Ligji Nr. 9121 datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- 2 Ndërmarrja “INTERSIG” SHA më datë 16.06.2012, pengoi kryerjen e inspektimit pranë ambienteve ku ajo zhvillon veprimtarinë, gjë e cila në zbatim të nenit 73, pika 1, gërma (ç), të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative, duke u cilësuar si shkelje e lehtë.
- 3 Ndërmarrja “INTERSIG” SHA, më datë 17.02.2012, ka lejuar kryerjen e procedurës së inspektimit nga ana e grupit të inspektimit.

Si konkluzion, pengimi i kryerjes së inspektimit më datë 16.02.2012 nga ndërmarrja “INTERSIG” SHA, në kuptim të nenit 73, pika 1, gërma (ç) të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, është shkelje e lehtë e Ligjit dhe për këtë arsye sanksionohet me gjobë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 24, gërma (d), nenit 73, pika 1, gërma (ç), të Ligjit Nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- 1 Vendosjen e masës së gjobës për shkelje të lehtë ndaj ndërmarrjes “INTERSIG” SHA në vlerën 664.000 (gjashtëqindgjashtëdhjetekatër mijë) lekë.
- 2 Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palës dhe për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 217, datë 21.02.2012

Për miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2011 dhe synimet kryesore për vitin 2012”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.02.2012, shqyrtoi materialin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm, të titulluar “Raporti vjetor 2011 dhe synimet kryesore për vitin 2012”.

Bazuar në nenet 24, gërma e, dhe 29, gërma ç, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), pas shqyrtimit të projekt-raportit të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm,

V E N D O S I:

Të miratojë Raportin Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2011 dhe synimet kryesore për vitin 2012” sipas raportit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
 (_____)

Anëtar

Koço Broka
 (_____)

Anëtar

Rezana Konomi
 (_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 218, Datë 23. 02 .2012

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.02.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapja e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d); 26; 28, shkronja b); neni 4, pika 1; dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës;

VËREN SE:

- 1 Në media, është botuar letra e plotë në emër të dy shoqërive të shërbimeve portuale në Portin e Vlorës, përkatësisht “Alpida” shpk dhe “Delfini 1” shpk ku bëjnë me dije se agjencitë detare të cilat përfaqësojnë respektivisht tragetet “Ioninan Spirit”

dhe “Red Star 1” të cilët janë të vetmit tragete që operojnë në linjën Vlorë - Brindisi – Vlorë. Sipas kësaj deklarate këto agjenci kanë ndërprerë shërbimin gjatë vitit të kaluar, kanë aplikuar një grafik udhëtimi të përbashkët duke operuar një ditë njëri traget një ditë tjetri, si dhe çmime tepër të larta për linjën Vlorë - Brindisi - Vlorë.

- 2 Gjatë monitorimit të kryer nga Sektori i Analizës dhe Studimeve të Autoritetit të Konkurrencës gjatë muajit Qershor 2011 me nr. 193 prot. datë 18.07.2011 është vënë re se tregu i shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës ka një shkallë të lartë përqëndrimi pasi operojnë vetëm dy tragete për linjën Vlorë-Brindisi-Vlorë.
- 3 Gjatë muajve Mars, Prill dhe Qershor 2011 në këtë linjë është ndërprerë disa herë qarkullimi i udhëtarëve nga njëri prej trageteve ose nga të dy njëkohësisht. Gjatë periudhës së mungesës së udhëtimeve nga trageti “Jonian Spirit” është vënë re rritje e çmimit biletës së tragecit tjetër, por gjithësesi pa kaluar tarifën e përcaktuar në Licencë.
- 4 Bazuar respektivisht në nenet 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, situatua e krijuar në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës mund të ketë ardhur si pasojë e një marrëveshje të ndaluar ose një praktike përjashtuese të ndërmarrjeve që mund të ekzistojnë pozitë dominuese të ndjekura nga një ose disa ndërmarrje.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e e procedurës së hetimit praparak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës, për të parë nëse ka, apo jo, shenja të pengimit, kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 30.04.2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
()

Anëtar

Koço Broka
()

Anëtar

Rezana Konomi
()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 219, Datë 16. 03 .2012

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.03.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhezuesi mbi luftimin e marreveshjeve të ndaluara në ofertat publike”, si dhe nenet 12 dhe 12/1 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

Në bazë të një ankese nga një ndërmarrje dhe pas monitormit të tregut, Komisioni i Konkurrencës me vendimin Nr. 211, datë 23.12.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.

Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka realizuar procedurat e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.

Sipas evidencave të administruara gjatë inspektimeve të befasishme rezulton se në dokumentat e këtyre ndërmarrjeve të paraqitura në procedurat e tenderave publike ka shenja të bashkëpunimit (gabime drejtshkrimore; formular të leshuar në të njëjten datë dhe numra serialë të njepasnjeshëm nga kompani sigurimi të njëjta; të njëjtën formulim, formatim në ofertën ekonomike etj) të cilat tregojnë që përgatitja e ofertave për pjesëmarrjen në prokurimet publike është bërë nga një numër punonjësish të përbashkët të cilët punojnë ngushtësisht me njëri-tjetër.

Nga informacioni i administruar gjatë procedurës së hetimit paraprak, rezulton se ekzistojnë evidenca, në formë elektronike dhe shkresore, të bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni Security”, Eurogjici Security 1”, “Saimiri AL”, “NAZERI – 2000”, dhe “Dea Security” për pjesëmarrjen në prokurimet publike, çka mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në tregun përkatës në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Konkluzionet e hetimit paraprak tregojnë për një bashkëpunim të mundshëm në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni Security”, Eurogjici Security 1”, “Saimiri AL”, “Nazeri – 2000”, dhe “Dea Security” sjellje të cilat mund të bien në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 43, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 dhe nenin 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”, me objekt ekzistencën ose jo të marrëveshjeve në oferta që kufizojnë konkurrencën në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore 2009 - 2011.
- III. Përcaktimin e hapave të kryerjes së hetimit të thelluar si vijon:
- a. Mbledhja e informacioneve të nevojshme dhe plotësuese;
 - b. Inspektime në ndërmarrjet nën hetim, nëse del e nevojshme gjatë hetimit;
 - c. Përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur;
 - d. Hartimi i raportit përfundimtar të hetimit të thelluar brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 220, Datë 16. 03 .2012

“Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|---|---------------------|---------|
| • | Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • | Servete Gruda | Anëtar |
| • | Koço Broka | Anëtar |
| • | Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 12.03.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike

Baza ligjore: Nenet 4, pika 1, 24, germa d, 44, pika 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 9121, neni 61, shkronja d datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ketu dhe me poshte Ligji.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit “Mbi hetimin praparak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, Nr.35/1prot, dt.02.03.2012,

VËREN SE:

Në bazë të një ankese nga një ndërmarrje dhe pas monitormit të tregut, Komisioni i Konkurrencës me vendimin Nr. 211, datë 23.12.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security”

Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.

Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka realizuar procedurat e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.

Sipas evidencave të administruara gjatë inspektimeve të befasishme rezulton se në dokumentat e këtyre ndërmarrjeve të paraqitura në procedurat e tenderave publike ka shenja të bashkëpunimit (gabime drejtshkrimore; formularë të leshuar në të njëjtën datë dhe numra serial të njepasnjeshëm nga kompani sigurimi të njëjta; të njëjtën formulim, formatim në ofertën ekonomike etj) të cilat tregojnë që përgatitja e ofertave për pjesëmarrjen në prokurimet publike është bërë nga një numër punonjësish të përbashkët të cilët punojnë ngushtësisht me njëri-tjetër.

Nga informacioni i administruar gjatë procedurës së hetimit paraprak, rezulton se ekzistojnë evidenca, në formë elektronike dhe shkresore, të bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni Security”, Eurogjici Security 1”, “Sajmiri AL”, “NAZERI – 2000”, dhe “Dea Security” gjatë procedurave të prokurimeve publike, çka mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në tregun përkatës në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Pra, konkluzionet e hetimit paraprak tregojnë për një bashkëpunim të mundshëm në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni Security”, Eurogjici Security 1”, “Sajmiri AL”, “Nazeri – 2000”, dhe “Dea Security” sjellje të cilat mund të bien në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 4, pika 1, 24, germa d, 44, pika 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 9121, neni 61, shkronja d datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, duke marrë në konsideratë rrezikun e kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit,

V E N D O S I:

- I. Marrjen e masave të përkohshme për ndërmarrjet: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”, që t’i japin fund bashkëpunimit mes tyre për gjatë procedurave të prokurimeve publike në tregun e shërbimeve të rojeve fizike dhe i detyron këto ndërmarrje të sillen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra gjatë procedurave të prokurimeve publike sa i përket caktimit të çmimit të ofertës dhe/ose ndarjes së tregut përkatës.
- II. Moszbatimi i vendimit për masa të përkohshme, i cituar në piken 1 të këtij vendimi, ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b të Ligjit

- III. Masat e përkohshme duhet të zbatohen që nga momenti i marrjes dijeni të këtij vendimi nga ana e ndërmarrjeve “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 221, Datë 11. 04 .2012

“Për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes “Romano Port” SHA në tregun e ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.04.2012, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Ekzistenca ose jo e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes “Romano Port” SHA, në tregun e shërbimit të ngarkim–shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”
- Baza ligjore:** Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 8, neni 9, neni 24 germa d, neni 74 pika 1, shkronja a dhe neni 75 pika 1.
Kodi i Procedurave Administrative
- Palët në hetim:** “Romano Port” SHA, me NIPT K516255010 dhe adresë: Porto Romano, Durrës
- Periudha e hetimit:** Periudha objekt hetimi është përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në vendimin Nr.201, datë 20.09.2011 nga 1 janar 2009 deri në 15 shtator 2011.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës (GLN-së) në rrugë detare të paraqitur nga grupi i punes; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm; dhe

- Pretendimeve të ndërmarrjes “Romano Port” SHA, dhënë në seancën dëgjimore të dt.21.02.2012, si dhe pretendimeve me shkrim të depozituara nëpërmjet shkresës së saj Nr. 23 Prot datë 21.02.2012, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 107 Prot. datë 28.02.2012;

VËREN SE:

I. Çështja në shqyrtim

1. Hetimi i thelluar i adresohet shërbimit të ngarkimit dhe shkarkimit të GLN-së për depozitat e ndërtuara në Porto Romano nga ana e ndërmarrjeve të licencuara në importin dhe tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj. Ky shërbim ofrohet në bazë të ekskluzivitetit të dhënë nëpërmjet marrëveshjes koncesionare vetëm nga ndërmarrja koncesionare “Romano Port” SHA.
2. Në bazë të Ligji Nr.9298, datë 28.10.2004, “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”, pontili me infrastrukturën e tij është projektuar dhe do të funksionojë si një port shërbimesh të pavarura, i hapur për të gjithë operatorët e kualifikuar në industrinë e naftës e nënprodukteve të saj dhe do të sigurojë, për rrjedhojë, një bazë logjistike të një niveli shumë të lartë për të gjithë operatorët e licencuar në Shqipëri.
3. Gjithashtu, koncesionari detyrohet të respektojë të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij objekti, duke respektuar legjislacionin në fuqi në këtë fushë dhe koncesionari do të kryejë nëpërmjet pontilit vetëm veprimtarinë e ngarkim-shkarkimit të naftës, gazit të lëngshëm dhe nënprodukteve të saj dhe jo aktivitete të tjera tregtare.
4. Përdoruesit e shërbimit të ngarkim-shkarkimit janë ndërmarrjet që operojnë në tregun e importit të GLN-së, të cilat kanë ndërtuar depozitat në pronësi të tyre dhe/ose marrin kapacitete depozituese me qera.
5. Organi shtetëror i autorizuar është institucioni që ka për detyrë mbikëqyrjen dhe rregullimin e këtij koncesioni.

II. Procedurat e ndjekura

6. Procedurat e ndjekura gjatë hetimit janë bazuar në Kreun II të Pjesës II dhe në Kreun II dhe III të Pjesës së III të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar) (këtu e mëposhtë Ligji) dhe Kodin e Procedurave Administrative.
7. Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja “Mare Oil” SHA paraqiti një ankesë me Nr. 61/1 Prot datë 26.07.2011, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 326 Prot datë 26.07.2011. Me anë të kësaj ankese, kjo ndërmarrje pretendonte se “Romano Port” SHA nuk po lejonte shkarkimin e anijes me GLN në depozitat në pronësi të saj, për shkak të plotësimit të dokumentacionit. Për vlerësimin e kësaj ankese, Sekretariati, në zbatim të procedurave hetimore, në datën 27.07.2011, zhvilloi takime me përfaqësuesit e ndërmarrjes “Mare Oil” SHA dhe “Romano Port” SHA

8. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të procedurave, realizoi monitorimin në datën 27.07.2011, zhvilloi takime me përfaqësuesit e ndërmarrjes “Mare Oil” SHA dhe “Romano Port” SHA
9. Bazuar në gjetjet e monitorimit, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenin 42 të Ligjit, me anë të Vendimit Nr. 196 datë 29.07.2011 ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkimit dhe shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës (GNL) në tregun gjeografik Porto Romano, Durrës, për të parë nëse ka elementë të kufizimit të konkurrencës.
10. Komisioni i Konkurrencës, duke e vlerësuar se moslejimi i shkarkimit të anijes së subjektit pritës “Mare Oil” SHA nga ana e “Romano Port” SHA mund të përbënte një rrezik të kryerjes së një dëmi me pasoja të rënda e të pariparueshme për konkurrencën, me Vendimin Nr. 197 datë 29.07.2011 vendosi, me shumicë votash, të marrë masën e përkohshme. Nëpërmjet këtij vendimi është urdhëruar ndërmarrja “Romano Port” SHA të bëjë të mundur përpunimin e anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Mare Oil” SHA në mënyrë të menjëhershme dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e njoftimit të këtij vendimi.
11. Ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA me anë të shkresës së saj Nr.PGA–AK0811, datë 12.08.2011, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. Prot 355, datë 12.08.2011, ankohej se nga ana e “Romano Port” SHA, nuk po lejohej përpunimi i anijes së sjellë me GLN nga ana e saj dhe që do ta depozitonte në depozitat në pronësi të saj, pasi i kërkonin edhe dokumenta të tjera shtesë.
12. Gjithashtu, pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa me nr 13/1 prot., datë 13.08.2012 nga Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve, mbi disa shqetësime lidhur me konkurrencën në tregun e ngarkim-shkarkimit të GLN-së në Porto Romano, Durrës.
13. Komisioni i Konkurrencës, pasi u njoh me këtë ankesë, si dhe pas organizimit të seancës dëgjimore, duke gjykuar se ky akt mund të përbënte një rrezik të kryerjes së një dëmi me pasoja të rënda e të pariparueshme për konkurrencën, me Vendimin Nr. 198, datë 25.08.2011 vendosi, me shumicë votash, të marrë masën e përkohshme duke urdhëruar ndërmarrjen “Romano Port” SHA të bëjë të mundur përpunimin e anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA.
14. Autoriteti i Konkurrencës u njoftua nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA), mbi Vendimin Nr. 5537/6 datë 12.08.2011. OSHA bazuar në ankesën e ndërmarrjes “Mare Oil” SHA me Vendimin e saj Nr.1 datë 24.08.2011, vendosi që Shoqëria “Romano Port” SHA të garantojë zbatimin e menjëhershëm të detyrimit ligjor për të bërë përpunimin e anijeve të sjella nga shoqëritë e licencuara për tregtimin e GLN dhe që kanë në pronësi ose përdorim depozita bregdetare në zonën e Porto Romanos, të cilat janë brenda kushteve të kërkuara teknike dhe të certifikuara nga institucionet përkatëse si Inspektoriati Qendror Teknik (IQT), Policia Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (PMNZSH), Ministria Mjedisit Pyjeve Administrimit të Ujrave, etj.
15. Më datë 01.09.2011 ndërmarrja “Mare Oil” SHA depozitoi një ankesë me Nr. 181 prot, me anë të së cilës ajo kërkoj që t’i mundësohet përpunimi i anijes së sjellë prej saj në depozitën në zonën bregdetare te Porto Romanos. Me anë të kësaj ankese, “Mare Oil” SHA pretendon se pranë Porto Romanos në datën 31 Gusht 2011 kishte dërguar një anije me GLN të destinuar për tregun shqiptar (me emërtim “Synzaura”), në mënyrë që t’a shkarkonte dhe t’a depozitonte në depozitat e saj bregdetare në Porto Romano. Me anë të shkresës nr. 76 prot, datë 31.08.2011, është njoftuar

nga “Romano Port” SHA se duhet të nënshkruante një kontratë-tip të formës “sipërmarrjes”, për t’i mundësuar më pas shkarkimin.

16. Në vazhdim të procedurave, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin Nr. 201, datë 20.09.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare ndaj ndërmarrjes “Romano Port” SHA, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun përkatës ndaj ndërmarrjes “Romano Port” SHA, me objekt ekzistencën ose jo të abuzimit me pozitën dominuese në treg.
17. Gjatë zhvillimit të procedurave të hetimit të thelluar, pranë Autoritetit të Konkurrencës janë depozituar edhe dy ankesa të tjera, njëra nga ndërmarrja “Mare Oil” SHA me nr. extra prot, datë 12.10.2011 dhe tjetra nga “Romano Port” SHA i datës 13.10.2011. Me anë të saj, “Mare Oil” SHA shprehet se pranë Porto Romano në datën 12.10.2011 ka dërguar një anije me GLN të destinuar për tregun shqiptar (me emërtim “Synzaura”), në mënyrë që t’a shkarkojë dhe t’a depozitojë në depozitat që ajo zotëron pranë portit “Romano Port”. Në datën 11 tetor 2011, përsëri me anë të adresës elektronike, “Mare Oil” SHA njoftohet nga “Romano Port” SHA se duhet të nënshkruajë një kontratë-tip “Sipërmarrjeje për kryerje shërbimesh” për të bërë të mundur shkarkimin e anijes. Sipas “Mare Oil” SHA në lidhje me përmbajtjen e kësaj kontrate, me “Romano Port” SHA janë bërë disa takime, porse vetë “Romano Port” SHA nuk i ka marrë parasysh sugjerimet e saj dhe përfundimisht i ka kërkuar që të nënshkruajë kontratën-tip sipas kushteve të saj. Ajo e quan atë të pabazuar dhe të padrejtë, dhe kërkon që t’i mundësohet përpunimi i anijes së sjellë prej saj.
18. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës organizoi seancën dëgjimore më 21.2.2012 me përfaqësuesit ligjor të ndërmarrjes “Romano Port” SHA., si dhe morri në konsideratë pretendimet e ndërmarrjes objekt hetimi të protokolluar me nr.107 prot., datë 28.02.2012, pranë Autoritetit të Konkurrencës.

II. TREGU PËRKATËS

19. Bazuar në Ligjin Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe udhëzimin Nr. 76, datë 07.04.2008 të Komisionit të Konkurrencës “Për përcaktimin e tregut përkatës” ekzistojnë dy përmasa për përcaktimin e tregut përkatës. Tregu përkatës përcaktohet në dy dimensionet:
 1. Tregu përkatës i produktit dhe/ose i shërbimit
 2. Tregu përkatës gjeografik

II.1 Tregu i shërbimit

20. Tregu i shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) në rrugë detare ofrohet për depozitat e dedikuara në zonën e Porto Romano nga ndërmarrja “Romano Port” SHA.
21. Procesi i ngarkim-shkarkimit në rrugë detare ofrohet në dy porte: Porto Romano, Durrës dhe porti Vlora 1, Vlorë. Ky proces nuk mund të realizohet pa procesin e depozitimit të produktit në depozitat e lidhura me impiantet e ngarkim shkarkimit. Por kushtet dhe konditat në të cilat ofrohet ky shërbim në zonën e Porto Romanos nga ndërmarrja “Romano Port” SHA, janë specifike, pasi procesi i depozitimit realizohet në depozitat që janë në pronësi të ndërmarrjeve të ndryshme të importit të GLN-së.

Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës

22. Në zonën gjeografike të Porto Romanos, ndërmarrjet që operojnë në tregun e importit dhe të tregëtimit me shumicë të GLN-së kanë të drejtën të ndërtojnë depozitat në pronësi të tyre, përdorimi i të cilave lidhet ngushtësisht me mundësimin e procesit të ngarkim-shkarkimit. Këto ndërmarrje mund të realizojnë procesin e ngarkim-shkarkimit nëpërmjet shoqërisë “Romano Port” SHA, që është i vetmi subjekt që mund ta ofrojë shërbimin e ngarkim-shkarkimit të GLN-së. Kjo e drejtë ekskluzive është garantuar nga marrëveshja koncesionare, e përkatësisht Ligjit Nr. 9298 datë 28.10.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim) për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto Romano/Durrës” (i ndryshuar).

Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës

23. Ndërmarrja “Romano Port” SHA për shkak të ekskluzivitetit nuk mund të ketë konkurrentë në ofrimin e shërbimit. Në kontratën koncesionare ndërmarrjes “Romano Port” SHA i është dhënë ekskluziviteti për shërbimin e ngarkim-shkarkimit të naftës dhe nënprodukteve të saj në zonën e Porto Romanos, duke bllokuar në këtë mënyrë hyrjet e reja në tregun përkatës, për aq kohë sa kjo kontratë do të jetë në fuqi.

II.2 Tregu gjeografik

24. Tregu gjeografik përfshin territorin e Porto Romanos” në zonën me të njëjtin emër në Durrës. Kjo zonë gjeografike është e ndarë nga të tjerat, pasi depozitat e GLN-së që janë në pronësi të ndërmarrjeve të licencuara në fushën e importit dhe tregëtimit të GLN-së mund të përfitojnë shërbimin e shkarkimit dhe depozitimit në rrugë detare vetëm nëpërmjet këtij porti.

Tregu përkatës i shërbimit është tregu i ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare në zonën gjeografike të Porto Romanos, Durrës.

III. Vlerësimi i pozitës dominuese

25. Në bazë të pikës 5 të nenit 3 të Ligjit, pozitë dominuese është ajo fuqi ekonomike mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë përsa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
26. Vlerësimi i pozitës dominuese të ndërmarrjes nën hetim Romano Port SHA është bërë duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 8 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, për të cilat jepen shpjegimet sa më poshtë vijon:

III.1. Pjesët e tregut

27. Shërbimin e ngarkim-shkarkimit në rrugë detare në zonën e Porto Romanos e ofron vetëm “Romano Port”. Pra, depozitat që janë ndërtuar nga ana e ndërmarrjeve të licencuara në importin dhe tregëtimin me shumicë të GLN-së në zonën e Porto

Romanos mund ta marrin shërbimin e ngarkim shkarkimit vetëm nga ndërmarrja “Romano Port” SHA, e cila si rrjedhim zotëron 100% të tregut përkatës.

III.2 Pengesat e hyrjes në treg

III.2.1 Pengesat ligjore

28. Shërbimi i ngrakim-shkarkimit në rrugë detare realizohet nga një shoqëri e vetme, shoqëria “Romano Port” SHA, e cila vepron sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet saj dhe Qeverisë Shqiptare dhe ratifikuar në Kuvendin e RSH, me Ligjin nr. 9298, datë 11.07.2004, i ndryshuar në 2006. Sipas VKM Nr. 251, datë 20.04.2001 janë përcaktuar hapësirat ku do të ndërtohen instalimet bregdetare, përkatësisht në zonën e Porto Romanos
29. Në bazë të marrëveshjeve koncesionare të lidhura nga ana e Shtetit Shqiptar me këtë ndërmarrje, ekziston e drejta e eskuzivitetit për një periudhë 30 vjeçare të këtij porti. Sipas kësaj kontrate, për periudhën kohore në vijimësi nuk mund të ndërtohen atje porte të tjera, përveç përjashtimeve të parashikuara në marrëveshjet koncesionare për sa i përket ngarkimit-shkarkimit dhe depozitimit të naftës dhe nënprodukteve të saj.
30. Pra, tregu i ofrimit të shërbimit të ngarkim- shkarkimit të GLN-së në rrugë detare ka pengesë ligjore në hyrje .

III.2.2 Barrierat ekonomike

31. Kostot për ndërtimin e një porti të ri në tregun e ngarkimit-shkarkimit të GLN-së janë të larta, për shkak të investimeve që kërkohen për ngritjen e portit, ngritjen e infrastrukturës së nevojshme portuale, thellimin e detit, investimet në tokë etj. Në këtë lloj investimesh kërkohen shpenzime të mëdha për investime fikse, karakteristikë specifike kjo e tregjeve në të cilat teknologjia bëhet faktor kryesor për pengesën e konkurrentëve të rinj në treg.
32. Ndërmarrja gjithashtu duhet të marrë parasysh koston e daljes nga tregu, e cila vjen për shkak të një sërë kostosh të hyrjes dhe zhvillimit të këtij aktiviteti, të cilat konsiderohen të pakthyeshme ose kanë një normë të ulët kthimi në rast të rishitjes. Për sa më sipër, ndërtimi i porteve të reja të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre të cilat mund të jenë një mundësi potenciale vetëm në raste të përcaktuara në ligj, në kuptim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nenit 9, pika b përbëjnë pengesa në hyrje.

III.3. Fuqia kundërvepruese e blerësve

33. Ndërmarrja Porto Romano SHA është e vetmja ndërmarrje që operon në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim në zonën e Porto Romanos. Duke mos patur mundësira të tjera për ta marrë këtë shërbim, fuqia kundërvepruese e blerësve, në këtë rast e ndërmarrjeve që kanë investuar në depozitat e tyre ose me qera në zonën e Porto Romanos është e dobët.
34. Bazuar në kushtet dhe konditat specifike të ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit të GLN-së në Porto Romano, si dhe referuar pjesëve në tregun përkatës dhe barrierave ligjore dhe ekonomike që ekzistojnë në treg, konkurrencës

potenciale, sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, rezulton se ndërmarrja “Romano Port” SHA ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim – shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare, në portin Porto Romano

III.4. Kundërveprimi i konkurrentëve në tregjet e lidhura me tregun përkatës

35. Tregu i depozitimit. Importuesit e GLN me rrugë detare përfitojnë nga koncesionari vetëm shërbimin e ngarkim shkarkimit, por ky i fundit nuk mund të ofrohet i veçuar nga depozitimi. Kështu, ndërmarrjet importuese të GLN-së kanë investuar duke ndërtuar depozita në zonën e këtij porti, Tregu i ngarkim shkarkimit të Romano Port është treg, i cili nuk mund të funksionojë i veçuar nga depozitimi i GLN.
36. ga e evidencat e siguruara vërtetohet se aksioneri kryesor (i cili zotëron mbi 99 % të paketës së aksioneve) dhe që është edhe drejtuesi ekzekutiv i ndërmarrjes “Romano Port” SHA është zotërues i paketës bllokuese (prej 50%) të ndërmarrjes “Intergaz” SHA, e cila kryen aktivitetin e saj në tregun e depozitimit të GLN-së në Portin Romano, Durrës, si dhe është aksioner i vetëm i ndërmarrjes “AV Gaz” SHA, e cila operon në tregun e importit të GLN-së.
37. Tregui i importit dhe i tregtimit me shumicë i GLN-së. Struktura e tregut të importit të GLN ka patur ndryshime të forta strukturore gjatë periudhës kohore 2009-15 Shtator 2011, si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë së ngarkim shkarkimit dhe depozitimit.
38. Për vlerësimin e shkallës së përqendrimit është llogaritur indeksi HHI (Herfindahl-Hirschman), i cili është bazuar mbi pjesët e zotëruara të tregut nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në tregun e importit të gazit të lëngshëm. Përmasat e koncentritimit janë treguesit e ndërmarrjes për të ushtruar fuqinë e tregut. Dy nga njësitë që janë përdorur për të matur shkallën e përqendrimit janë: Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) dhe treguesi i CR3.
39. Tabela më poshtë paraqet HHI-në për periudhën janar 2009-15 Shtator 2011.

Tabele 1: Vlerësimi i indeksit të përqendrimit HHI për tregun e importit të gazit të lëngshëm

Treguesit e përqendrimit	2009	2010	Janar-15 Shtator 2011
HHI*	1975.04	2870.60	2791.
CR3	65%	82%	73.7%
CR4	76.9%	87%	84.2%

40. Po t’i referohemi treguesve të përqendrimit shohim se indeksi i përqendrimit HHI gjatë vitit 2009 është mbi nivelin 1800 duke na treguar për një treg me përqendrim të lartë. Ndërsa gjatë viteve 2010 - 15 Shtator 2011, vihet re një rritje e ndjeshme e HHI-së përkatësisht në 2870.60, dhe 2791, duke kaluar në një treg me shkallë të lartë përqendrimi. Kjo rritje e treguesit të përqendrimit vjen si rezultat i rritjes së

* Me një HHI nën 1000 përqendrimi i tregut mund të konsiderohet i ulët, ndërmjet 1000 dhe 1800 si i moderuar dhe mbi 1800 i lartë.

pjesës së tregut të ndërmarrjeve A&V-GAS SHA ku vetë kjo ndërmarrje plotëson shkallen e lartë të përqendrimit për periudhën Janar 15 Shtator 2011 në vlerën 2296, duke patur fuqi tregu për të patur ndikim në parametrat e konkurrencës.

41. Edhe treguesit CR3 dhe CR4 paraqiten të larte dhe në rritje në krahasim me vitin 2009 përkatësisht CR3 në 82% dhe 73.7% në krahasim me vitin 2009 që është 65% dhe CR4 në 87% dhe 84.2% në krahasim me 76.9% që ishte në vitin 2009.

IV. Abuzimi me Pozitën Dominuese i ndërmarrjes “romano port” sha

IV.1. Vendosja e kushteve te padrejta për ofrimin e shërbimit të ngarkim –shkarkimit

42. Në bazë të nenit 4 të Ligjit koncesionar, ndërmarrja “Romano Port” është e detyruar që të pranojë çdo ndërmarrje të licencuar për të ofruar shërbimin. Sipas këtij neni “Romano Port” SHA ka detyrimin të mos refuzojë ofrimin e shërbimit pa ndonjë shkak të arsyeshëm dhe të ligjshëm.
43. Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) me Vendimin Nr. 4 datë 27.04.2009 ka miratuar “Rregulloren e funksionimit të portit të përpunimit të lëndëve djegëse” për shoqërinë “Romano Port” SHA. Sipas nenit 1 të kësaj rregulloreje, qëllimi i saj është organizimi i të gjithë veprimtarisë juridike administrative për funksionimin e portit “Romano Port” si një port i hapur për trafik ndërkombëtar dhe se kjo rregullore do të zbatohet në këtë port ndaj të gjitha ndërmarrjeve (ose operatorëve ekonomikë) që transportojnë gaz, naftë dhe nënprodukte të tjera.
44. Në bazë të Rregullores së Portit, pritësi i mallit (operatori ekonomik) për të bërë të mundur shkarkimin e mallit (naftës, gazit, e nënprodukteve të tyre), duhet të paraqesë këta dokumenta tek autoritetet përkatëse:
 - Dokument i lëshuar nga autoritetet doganore që lejojnë përpunimin e anijes;
 - Dokument i lëshuar nga Laboratori i kontrollit për cilësinë e produkteve që do të përpunohen;
 - Dokument nga autoritetet mjedisore për plotësimin e kërkesave mjedisore;
 - Dokument për pagesën e shërbimit që kryen Porti.
45. “Romano Port” SHA i ka kërkuar “Mare Oil” SHA dhe “Prima Gas Albania” SHA që për të bërë të mundur shkarkimin e anijeve të tyre me GLN në Portin “Porto Romano”, përveç dokumenteve të mësipërme, edhe dokumenta të tjera shtesë që janë:
 - Leje shfrytëzimi për stacionin e depozitimit të gazit të lëngshëm për shoqërinë “Mare Oil” SHA;
 - Vërtetim teknik për konformitetin e linjave të transportit të lëndëve djegëse dhe depozitave të lësuara nga IQT;
 - Licencën e ushtrimit të aktivitetit;
 - Akt kolaudimin e stacion depozitimit.
46. Këto dokumente nuk përmenden në rregulloren e mësipërme. Në këtë mënyrë ndërmarrja Romano Port SHA vendos te tejkalojë detyrimet ligjore duke kërkuar dokumenta shtesë, të cilat i vendosin operatorët në kushte të pabarabarta tregtimi.

IV.2. Zbatimi i kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët.

47. Gjatë procedurës hetimore u konstatua se ndërmarrjet që operojnë në tregun e importit dhe të tregëtimit me shumicë të naftës gjatë periudhës objekt hetimi kanë marrë

shërbimin e shkarkimit të naftës duke shfrytëzuar depozitat e tyre megjithëse kanë qënë paleje shfrytëzimi. Sipas të dhënave nga Komuna Katund i Ri dhe nga autoritetet portuale¹, rezulton se për periudhën tetor – dhjetor 2009 Romano Port SHA:

- Ka përpunuar anijet e ndërmarrjes Kastpetrol për produktet naftë dhe benzine me date 04.06.2009-24.07.2009 ndërkohë që lejet e shfrytëzimit për depozitat bregdetare të kësaj ndërmarrje janë marrë më datë 29.07.2009, dhe për depozita bregdetare eskada e jashtme më datë 12.08.2011.
- Ka përpunuar anijet e ndërmarrjes Europetrol nga data 20.07.2009-27.12.2009 ndërkohë që lejet e shfrytëzimit për depozita bregdetare janë dhënë për : terminal karburantesh me datë 24.03.2011 ; depozita bregdetare estakada e jashtme datë 12.08.2011; depozita të naftës dhe nënprodukteve të saj date 24.08.2011.

48. Pra, në bazë të këtyre të dhënave rezulton se ndaj ndërmarrjeve që importojnë naftë, “Romano Port” SHA nuk ka kërkuar dokumente shtesë sikundër ka vepruar me ndërmarrjet që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN, dhe i ka lejuar ato të shkarkohen dhe pse për periudhën që ajo i ka lejuar të shkarkohen, nuk kanë patur leje shfrytëzimi. Ndërkohë që për ndërmarrjet që operojnë në tregun e GLN-së, nuk ka lejuar të bëhet shkarkimi, me arsyetimin se duhen dokumenta të tjerë shtesë duke e justifikuar për arsye sigurie në port.
49. Në këtë mënyrë “Romano Port” SHA ka zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, pavarësisht se operatorët e sipërcituar operojnë në tregje të ndryshme (depozitim dhe tregtim me shumicë të naftës dhe depozitim dhe tregtim me shumicë të GLN-së) duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme për të realizuar me efience aktivitetet e tyre respektive.
50. Duke qenë se ndërmarrja nën hetim ka pozitë dominuese në tregun përkatës, dhe duke qënë se ajo ndërmarrje është e integruar vertikalisht në tregun e depozitimit dhe të importit me shumicë të GLN², pra ka arsye ekonomike që anë të kësaj sjelljeje të bëjë të mundur pengimin e konkurrentëve të tjerë që operojnë në të njëjtin treg me ndërmarrjet e lidhura me të.

III.3 Vendosja e kushteve për lidhjen e kontratave me ndërmarrjet që veprojnë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të GLN, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë.

51. Në muajin gusht 2011, ndërmarrja “Romano Port” SHA ka kushtëzuar shkarkimin e anijeve me GNL me nënshkrimin e një kontrate tip, e cila i ngarkon me detyrime të tjera shtesë operatorët ekonomikë që duan të shkarkojnë produktet e tyre në depozitat që kanë ndërtuar në zonën bregdetare.

1 Shkresa nr 474/1 datë 21.10.2011,dhe Shkresa nr 102 datë 14/10/2011 .

2 Sipas të dhënave nga QKR, përfaqësues ligjor i “Romano Port” SHA është z. Pirro Bare, i cili zotëron 99,84 % të aksioneve në këtë ndërmarrje, c’ka tregon se ky aksionar ka të shumicën vendimmarrëse në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve në këtë shoqëri. Gjithashtu z. Pirro Bare është aksioner në masën 50 % të aksioneve në shoqërinë “INTERGAZ” SHA. Në këtë shoqëri, pavarësisht se z. Pirro Bare nuk ka shumicën vendimmarrëse në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve, ky person ka shumicën bllokuese të vendim-marrjes çka do të thotë që përsëri vendimmarrja e shoqërisë ” Intergas“ SHA kushtëzohet nga ana e tij. Gjithashtu ky aksionar zotëron 100 të aksioneve në ndërmarrjen A&V GAZ SHA, e cila kryen veprimtari importi të GLN.

52. Marrëveshja koncesionare si dhe rregullorja për funksionimin e portit, parashikojnë se çdo operator ekonomik i licencuar, (nenit 36 pika f dhe neni 37) ka të drejtë të shkarkojë mallin e tij dhe “Romano Port” duhet të plotësojë kërkesën e operatorit ekonomik. Ky detyrim për ndërmarrjen objekt hetimi rrjedh nga aktet ligjore dhe nënligjore dhe kushtëzimi i ofrimit të shërbimit me kërkesa shtesë është i pambështur dhe i pabazuar në ligj.
53. Në vlerësim të kësaj kontrate, në disa nene të saj detyrimet të cilat ligji ia ngarkon koncesionarit, ky i fundit ia kalon të tretëve pa vullnetin e tyre. Këto janë detyrime që në mënyrë specifike duhet ti përmbushi koncesionari. Detyrimet e koncesionarit përveçse burojnë nga ligji, janë detyrime të cilat janë të parashikuara edhe në nenin 673 të Kodit Civil, në të cilën parashikohet se: një ndërmarrje me pozitë dominuese në treg është e detyruar të kontaktojë me cilindo që kërkon një detyrim.
54. Neni 850 i Kodit Civil, i cili bën fjalë për kontratën e sipërmarrjes (kontratën tip që i është ofruar operatorëve ekonomik) bën fjalë për një kontratë me anë të së cilës njëra palë (sipërmarrësi) detyrohet që me mjetet e saj dhe duke marrë përsipër rrezikun, të kryejë një punë, një vepër, apo një shërbim, ndërsa pala tjetër detyrohet ta pranojë atë kundrejt çmimit të përcaktuar në kontratë. Pra, sikurse rezulton edhe nga kjo dispozitë në të cilën “Romano Port ka mbështetur kontratën tip të ofruar, detyrimet dhe rreziqet e mundshme janë përgjegjesi e koncesionarit dhe nuk mund t’i kalojnë të tretëve përveçse kur ekziston një vullnet i shprehur i palëve. Në këtë kuptim kushtet e kontratës në vlerësimin tonë janë të padrejta dhe të pabazuar në ligj.
55. Nëse negociatat midis koncesionarit dhe operatorëve që marrin shërbimin e tij nuk rezultojnë të pasukseshme, atëherë palët duhet t’i drejtohen OSHA-së, i cili është rregullatori dhe mbikëqyrësi i këtij koncesioni. Gjatë periudhës së hetimit konstatohet se “Romano Port” SHA nuk ka kërkuar dhe nuk është marrë ndonjë miratim për këtë “kontratë-tip” të ofruar operatorëve të cilët janë konkurrentë në tregjet e lidhura në të cilat koncesionari ka interes ekonomik.

Si konkluzion, Komisioni i Konkurrencës konstaton se ndërmarrja “Romano Port” SHA zotëron pozitë dominuese në tregun e ngarkim-shkarkimit të GLN-së në rrugë detare gjatë periudhës objekt hetimi. Ky operator në mënyrë të përsëritur ka refuzuar të realizojë procesin e shkarkimit të GLN-së për operatorët që kanë investuar për kapacitet depozituese në pronësi të tyre duke paraqitur arsye të paligjshme dhe të paarsyeshme. Ky refuzim lidhet me interesat ekonomike të drejtëpërdrejta të këtij operatori në tregjet e rrjedhës së poshtme pra, atë të depozitimit dhe të tregëtimit me shumicë të GLN-së, duke sjellë kufizimin e konkurrencës në këto tregje. Kjo sjellje e ndërmarrjes “Romano-Port” SHA, është abuzive, në kuptim të nenit 9, pika 2, (germa “c”) të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës,

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 24, gerrat “a” dhe “d”, nenit 74 pika “1” germa “a” dhe me nenet 69-70 të Ligjit Nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar),

V E N D O S I:

- I. Shoqëria “Romano Port” SHA ka abuzuar në tregun e ofrimit të ngarkim-shkarkimit të GLN-së në zonën e Porto Romanos;

- a. duke vendosur kushteve të tjera të padrejta të ofrimit të shërbimit,
 - b. batimi i kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - c. vendosja e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.
- II. Gjobitjen për këtë shkelje të rëndë të ndërmarrjes “Romano Port” SHA në masën 2.35% të xhiros totale të kësaj ndërmarrje për vitin 2010 që korrespondon me shumën 6,735,419 lekë.
- III. Urdhërimin e “Romano Port” SHA të mos kushtëzojë ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit duke krijuar pengesa me sjelljen e saj ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e depozitimit dhe të importit e tregëtimit me shumicë të GLN-së.
- IV. Mbylljen e hetimit të thelluar nisur me Vendimin Nr. 201 datë 20.09.2011 të Komisionit të Konkurrencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R

MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr 221, datë 11/04/2012” Për Abuzimin me pozitën dominuese të ndërmarrjes “Romano Port” SHA në tregun e ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare“, kam mbajtur qëndrimin kundra, me arsyetimin e mëposhtëm :

- 1— Siç jam shprehur lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.197, Datë 29.07.2011 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm

në Portin”Porto Romano” –“Duke vlerësuar shqetësimin e firmës “Mare Oil”e cila ka paraqitur një ankesë me anë të shkresës së saj Nr. 61/1 **datë 26.07.2011**, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 326 të datës 26.07.2011 me anë të së cilës ka pretenduar se “Romano Port” SHA nuk e lejon të kryejë shkarkimin e anijes me gaz të lëngshëm në Porto Roman, që nga data 22.07.2011, dhe kërkon nga Autoriteti i Konkurrencës që të ndërhyjë në tregun e brendshëm të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN), për shkak të praktikave monopoliste që ndiqeshin në këtë treg, **kam mbështetur dhe kam nxitur ndërhyrjen e shpejtë të Autoritetit për shqyrtimin e kësaj ankese**. Por kjo ndërhyrje e shpejtë, nuk përjashton por për më tepër presupozon **një hetim të plotë dhe objektiv**.

- 2– Mbështetur në Raportin e Grupit të Punës të ngritur për shqyrtimin e kësaj ankese, informacionin plotësues të prezantuar dhe propozimeve të tij, mbështetur mbi faktet dhe provat e mbledhura në terren dhe të vena në dispozicion, kam qenë dhe jam dakord me propozimin dhe Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr 196 datë 29/07/2011”Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano” . Pra jam plotësisht dakord për shqyrtimin sa më të shpejtë të ankesës së ndërmarrjes “Mare Oil”, duke ndjekur procedurat përkatëse, përfshi informacionin e siguruar nga ndërmarrja “Porto Romano”.
- 3– Sipas informacionit të siguruar nga Grupi i Punës gjatë muajit Korrik, ndërmarrja “Porto Romano” kërkon garanci se ndoshta ndodhë ndonjë shpërthim, në kushtet kur ndërmarrja “Mare Oil” nuk ka lejë shfrytëzimi të depozitës së saj të gazit. Kjo për arsye se me anë të marrëveshjes koncesionare “Romano Port” SHA përgjigjet për mirëmbajtjen dhe sigurinë teknike të portit. Mbështetur në shqyrtimi i dokumentacionit të siguruar në dosjen përkatëse, sqarimet e grupit të punës, dyzimin e qëndrimeve brendapërbrenda sekretariatit lidhur me propozimin për marrjen e masave të përkohshme, mungesën e dëgjimit të drejtpërdrejtë nga ana e Komisionit të Konkurrencës, të pretendimeve të ndërmarrjes “Porto Romano” SHA për mos përpunimin e anijes me GLN të ndërmarrjes “Mare Oil” në depozitën e saj nuk krijova bindjen se jemi para një Vendimi të Komisionit të Konkurrencës për të vendosur përpunimin e menjëhershëm të anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Mare Oil” në depozitën e saj të re, pavarësisht zbatimit të kërkesave teknike të sigurisë ” . Mungesa e lejes së shfrytëzimit konfirmohet nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga materialet e siguruar gjatë monitorimit por edhe Vendimi Nr 197, datë 29/07/2011 I Komisionit të Konkurrencës “8. Vërtetim nga Komuna Katund i Ri e datës 24.07.2011; (Me anë të të cilit vërtetohet se ndërmarrja Mare Oil ka depozituar dokumentacionin për leje shfrytëzimi)” Pra deri në këtë kohë është depozituar vetëm kërkesa për leje shfrytëzimi, që është bërë më 24.07.2012. Ndërsa kërkesa për shkarkime gazit të lëngët në Depozitat e reja të ndërmarrjes Mare Oil, nga kjo ndërmarrje është bërë në date 21.07.2011. Pra kemi të bëjmë me një kontradiktë, në se duhet pranuar nga “Romano Port “ SHA, të lejojë të operohet në depozitat e reja të ndërtuara nga operatorët pa leje shfrytëzimi dhe jo me një çështje që ka të bëjë me abuzimin me pozitën dominuese. Kjo është një çështje që është në kompetencë të të organeve të tjera shtetërore, aq më tepër që ky është një treg i rregulluar, dhe jo në kompetencë të Autoriteti të Konkurrencës. Komisioni i Konkurrencës, dhe unë si anëtar i tij për gjykimin tim **nuk mund të ligjëroj**, se ndërmarrjet që operojnë ose ndërveprojnë me ndërmarrje të tjera

monopol apo me pozitë dominuese, nuk kanë nevojë për lejë shfrytëzimi që kërkojnë këto ose ato akte ligjore në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe se mund të operojnë pavarësisht kësaj kërkesë ligjore.

- 4– **Pretendimi i ndërmarrjes “Mare Oil” i bërë gjatë séancës dëgjimor se edhe para datës 24 Korrik 2011, se kjo ndërmarrje ka shkarkuar gaz të lëngët në depozitat e veta (e theksoj të veta), rezultoi i pasaktë, i gabuar, një keqinformim.** Kjo pasaktësi është konfirmuar dhe nga Grupi Hetimor i cili nuk gjeti asnjë provë dhe fakt se ndërmarrja Mare Oil, ka shkarkuar më parë në depozitat e veta para muajit Gusht, dhe pohon se ky pretendim është i pasaktë. Nga kjo rezulton se depozita e re e ndërmarrjes Mare Oil, ka përfunduar në gjysmën e dytë të muajit Korrik dhe vetëm më 24.07.2012, është bërë kërkesa për lejë shfrytëzimi. Ndërsa nga ana e saj “Romano Port” sh.a. ka kërkuar për efekte sigurie në konformitet me kërkesat e legjislacionit shqiptar për lejë shfrytëzimi por dhe me ato të legjislacionit dhe konventat ndërkombëtare për sigurinë në porte ku Republika e Shqipërisë është pale, e ka konsideruar që në fillim dhe në vazhdimësi zbatimin e këtij legjislacioni si një garanci për sigurinë në port. Ndërkohë ka qenë e hapur për bashkëpunim të drejtpërdrejtë me entin rregullator, për të shmangur çdo keqinformimin nga palët e tretat Në shkresën e datë 17/08/2011-Material informues për shkresën Nr 5537/7 Prot, date 15.08.2011 në lidhje me Vendimin Nr 5537/6 Prot datë 12.08.2011 e dërguar nga OSHA, drejtuar Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA) dhe për dijeni dhe Autoritetit të Konkurrencës; Romano Port Sh.a nënvizon.” Kërkojmë që ne mbledhjen e radhës së OSHA-së të jenë prezent përfaqësues të shoqërisë koncesionare “Romano Port” dhe përfaqësues të shoqërive tregtare të cilat kane bërë ankime, në këtë mënyrë do të ballafaqohemi drejtpërdrejt me aspektet teknike ligjore, në këtë mënyrë do të vihen para pergjegjesise Institucionet kompetente për vlerësimin e rrezikshmërisë së shkarkimit të lendeve djegëse në stacionin e depozitimit pa leje shfrytëzimi dhe pa licence. **Vlen të theksohet fakti se OSHA është keq informuar nga persona të cilat kane interesa të drejtpërdrejta apo të tërthorta në lidhje me këto kompani”.**

- 5– Në se mund të ketë ndodhur, siç pohohet në pikën nr 47 dhe 48 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës se nga ndërmarrja “Romano Port “Sh.a. që në ndonjë treg tjetër përkatës si ai i ngarkim shkarkimit të produkteve të naftës dhe benzinës, është toleruar shkarkimi i tyre pa patur lejë shfrytëzimi, mendoj se mospasja e lejes së shfrytëzimit është shkelje ligjore, që nuk ka përse të tolerohet në vazhdimësi. Kalimi nga një situatë jo ligjore, në një situatë ligjore, natyrisht nuk përjashton pabarazi, në këtë moment ose periudhë të dhënë. Por zbatimi i ligjit nuk duhet justifikuar dhe nuk mund të shtyhet në pafundësi me pretekstin se kemi një situatë të pabarabartë për veprime tregtare të njëjta.

Procesi i kalimi nga praktika e mëparshme e shkarkimit të anijeve të ngarkuar me gaz të lëngët drejtpërdrejt në autobote, me mangësi të mëdha sigurie për portet por dhe njerëzit rreth tyre, në shkarkimin e tyre nëpërmjet depozitave bregdetare, në Porto Romano apo Portin e Vlorës, është shoqëruar **pashmangshmërisht me pabarazi në kushtet e veprimeve tregtare**, duke favorizuar ndërmarrjet me fuqi ekonomike dhe financiare që kishin dhe kanë mundësi të ngrenë depozitat e veta, mundësisht pa kredi apo të marrin me qira. Por avantazhi i të parit(në rastin e marrjes së depozitave bregdetare me qira), siç e tregojnë ndërmarrjet që kanë

operuar në portin e Vlorës nuk është i përhershëm sidomos kur ndërmarrje të tjera ngrenë(ndërtojnë) depozita me burime të veta Por kjo (lindja e pabarazisë, pabarazi në krahasim me më parë), për të kaluar në kushtet e një barazie kur të gjithë operatorët zbatojnë ligjin, nuk do të thotë të mos kalohet në këtë metode të përpunimit të anijeve të gazit, me kushte më të larta sigurie dhe standarde bashkëkohore për mbrojtjen e mjedisit. Për rrjedhojë për gjykimin dhe vlerësimin tim nuk është shprehje e abuzimit me pozitën dominuese, nga ana e ndërmarrjes “Romano Port” Sh.a. Siç e kam thënë edhe më lart, por edhe ne mendimet e pakicës te vendimeve të mëparshme të Komisionit që lidhen me këtë hetim, është kërkuar dhe kërkohej një hetim i plotë nga ana e grupit hetimor, mbi pabarazitë (natyrën dhe sidomos shkaqet e tyre) që janë shfaqur në tregun e ngarkim shkarkimit të gazit të lëngët. Por ky hetim nga grupi i punës është jo i plotë dhe mungojnë provat për zbulimin e lidhjeve shkakësore abuzim me pozitën dominuese të Romano Port SHA dhe rritjes së peshës së ndërmarrjeve të lidhura A&V GAZ SHA, në tregun e shkarkimit depozitimit dhe tregtimit të gazit të lëngshëm. Pavarësisht nga shtrirja jo e vogël kohore që ka vazhduar hetimi i thelluar, ai është realizuar duke u ndalur vetëm në ato që thuhet në pikën 37, 38, 39 mbi ndryshimet strukturore dhe indeksin HHI që kanë ndodhur gjatë periudhës kohore 2009-15 Shtator 2011. Por siç pohohet në pikën 37 të vendimit “Struktura e tregut të importit të GLN, ka patur ndryshime të forta strukturore gjatë periudhës kohore 2009-15 Shtator 2011, **si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë së ngarkim shkarkimit dhe depozitimit**” Pra nga Grupi Hetimor por dhe vetë Vendimi i Komisionit nuk ka provuar se ky ndryshim strukturor, në dobi të ndërmarrjeve të lidhura “Romano Port” SHA dhe A&V-Gaz SHA ka ndodhur si rezultat i Abuzimit me pozitën dominuese nga “Romano Port “ SHA, por pohohet se ka ndodhur si rezultat “ **si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë së ngarkim shkarkimit dhe depozitimit**” Ndërkohë nga ana ime si komisioner është kërkuar një hetim i plotë duke u ndalur në aspektet e akuzës të ngritur nga grupi i punës si vendosja e kushteve të kontratës të padrejta dhe të pabazuara në ligj nga ana e Romano Port. Për këtë u kërkuar provat dhe faktet se ku paraqiten psh kushtet e padrejta specifike për kontratat e realizuara midis “Romano Port “SHA dhe “Prima Gaz Albania” Sh.a. në vitet 2009 kur kjo e fundit ka rritur pjesën në strukturën e tregut të tregtimit të gazit të lëngët dhe në vitet vijuese kur kjo pjesë tregu ka rënë. Po kështu u kërkuar të provohet se cili është elementi abuziv i kontratës tip “Romano Port “ SHA në krahasim me përdorimin e kontratave tip nga portet simotra si ai i trageteve Durrës etj. Por këto e hetime dhe aq me teper sjellja e provave nuk janë realizuar, pa zbuluar lidhjen midis veprimtarisë së abuzimit me pozitën dominuese nga “Romano Port “ SHA nëpërmjet shpalljes me se një kontrate tip për të gjithë operatorët me ndryshimet në strukturën e tregut të gazit të lëngët. Ne datën 29 Gusht Romano Port SHA i u është drejtuar të gjithë Operatorëve Ekonomikë që kërkojnë të marrin shërbimin e transportimit të hidrokarbureve nëpërmjet Pontilit të drejt Depozitave të tyre në zonën e Porto Romano. Ndërkohe në seancat dëgjimore, Ndërmarrja Porto Romano ka qenë e hapur ndaj çdo rekomandimi të një kontrate tip që rekomandojnë institucionet përkatëse rregullator, ose kontratë që përdorin operatorët e ngjashëm me të. Por roli i Entit Rregullator dhe për rrjedhojë rekomandimet për të nuk u bënë objekt shqyrtimi as gjatë hetimit paraprak, as gjatë hetimit të thelluar dhe për rrjedhojë as objekt i rekomandimeve të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

Gjykoj se për një zgjidhje afatgjate të marrëdhënieve midis operatoreve në tregun e ngarkim shkarkimit të depozitimit të gazit të lënget dhe për një mirëfunksionim të tij në përputhje me standardet evropiane të sigurisë do ishte që enti rregullator -OSHA, të miratojë një kontratë tip të shqyrtuar dhe të detyrueshme, me e nga të gjitha palët.

6. Nisur nga sa me sipër kam mbajtur e mbaj qëndrim kundra edhe për sa i përket pjesës vendimmarrëse të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës si për sa Pikës I dhe nënpikat, A, B, C ashtu dhe pikës II, që ka të bëjë me gjobën, duke qenë dakord me pikat III dhe IV të vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

Gjykoj se për vete ndryshimet e mëdha strukturore që kanë ndodhur në tregun e ngarkim- shkarkim -depozitimit por dhe të tregtimit të gazit të lëngshëm, këto tregje të jenë objekti i vazhdueshëm monitorimi nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, duke ndjekur në mënyrë të posaçme dhe procesin e vendosjes së kasave dhe përdorimin e tyre dhe në tregun me pakice të gazit të lëngshëm

Për sa më sipër jap votën time kundra.

Komisioner
Koço Broka



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 222, Datë 11. 04 .2012

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.04.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL).

Baza ligjore: Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe ai 43, (pika 1) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Nisur nga njoftimet në media për një rritje në të njëjten ditë të çmimit të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike, dhe pas monitorimit të kryer nga Sekretariati i

AK, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 215, datë 10.02.2012 të Komisionit të Konkurrencës, “vendosi të miratojë hapjen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL), për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës.

2. Prane Autoritetit të konkurrencës në datë 13.02.2012, u depozitua një ankese nga Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit me subjekt “ZMK denoncon kartelin e sigurimeve : Rritja e çmimeve të sigurimeve për 300 mijë automjete është një shkelje e pastër e ligjit të konkurrencës.”
3. Në zbatim të këtij vendimi inspektoret e Sekretariatit të AK kanë kryer inspektime dhe kanë kërkuar informacion nga ndermarrjet që veprojnë në këtë treg si dhe nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

II. TREGU PËRKATËS

II.1 Tregun përkatës i produktit

4. Tregu i produktit është sigurimi i detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL). Ky produkt nuk mund të zëvendësohet me asnjë produkt tjetër për shkak të detyrimit ligjor specifik që i kërkohet poseduesit të mjetit motorik.

II.2 Tregu përkatës gjeografik

5. Tregu gjeografik në këtë rast është territori gjeografik i Republikës së Shqipërisë, pasi ky produkt është i vlefshëm vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

III. VLERËSIMI I SJELLJES SË NDËRMARRJEVE.

III.1 Primet e Sigurimit për periudhën Shtator 2011-Janar 2012

6. Nga analiza e konkurrencës në tregun e MTPL së brendshme konstatohet se ka një rritje të çmimeve gjatë periudhës 1-16 Shkurt 2011 nga ana e kompanive që operojnë në këtë treg. Kjo rritje është në masë të njëjtë për të gjitha ndermarrjet që veprojnë në këtë treg.
7. Rritja e menjëhershme e çmimeve ka nisur në datën 1 Shkurt 2012 kryesisht në produktin autoveturë me kapacitet motorik mbi 1600 Cm3 (klasa B1/2). Policat e shitura nga kompanitë Sigal Sha, Atlantik Sha, Sigma Sha, Albsig Sha, Intersig Sha, Interbalkan Sha, Eurosig Sha dhe INSIG SHA për klasën B1/2 kanë qenë me një çmim të rritur në 14 600 lekë¹. Para kësaj date çmimet në shitje rezultojnë për ndermarrjet nga 6 000 lekë deri në 7 800 lekë.
8. Për sa i përket klasës B1/1 të gjitha ndermarrjet kanë shitur me një çmim 10 000 lekë nga data 1 Shkurt. Rritja e çmimit për këtë klasë police ka vazhduar dhe deri në datën 14 Shkurt, çmimi për klasën B1/1 për të gjithë ndermarrjet ka qenë 14 000 lekë, përjashtojnë ndermarrjen Insig që ka vazhduar të shesë me 10 000 lekë këtë produkt edhe më vonë.

1 Në raste të caktuara ka shitje të MTPL edhe me çmime më të ulëta që realizohen për klientë të vecantë.

9. Edhe për klasat e tjera të policave të sigurimit ka patur një rritje të njëkohshme të çmimeve në periudhën 1-16 Shkurt duke konkluduar në të njëjtat çmime
10. Në bazë të legjislacionit për sigurimet², tarifat e primit të shitjes përcaktohen nga vetë shoqëritë duke marrë parasysh primin e rrezikut duke shtuar edhe shpenzimet administrative dhe fitimin që kompania pret të realizojë nga produkti MTPL e brendshme. Pra, primi i shitjes (çmimi përfundimtar) llogaritet duke i shtuar primit të pastër (primi i minimal i riskut miratuar nga AMF) komisionin e agjentit; shpenzimet e letrës; fitimin e shoqërisë; shpenzimet administrative. Vlerës totale që del i shtohet edhe TVSH (20%).
11. Në bazë të nenit 99 të Ligjit nr 9267, datë 29.07.2004, "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime", primi i sigurimit ose i risigurimit përbehet nga: a) pjesa e llogaritur për mbulimin e rrezikut të marre në sigurim i quajtur "primi i pastër"; b) pjesa e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve administrative; c) elementet e kursimit për klasa të caktuara të sigurimit të jetes; ç) pjesa e llogaritur për fitimin e shoqërisë, duke përfshirë fitimin nga investimi pa risk dhe investimi në sigurime me risk.
12. Në bazë të rregullores të miratuar me vendimin e bordit të AMF nr 11, datë 28.07.2010, "Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", në nenin 9 pika 2, përcaktohet se shoqëritë e sigurimit mund të zbatojnë tarifa më të ulëta se primi i rrezikut i përcaktuar nga AMF. Në këtë rast shoqëria duhet të depozitojë në AMF, së bashku me tarifat, edhe një plan biznesi, i cili duhet të përmbajë mënyrën dhe kohën e kompensimit të humbjes.
13. Për sa më sipër, rezulton se të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e MTPL-së së brendshme, duke filluar nga data 1 shkurt 2012 deri në datë 16 shkurt 2012, kanë rritur në të njëjten masë primin e sigurimit për të gjitha klasat e produktit MTPL e brendshme, gjë e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, germa (a) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, (shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si dhe në nenin 12 të Rregullores "Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës",

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL) ndaj 8 (tetë) ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg dhe konkretisht: INSTITUTI I SIGURIMEVE SHA, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA, SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP

2 Ligji Nr 10076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin në sektorin e transportit" i ndryshuar, Rregullorja Nr 110, datë 28.07.2011 "Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", etj.

SHA, INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP SHA, ALB - SIGURACION
SHA, ATLANTIK SHA, EUROSIG SHA, INTERALBANIAN SHA

- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2011 deri në 30.04.2012.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 223, Datë 11. 04 .2012

“Për përcaktimin e hapave të kryerjes së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshem motorrik ndaj paleve të treta (TPL)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|---|---------------------|---------|
| • | Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • | Servete Gruda | Anëtar |
| • | Koço Broka | Anëtar |
| • | Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 11.04.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Përcaktimi i hapave të kryerjes së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshem motorrik ndaj palëve të treta (TPL).

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të Vendimit 222, datë 11.04.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshem motorrik ndaj palëve të treta (TPL)”

VENDOSI:

- I. Përcaktimin e fazave të kryerjes së hetimit të thelluar si më poshtë vijon:
- a) Inspektime në ndërmarrjet nën hetim;
 - b) Mbledhja e informacioneve të nevojshme dhe plotësuese;
 - c) Përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur;
 - ç) Hartimi i Raportit të Ndërmjetëm brenda dy muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

- d) Diskutim i Raportit të Ndërmjetëm në Komision;
 - dh) Hartimi i Raportit Përfundimtar të Hetimit të Thelluar dhe paraqitja e tij përpara Komisionit brenda 15 diteve nga diskutimi në Komision I Raportit të Ndërmjetëm.
- II. Sekretari i Përgjithshëm të miratojë matricën e veprimeve të hetimit të thelluar sipas hapave të përcaktuar më sipër në këtë vendim.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 224, Datë 09.05.2012

“Për zgjedhjen e Zëvendeskryetarit të Komisionit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të dates 09.05.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Zgjedhja e Zëvendeskryetarit të Komisionit të Konkurrencës

Baza ligjore: Nenit 21, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, date 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

Komisioni i Konkurrencës:

VENDOSI:

1. Znj. Rezana Konomi zgjidhet Zevendeskryetare e Komisionit të Konkurrencës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

()

Anëtar

Koço BROKA

()

Anëtar

Rezana KONOMI

()

Anëtar

Iva ZAJMI

()

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

KRYETAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 225, datë 28.05.2012

“Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive të tregut sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për shërbimin e “Policës Kufitare të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|---------|
| • Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • Servete Gruda | Anëtar |
| • Koço Broka | Anëtar |
| • Rezana Konomi | Anëtar |
| • Iva Zajmi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 28.05.2012 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e Raportit të “Përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit mes 9 shoqërive të tregut të sigurimit mbi shkëmbimin e informacionit për shërbimin “Policë Kufitare e mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”.

Baza ligjore: Nenet 5, 24, shkronja d, neni 49 dhe neni 50 (pika 1), të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të :

- Raportit “Përjashtimin nga ndalimi të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur midis shoqërive të sigurimit për shkëmbimin e informacionit për produktin e sigurimit të detyrueshëm Policë Kufitare”,
- Relacionit shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm,

VENDOSI:

I. Procedura e ndjekur

Në datën 06.04.2012 Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 5 dhe 48 e në vijim të Ligjit ka marrë njoftimin nga përfaqësuesi i autorizuar i shoqërive “INSIG” Sh.a, “SIGMA VIG” Sh.a, “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” Sh.a, “INTERSIG VIG” Sh.a, “INTERALBANIAN VIG” Sh.a, “ATLANTIK” Sh.a, “EUROSIG” Sh.a dhe “ALBSIG” Sh.a”, për kërkesën për përjashtim nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit në tregun e sigurimeve të mjeteve motorike (Polica Kufitare) lidhur me shkëmbimin e informacionit për llogarritjen e dëmit, studimet e tregut dhe mbulimin e përbashkët të risqeve që rrjedhin nga mbajtësit e politës kufitare të sigurimit.

Me marrjen e informacionit të plotë është publikuar një njoftim paraprak për shtyp në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës për shprehjen e interesit nga palët e treta. Gjatë periudhës 15-ditore të publikimit nuk ka patur asnjë reagim nga palë të treta në adresat e publikuara të Autoritetit të Konkurrencës.

II. Palët në marrëveshje

Palët në marrëveshje janë të gjitha shoqëritë e sigurimit të cilat e ofrojnë produktin e policës kufitare të sigurimit të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palë të treta:

- Shoqëria e sigurimeve “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” Sh.a,
- Shoqëria e sigurimeve “SIGMA VIG” Sh.a,
- Shoqëria e sigurimeve “INSIG” Sh.a,;
- Shoqëria e sigurimeve “INTERALBANIAN VIG” Sh.a,
- Shoqëria e sigurimeve “INTERSIG VIG” Sh.a,
- Shoqëria e sigurimeve “EUROSIG” Sh.a,
- Shoqëria e sigurimeve “ALBSIG” Sh.a,
- Shoqëria e sigurimeve “ATLANTIK” Sh.a;

III. Përshkrimi i marrëveshjes

Marrëveshja e bashkëpunimit sipas përcaktimeve të udhëzimit të Komisionit të Konkurrencës “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale” është një marrëveshje standartizimi e cila ka si objekt përcaktimin e kërkesave teknike dhe cilësore me të cilat do të përputhet produkti i Policës Kufitare. Marrëveshjet e standartizimit kanë si objekt kryesor të tyre përcaktimin e kërkesave teknike ose cilësore me të cilat mund të përputhen produktet në qarkullim ose të ardhshme, proceset e prodhimit ose metodat.

Qëllimi i marrëveshjes do të jetë shkëmbimi i informacionit mes palëve për mbulimin e riskut të ardhur nga mbajtësit e policave kufitare, shkëmbimin e informacionit për primet e sigurimit, organizimin e studimeve të përbashkëta të tregut dhe shpërndarjen e këtyre rezultateve pa vonesë të të gjitha palët në marrëveshje. Gjithashtu palët në marrëveshje kanë rënë dakord që gjithë informacioni i mësipërm të njoftohet në baza periodike (të paktën një mujore) në Byronë Shqiptare të Sigurimeve.

IV. Tregu përkatës

IV.1. Tregu përkatës i produktit

Tregu përkatës i produktit përfshin Policat e Sigurimit të detyrueshëm të mjeteve të transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta. Në bazë të ligjit Nr. 10 076, datë 12.2.2009, sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit përfshin sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, që më poshtë do të referohet si sigurimi i pronarit, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti. Drejtuesi i mjetit motorik me regjistrim të huaj, i cili nuk ka një dokument ndërkombëtar të vlefshëm të sigurimit të përgjegjësisë, është i detyruar të lidhë kontratë për sigurimin e përgjegjësisë nga përdorimi i mjetit motorik (sigurim kufitar), të vlefshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe sigurimi kufitar i përgjegjësisë së mbajtësve të mjeteve motorike

Si konkluzion tregu përkatës i produktit përfshin Policat e Sigurimit Kufitar për përgjegjësitë ndaj palëve të Treta të drejtuesve të mjeteve motorike me targa të huaja për dëmet (materiale e jo materiale) që u shkaktohen palëve të treta gjatë qarkullimit rrugor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Kjo policë lëshohet për automjetet me targa të huaja dhe është produkt zëvendësues i kartonit jeshil (poseduesit e kartonit jeshil nuk kanë nevojë të zotërojnë një Policë Kufitare).

IV.2. Tregu përkatës gjeografik

Meqënëse produkti (shërbimi) përkatës ofrohet në të gjitha pikat e licensuara për tregtimin e policës kufitare, e atëherë si treg gjeografik do të jetë territori i Republikës së Shqipërisë.

V. Analiza e Konkurrencës

Tregu i sigurimeve të detyrueshme të përgjegjësisë ndaj palëve të treta është një treg i rregulluar dhe mbikëqyrur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bazë të ligjit organik 10076/2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar me ligjin 10455/2011. Sigurimi i mjeteve motorike bën pjesë në llojin e sigurimeve të detyrueshme të përgjegjësisë të palëve të treta për të mbuluar riskun e mundshëm të shkaktuar nga pala e parë (mbajtësi i policës së sigurimit).

Një nga llojet e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta është Polica Kufitare e cila zë një peshë specifike shumë të ulët në raport me totalin e tregut të sigurimeve të mjeteve motorike (5-6 për qind për tre vitet e fundit).

Sa i përket rivalitetit konkurrues për këtë produkt, rezulton se struktura e tregut nuk është e domonuar nga asnjëri prej konkurrentëve. Nga vlerësimi i indeksit të përqendrimit (HHI) për periudhën 2009-2011 (përkatësisht 1377, 1337, 1426) rezulton se indeksi është në nivelet e poshtme të një tregu me përqendrim të moderuar dhe ndryshimet e pjesëve të tregut mes kompanive tregojnë një treg dinamik sa i përket konkurrencës dhe pa fiksime apo ndarje të pjesëve të tregut.

Sipas të dhënave të AMF-së, ndërmarrja me pjese me te vogël Eurosig ka rritur pjesën nga viti në vit nga 8.81% në vitin 2008 në 14.88% në vitin 2011, si dhe ndërmarrja Sigma ka ulur pjesën e tregut nga 16.35 % në 10.45%. Ndërkohë ndërmarrja Sigal që ka pjesën më të madhe të tregut në sigurimet e detyrueshme, ka peshën më të vogël të policës kufitare ndaj totalit krahasuar me kompanitë e tjera.

Si konkluzion, tregu nuk është i dominuar nga një ose disa ndërmarrje dhe nga pjesët e tregut nuk rezulton që të ketë ndarje tregu apo kuzime të konkurrencës.

VI. Arsyet e përjashtimit nga ndalimi

Tregu i sigurimeve paraqet një sërë specifikash që duhet të merren në konsideratë gjatë aplikimit të legjislacionit të konkurrencës për shkak të riskut që e shoqëron këtë shërbim.

Marrëveshja e bashkëpunimit është një marrëveshje horizontale standartizimi e cila ka si mision rritjen e standarteve të emetimit dhe tregëtimit të policës kufitare të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike, përcaktimin e kërkesave teknike dhe cilësore me të cilat do të përputhet produkti i Policës Kufitare, eliminimin e produkteve të falsifikuara apo të shitjeve në rrugë si dhe rritjen e përgjegjshmërisë së palëve për përballimin e dëmeve nëpërmjet shkëmbimit të informacionit mes palëve.

Marrëveshja është transparente dhe me mbështetjen e autoriteteve publike (Byrosë Shqiptare të Sigurimeve) dhe nuk përjashton asnjë konkurrent nga tregu, as hyrësit e rinj të cilët njëlloj si ata ekzistues duhet të rrespektojnë standartet e vendosura nga autoritetet publike.

Kjo marrëveshje do të kontribuojë në :

1. Përmirësimin e kushteve të furnizimit të tregut;
2. Përmirësimin e cilësisë së shërbimit;
3. Eliminimin e policave nën standart (falso) dhe duke mbrojtur konsumatorët nga mashtrimet e mundëshme;
4. Shkëmbimin e informacioneve për pagesat e kryera nga dëmet e shkaktuara nga mbajtësit e Policës Kufitare që do të shmangte pagesat e dyfishta, të cilat rëndojnë financat e palëve;
5. Rritjen e sigurisë së klientëve për cilësinë e produktit dhe pagesat e dëmeve;
6. Uljen e rreziqeve të përkeqësimit financiar të palëve;

Pra, si konkluzion marrëveshja e propozuar për përjashtim nga shoqëritë e sigurimit dhe Byroja Shqiptare e Sigurimit për bashkëpunimin midis shoqërive të sigurimit ka për qëllim të ulë në mënyrë të ndjeshme risqet për kompanitë e sigurimeve nëpërmjet bashkëpunimit mes shoqërive të sigurimit për shkëmbimin e informacioneve mbi klientët, dëmet e shkaktuara dhe mënyrën e mbulimit të tyre dhe cdo informacion tjetër, shkëmbimi i të cilit nuk bie ndesh me parimet e konkurrencës së lirë në treg.

Nga zbatimi i kësaj marrëveshje priten disa përfitime për konsumatorët si mbrojtja nga policat e sigurimit kufitar të falsifikuara, rritja e sigurisë për pagesën e dëmeve, si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit.

VII. Kushtet dhe detyrimet

Autoriteti i Konkurrencës në gjykimin e këtij rasti i është referuar edhe Rregullores së Komisionit Evropian 267/2010, “Mbi aplikimin e nenit 101(3) të TFEU për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”.

Kjo rregullore parashikon përjashtimin nga ndalimi të një sërë kategorish marrëveshjesh, vendimesh apo praktika në tregun e sigurimeve kur në mungesë të database-ve të sakta palët bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacionit lidhur me: përcaktimin e provigjoneve të përbashkëta për riskun; vendosjen e kushteve dhe standarteve të përbashkëta të policës së sigurimit si dhe mbulimin e përbashkët të disa llojeve të riskut për produkte të reja.

Sipas analizës së bërë në raport, ky përjashtim, në bazë të nenit 50, pika 2 e ligjit, do të jepet me kushtet dhe detyrimet vijuese:

1. Afati i marrëveshjes të jetë 3 vjeçar

Marrëveshja e njoftuar kërkohet të përjashtohet për një periudhë 5 vjeçare, por Autoriteti i Konkurrencës mbështetur në mënyrën e funksionimit të database-it të të dhënave që përdorin aktuarët për vlerësimin e primit të riskut ka vlerësuar dhënien e përjashtimit për një periudhë më të kufizuar kohe prej tre vitesh.

2. Ndryshimet në pjesën e tekstit të marrëveshjes:

- Në nenin 1 të marrëveshjes, (germa a) hiqet pjesa e tekstit: “respektimi i tarifave bazë për primin e riskut të përbashkët bazuar në statistikat që zotërojnë shoqëritë e sigurimit” dhe kjo pikë ndryshohet me shprehjen “shkëmbimi i informacioneve për numrin e aplikimeve për përfitime nga dëmet”.
- Në nenin 3 të saj, të hiqet pjesa e tekstit: “shkëmbimin e informacionit statistikor që zotërojnë palët për përgatitjen e pasqyrave të primeve të sigurimit” dhe kjo pikë ndryshohet me shprehjen “shkëmbimin e informacionit statistikor që zotërojnë palët për përgatitjen e pasqyrave të primit të rrezikut”
- Nenit 4, i hiqet paragrafi parë i tij, titulluar “Primet e sigurimit”.

Këto ndryshime synojnë reduktimin e mundësisë së koordinimit të sjelljes dhe kanë si qëllim të shmangin një ndarje potenciale të pjesëve të tregut mes palëve njoftuese të marrëveshjes dhe në këtë mënyrë respektohen parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

VIII. Konkluzione

- 1 Tregu i sigurimeve është një nga sektorët e tregut financiar ku marrëveshjet mes operatorëve për qëllime të shkëmbimit të informacionit, mbulimit të riskut të përbashkët dhe standartizimit të produkteve mund të përfitojnë nga përjashtimi nga ndalimi sipas parashikimeve të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 9121, datë 28.03.2011 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
- 2 Marrëveshja e bashkëpunimit e njoftuar është një marrëveshje horizontale standartizimi e cila nuk kufizon ndjeshëm konkurrencën dhe, përmbush kushtet e parashikuara në nenin 5 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, duke përmirësuar shpërndarjen dhe cilësinë e shërbimit për produktin e policës kufitare.
- 3 Marrëveshja e njoftuar për përjashtim ka marrë parasysh parashikimet e ligjit të konkurrencës dhe ka si mision rritjen e standarteve të emetimit dhe tregimit të policës kufitare të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike.
- 4 Qëllimi është vendosja e standartit të shitjes, shmangjes së informalitetit dhe rrjedhimisht kryerjen e një shërbimi sa më efektiv në trajtimin e dëmeve nga secili operator.
- 5 Marrëveshja sipas udhëzimit të Komisionit të Konkurrencës “Për përjashtimin e marrëveshjeve individuale” klasifikohet si një marrëveshje horizontale standartizimi pasi ka qëllim standartizimin e produktit përkatës. Marrëveshja pritet të sjellë disa përfitime për konsumatorët si mbrojtja nga policat e sigurimit kufitar të falsifikuara, rritja e sigurisë për pagesën e dëmeve, si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit.
- 6 Sa më lart, marrëveshja e njoftuar për përjashtim nga ndalimi kontribon në rritjen e standartit të tregimit të produktit “Policë Kufitare e Sigurimit të Detyrueshëm të

Përgjegjësitë të Palëve të Treta”, dhe:

- a. nuk përmban kufizime të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse,
- b. nuk kufizon në mënyrë të ndjeshme konkurrencën në lidhje me këtë produkt dhe:
- c. konsumatorët përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përmirësimi i këtij produkti.

PËR KËTO ARSYE :

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 24, (shkronja d); 5; 50; dhe 51, (germa b); të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,(i ndryshuar),

V E N D O S I:

1. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit për ofrimin e shërbimit të Policës Kufitare të Sigurimit të Detyrueshëm të mjeteve motorrike për Përgjegjësitë ndaj Palëve të Treta, midis shoqërive të sigurimit: “INSIG” Sh.a, “SIGMA VIG” Sh.a, “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” Sh.a, “INTERSIG VIG” Sh.a, “INTERALBANIAN VIG” Sh.a, “ATLANTIK” Sh.a, “EUROSIG” Sh.a dhe “ALBSIG” Sh.a”.
2. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
 - 2.1 Afati i vlefshmërisë së kësaj marrëveshje do të ndryshohet nga 5 në 3 (tre) vjet pas hyrjes në fuqi të përjashtimit nga ndalimi.
 - 2.2 Në nenin 1 të marrëveshjes, (germa a) hiqet pjesa e tekstit: “respektimi i tarifave bazë për primin e riskut të përbashkët bazuar në statistikat që zotërojnë shoqëritë e sigurimit” dhe kjo pikë ndryshohet me shprehjen “shkëmbimi i informacioneve për numrin e aplikimeve për përfitime nga dëmet”.
 - 2.3 Në nenin 3 të saj, të hiqet pjesa e tekstit: “shkëmbimin e informacionit statistikor që zotërojnë palët për përgatitjen e pasqyrave të primeve të sigurimit” dhe kjo pikë ndryshohet me shprehjen “shkëmbimin e informacionit statistikor që zotërojnë palët për përgatitjen e pasqyrave të primit të rrezikut”
 - 2.4 Nenit 4, i hiqet paragrafi parë i tij, titulluar “Primet e sigurimit”.
3. Hyrja në fuqi e përjashtimit do të jetë pas njoftimit në Komisionin e Konkurrencës të Marrëveshjes objekt-vendimi, me ndryshimet sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit prej shoqërive pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
5. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat e parashikuara në rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr.226, datë 08.06.2012

“Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA për revokimin e vendimit nr. 222, datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2012 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA për revokimin e vendimit nr. 222, datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palave të treta (MTPL)”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, gërma d, dhe neni 46.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA për revokimin e vendimit nr. 222, datë 11.04.2012, të Komisionit të Konkurrencës,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 222, datë 11.04.2012 ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj paleve të treta (MTPL).

Lidhur me këtë vendim ka paraqitur kërkesë për revokimin e tij ndërmarrja “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA, me anë të shkresës së saj nr. 2556 prot. datë 24.05.2012.

Kërkesa e ndërmarrjes “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA për revokimin e vendimit nr. 222, datë 11.04.2012 nuk përmbush asnjë nga kërkesat e parashikuara nga neni 46 i Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pra është e pabazuar në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma d, nenin 46 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA për revokimin e vendimit nr. 222, datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palave të treta (MTPL)”;
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 222, datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palave të treta (MTPL)”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi shoqërisë “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()

Zv/Kryetare

()

Anëtare

()

Anëtar

()

Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.227, datë 28.06.2012

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të 100 % të kapitalit themeltar nga shoqëria Audi Aktiengesellschaft tek shoqëria Ducati Motor Holdings S.p.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.06.2012 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit themeltar nga shoqëria Audi Aktiengesellschaft tek shoqëria Ducati Motor Holdings S.p.A.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 2, nenet 10-12, 13 dhe 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Audi Aktiengesellschaft /Ducati Motor Holdings S.p.A, dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni i përqendrimit realizohet me anë të ‘Marrëveshjes për shitjen e aksioneve’ e nënshkruar ndërmjet palëve Internatinonal Motorcycles S.p.A dhe Audi AG, më datë 18 Prill 2012.

Me anë të këtij transaksioni shoqëria blerëse Audi AG do të përftojë kontrollin e vetëm ekskluziv mbi shoqërinë target Ducati Motor Holding S.p.A, duke përftuar 100% të kapitalit themeltar dhe të gjitha asetet duke përfshirë edhe shoqëritë e kontrolluara nga Ducati.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën ndryshimit të pronësisë. Gjithashtu përqendrimi njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit për sa i përket xhirove (neni 12/1) dhe është njoftuar brenda afatit të parashikuar (neni 12/2).

2. Palët në transaksion

- Audi Aktiengesellschaft në cilësinë blerësit, është një shoqëri me ofertë publike, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit gjerman, me seli në adresën: 85045 Inglostandt, Gjermani. Shoqëria është aktive në dizajnmin, prodhimin, ofrimin dhe shpërndarje e automjeteve, në veçanti në segmentin Premium. Gjithashtu shoqëria ka edhe aktivitete dytësore që lidhe kryesisht me prodhimin dhe shitjen e pjesëve të këmbimit për automjetet.
- Ducati Motor Holdings S.p.A, në cilësinë e shitësit është një shoqëri me e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit italian me seli në adresën: Via Antonio Cavalieri Ducati, 40132 Bologna, Itali. Ducati është aktive në projektimin, prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e motoçikletave. Gjithashtu kryen në mënyrë dytësore, shoqëria është aktive në ofrimin e pjesëve të këmbimit, aksesorëve dhe mallrave.

3. ANALIZA E KONKURENCËS

Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në përqendrim në tregun ndërkombëtar për vitin 2011 është afërsisht 28,607 miliard Lek:

- Xhiro e Grupit Volkswagen– XXX milion EUR() = XXX miliard Lek .
- Xhiro e Grupit Audi – XXX milion EUR = XXX miliard Lek.
- Xhiro e Grupit Ducati– XXXX EUR = XXX miliard Lek.

Ndërkohë, xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në përqendrim në tregun e brendshëm, për vitin 2011 është XXXX Lek:

Në Shqipëri, grupi Volkswagen është prezent nëpërmjet shoqërisë të kontrolluar, Porsche Albania Sh.p.k , e cila u pë pjesë e tij më 1 Mars 2011.

Për vitin 2011, xhiro e Porsche Albania Sh.p.k rezulton XXXX Lek.

Ndërkohë Ducati ka realizuar shitje me vlerë minimale xxx EUR / Lek, shitje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me artikuj të cilët mbajnë logon Ducati si bluza me mëngë të shkurtra, çanta, xhaketa.

3.1. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

a) tregu i produktit, dhe b) tregu gjeografik.

3.1.a Tregu i produktit:

Aktiviteti ekonomik i Audi-t (së bashku dhe me kompaninë mëmë të tij, Volkswagen AG) është zhvillimi, prodhimi, marketingu dhe shitja e mjeteve motorrike, si psh automjete pasagjerësh, mjete të lehta tregtare, kamionë, autobuzë, duke përfshirë këtu edhe pjesët e këmbimit, aksesorët dhe motorët e këtyre mjeteve motorrike.

Ducati disenjon, prodhon, dhe shet motorçikleta përfshirë këtu dhe aksesorët apo pjesët e tyre të këmbimit.

Referuar veprimtarisë së palëve, analiza e efekteve që do të sjellë transaksioni në fjalë do të përqendrohet në tregun e motorçikletave.

3.1.b Tregu përkatës gjeografik:

Për analizimin dhe vlerësimin e efekteve që do të shkaktojë ky transaksion në tregun përkatës të produktit, treg përkatës gjeografik është konsideruar Tregu kombëtar.

3.2 Struktura e tregut dhe vlerësimi i konkurrencës

Ducati nuk ka shoqëri të kontrolluar në Shqipëri dhe as nuk është prezent në tregun e motorçikletave nëpërmjet palëve të treta importuese apo shpërndarëse të kësaj marke. Nga ana tjetër, as Audi dhe as ndonjë shoqëri tjetër e kontrolluar nga Grupi Volkswagen/ Grupi Porsche, qoftë në nivel ndërkombëtar ashtu dhe në atë kombëtar, nuk është aktive në tregun e prodhimit apo shitjes së motorçikletave.

Porsche Albania, pjesë e grupit Volkswagen, e cila operon në tregun e brendshëm operon vetëm në tregun e automjeteve/ mjeteve të pasagjerëve dhe mjeteve të lehta tregtare. Si rrjedhim, ky transaksion nuk sjell asnjë mbivendosje të aktivitetit të palëve pjesëmarrëse në nivel horizontal dhe as tregje të prekura. Realizimi i tij nuk pritët të ketë ndonjë ndikim në tregun e brendshëm. Struktura e tregut të motorçikletave në Shqipëri apo pozicioni i shoqërive të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në këtë treg nuk ndryshon.

Edhe në nivel vertikal ky transaksion nuk shfaq shqetësime për konkurrencën jo vetëm sa i takon tregut të brendshëm por edhe atij ndërkombëtar, pasi pjesët e këmbimit, motorët, aksesorët e prodhuar nga Audi, apo kompani të tjera të grupit Volkswagen apo Porsche nuk janë të përshtatshme teknikisht për motorçikletat. Për më tepër, asnjë nga kompanitë e sipërpërmendura nuk prodhojnë apo ofrojnë pjesë për prodhimin e motorçikletave.

Përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të 100 % të kapitalit themeltar nga shoqëria Audi Aktiengesellschaft tek shoqëria Ducati Motor Holdings S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr.228, datë 28.06.2012

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përthithjes së shoqërive Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a nga shoqëria Geci Sh.p.k”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.06.2012 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përthithjes së shoqërive Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a nga shoqëria Geci Sh.p.k.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 13, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit ” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Geci Sh.p.k / Albanian Consortium Sh.a / Sky 2009 Sh.a dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjes mbi bashkimin me përthithje të shoqërive Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a nga shoqëria përthithëse Geci Sh.p.k” të

datës 13 Dhjetor 2011, me anë të së cilës shoqëria Geci Sh.p.k ka realizuar përthithjen e shoqërive Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a në një njësi të vetme ekonomike.

Transaksioni realizohet në formën e bashkimit me anë të përthithjes i cili në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja a) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (Ligji) është përqendrim, sjell ndryshim të kontrollit në ndërmarrjet target (Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a)

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/a të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën e bashkimit me përthithje. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12.1 të Ligjit përse i përket xhirove.

2. Palët në transaksion

- Geci Sh.p.k, në cilësinë e Shoqërisë Përthithëse është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar. Objekti i shoqërisë është (i) kryerja e investimeve në fushën e ndërtimit, kryesisht në infrastrukturën rrugore, ndërtimit të rrugëve kryesore, autostrada, superstrada, ura, ujësjellësa e kanalizime, ndërtime civile dhe industriale si shkolla , ndërtesa etj.
- Albanian Consortium Sh.a, në cilësinë e Shoqërisë së Përthithur është një shoqëri që vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar. Objekti i shoqërisë është (i) zhvillimi i aktivitetit të hoteleri-turizmit, administrim hotele, motele, fshatra pushimi, plazhe, vende argëtimi, ushqimi dhe freskimi, sporti, ushqimi dhe aktivitete të tjera me natyrë turistike brenda dhe jashtë vendit; (ii) kryerja e aktiviteteve të publikimit dhe reklamimit etj.
- Sky 2009 Sh.a, në cilësinë e Shoqërisë së Përthithur është një shoqëri që vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar. Objekti i shoqërisë është ushtrimi i veprimtarisë në fushën e hotelerisë dhe turizmit si dhe të aktivitetit të pjesëmarrjes në kapital.

3. Analiza e Konkurrencës

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është 0 Lekë:

- Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në transaksion në tregun e brendshëm është: XXX Lekë:
 - o Albanian Consortium Sh.a : XXX Lekë;
 - o Sky – 2009 Sh.a: X Lekë;
 - o Geci Sh.p.k: XXX Lekë;

4. TREGU PËRKATËS

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

a) *tregu i produktit, dhe b) tregu gjeografik.*

a) *Tregu i produktit:*

Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do të konsiderohet shërbimi i hotelerisë/ akomodimi në hotele.

II. Tregu gjeografik

Për analizimin e këtij rasti treg gjeografik është konsideruar tregu lokal, pra qyteti i Tiranës së bashku me komunat që e rrethojnë.

5. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Shoqëria Geci sh.p.k është aktive në tregun e ndërtimit në Shqipëri, ndërsa shoqëria Albanian Consortium sh.a në tregun e akomodimit në hotele. Si rrjedhojë, nuk kemi mbivendosje të veprimtarive ekonomike të palëve në Shqipëri, dhe as tregje të prekur nga ky transaksion në nivel horizontal, pasi dy shoqëritë operojnë në tregje të ndryshëm të produktit.

Albanian Consortium operon vetëm me hotelin Tirana International Hotel & Conference Center, duke zënë më pak se 9% të tregut të akomodimit në hotele në Tiranë dhe rrethinat e saj. Transaksioni i bashkimit nuk sjell ndryshim të strukturës së tregut të hotelierisë në Tiranë pasi kemi të bëjmë vetëm me një ndryshim pronësie. Pas realizimit të përqendrimit pjesa e tregut e Tirana International Hotel & Conference Center nuk ndryshon.

Edhe pas realizimit të këtij transaksioni Tirana International Hotel & Conference Center do të vazhdojë të hasë konkurrentë të fortë në treg si marka internacionale hotelesh ashtu edhe operatorë vendas. Ndër konkurrentët më kryesorë për nga kapaciteti, shërbimet dhe niveli i çmimeve, do të jenë Hotel Sheraton dhe Rogner Hotel EuropaPark. Këta konkurrentë janë pjesë e rrjeteve të hoteleve ndërkombëtare, ku pjesa e tyre e përafërt e tregut me Tirana International Hotel duhet parë edhe në perspektivën e fuqisë së tyre financiare/ ekonomike, shtrirjes së tyre ndërkombëtare, emrit të mirënjohur të markës së tyre, experiencës dhe nivelit të shërbimeve që ata ofrojnë.

Pozicioni në treg i Tirana International Hotel & Conference Center edhe pas përqendrimit nuk do ta lejonte të vepronte në mënyrë të pavarur nga konkurrentët apo klientët e tij. Prezenca e limituar (vetëm nëpërmjet një hoteli) në tregun e akomodimit në hotele tregon fuqinë e tij të kufizuar si blerës domethënës i shërbimeve të lidhura me hotelierinë në Shqipëri.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese për shkak të përqendrimit ndërmjet shoqërive Geci Sh.p.k, Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin të realizuar nëpërmjet përthithjes së shoqërive Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a nga shoqëria Geci Sh.p.k.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 229, Datë 03.07.2012

Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë “Geci” shpk për njoftimin jashtë afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përthithjes së shoqërive Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|------------|
| • Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • Rezana Konomi | Zv/Kryetar |
| • Servete Gruda | Anëtar |
| • Koço Broka | Anëtar |
| • Iva Zajmi | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 28.06.2012 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e relacionit mbi njoftimin jashtë afatit ligjor të përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të 60% të aksioneve të Hotel Tirana International tek shoqëria GECI Sh.p.k.

Baza ligjore: Nenet 10, 12, 24, shkronja d, neni 71 të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe rregullorja e Komisionit të Konkurrencës “Për gjrobat dhe lehtësimin prej tyre”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm për njoftimin jashtë afatit ligjor të përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të 60% të aksioneve të Hotel Tirana International tek shoqëria GECI Sh.p.k.,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

Autoriteti i Konkurrencës pasi është njohur nga media me transaksionin e transferimit

të 60% të aksioneve të Hotel Tirana International tek shoqëria GECI Sh.p.k e zotëruar 100% nga personi fizik dhe aksioner ekzistues, ka vlerësuar se transaksioni përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10, pika 1 germa b të Ligjit nr. 9121 'Për mbrojtjen e konkurrencës', i ndryshuar (Ligji).

Me anë të shkresës me Nr. 41 Prot., datë 20 Janar 2012, Autoriteti i Konkurrencës i ka kërkuar shoqërisë përthithëse Geci Sh.p.k njoftimin e përqendrimit, pasi plotësonte kriteret e neneve 10 dhe 12 të Ligjit duke theksuar se përqendrimi në bazë të nenit 14, pika 1 germa a e Ligjit nuk realizohet para njoftimit në Autoritetin e Konkurrencës.

Përfaqësuesi i shoqërisë përthithëse Geci Sh.p.k, me shkresën Nr. 41/1 Prot të datës 26 Janar 2012 ka depozituar njoftimin e përqendrimit me objekt bashkimin me përthithje të shoqërive Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a nga shoqëria Geci Sh.p.k;

II. Njoftimi i përqendrimit në shkelje të afatit ligjor

Nga administrimi i formularit të përqendrimit dhe marrëveshjes së nënshkruar rezulton se përqendrimi objekt-kontrolli është realizuar me anë të "Marrëveshjes për bashkimin më përthithje" e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në datë 13 Dhjetor 2011;

Në bazë të neni 12 pika 2 dhe nenit 53 pika 1, germa b të Ligjit, ndërmarrjes përfituese të kontrollit Geci Sh.p.k i ka lindur detyrimi ligjor për njoftimin e përqendrimit, brenda afatit 30 ditor nga lidhja e marrëveshjes, pra brenda datës 13 Janar 2012.

Në fakt njoftimi i përqendrimit të realizuar është bërë vetëm pas kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës dhe është depozituar në protokollin e Autoritetit të Konkurrencës me datë 26 Janar 2012, pra në shkelje të afatit ligjor të parashikuar në nenin 12, pika 2 të Ligjit;

Përqendrimi i realizuar është njoftuar jashtë afatit ligjor të parashikuar në nenin 12 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, që në kuptim të nenit 73, pika 1, shkronja dh, e Ligjit cilësohet si shkelje e lehtë dhe është e dënueshme më gjatë në masën deri në 1 % të xhiros totale të vitit financiar paraardhës.

III. Konkluzione

Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar se në këtë proces, pala njoftuese Geci Sh.p.k nuk ka patur dijeni për njoftimin e përqendrimit dhe e ka realizuar atë vetëm pas kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës dhe megjithëse në mënyrë të fragmentuar, në kohë ka bashkëpunuar me Autoritetin e Konkurrencës.

Megjithëse njoftimi është bërë jashtë afatit, sjellja e shoqërisë Geci Sh.p.k ka qenë bashkëpunuese për të përmbushur detyrimet ligjore si për njoftimin ashtu edhe për dhënien e informacionit në lidhje me këtë procedurë të kontrollit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të Ligjit dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës, në vendimmarrjen e tij synon zbatimin e ligjit dhe të advokacisë së konkurrencës si instrumente kryesore për konkurrencën e lirë dhe efektive në treg dhe rritjen e kulturës së konkurrencës.

Duhet theksuar se përqendrimi i realizuar nuk sjell asnjë efekt anti-konkurrenues në tregun përkatës të shërbimeve të hotelerisë, pasi ndërmarrja përthithëse nuk ka tregje të prekura me ndërmarrjen e përthithur, pasi veprojnë në tregje të ndryshme dhe përqendrimi është në formën e ndryshimit të kontrollit pa efekte në strukturën e tregut

PËR KËTO ARSYE :

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 24, (shkronja d); nenit 12, pika 2, nenit 53, pika 1, germa a, nenit 73, pika 1, germa dh e Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,(i ndryshuar), dhe nenit 12 të rregullores “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”

V E N D O S I:

1. Të gjobisë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë ndërmarrjen GECI Sh.p.k për njoftimin e përqendrimit të realizuar në shkelje të afatit ligjor.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

(_____)
Zv/Kryetare

(_____)
Anëtare

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 230, Datë 05.07.2012

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.05.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.
Ligji Nr. 8485 datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, si dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

KONSTATOI:

I. Procedura e ndjekur

1. Në zbatim të Vendimit nr. 204, datë 14.11.2011, të Komisionit të Konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës ka zhvilluar një hetim paraprak në tregun e shërbimit të telefonisë fikse të kartave me parapagesë.

II. VLERËSIMI I KONKURRENCËS NË TREG

II.1. TREGU I PRODUKTIT

II.1.a. Tregu përkatës i produktit

2. Për të përfutur produktin/shërbimin e thirrjes me kartë me parapagesë në telefoninë fikse, operatorët e autorizuar nga AKEP që ofrojnë këtë shërbim OSHKP duhet të përdorin:
 - ***Tregun errjedhës sipërme***, i cili përfshin tregun e aksesit (origjinim, terminim dhe tranzitim), që ofrohet vetëm nga operatori OFNT, ALBTELECOM.
3. Operatorët e licencuar për ofrimin e shërbimit të kartës së parapaguar në telefoninë fikse duhet të sigurojnë aksesin nëpërmjet rrjetit të Albtelecom. Karta me parapagesë e telefonisë fikse shërben për përdoruesin fundor kryesisht për të realizuar thirrje ndërkombëtare. Operatorët që ofrojnë shërbimin e kartës me parapagesë mund ta marrin shërbimin e origjinimit nga OFNT Albtelecom me çmime të rregulluara nga AKEP. Ndërsa shërbimi i terminimit dhe tranzitimit mund të sigurohet edhe nga operatorë të tjerë jashtë vendit me çmime tregu.
 - ***Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës në rrjedhën e sipërme të tregut.*** Operatorët e shërbimit të kartave të parapaguara – OSHKP, aksesin për shërbimin e origjinimit e sigurojnë vetëm nga Albtelecom ndërsa shërbimi i terminimit/tranzitimit sigurohet edhe nga operatorë të tjerë jashtë vendit.
4. Por meqenëse shërbimi që ofron OSHKP-ja nuk mund të kryhet pa realizuar më parë origjinimin, shërbimi i aksesit është i pazëvendësueshëm nga ana e ofertës. Pra tregu është inelastik.
 - ***Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës në rrjedhën e sipërme të tregut.*** Kërkesa për shërbimin e aksesit do të kryhet nga OSHKP të cilat pavarësisht nga rritja e tarifës së origjinimit për të realizuar shërbimin e kërkuar janë të detyruar ta realizojnë vetëm nëpërmjet Albtelecom. Pra, tregu është inelastik dhe i pazëvendësueshëm nga ana e kërkesës.
 - * Tregu i rrjedhës së poshtme, përfshin produktin/shërbimin kartë me parapagesë në telefoninë fikse. Karta me parapagesë është një produkt që në vetvete përfaqëson një kartë që konsumatori e përdor për të realizuar thirrje që janë kryesisht ndërkombëtare por mund të jenë lokale dhe kombëtare. Secila nga kartat ofrohet nga operatorët e licencuar për këtë shërbim nga AKEP-i.
5. Shërbimi kryhet nëpërmjet kartës së parapaguar e cila përmban një kod të caktuar (0800XXXX) që formohet nga konsumatori në një telefon fiks dhe lejon hyrjen në rrjetin e Albtelecom dhe njëkohësisht identifikon në platformë se kujt operatori i përket. Më pas përdoruesit i kërkohet të formojë numrin e kartës duke ndjekur instruksionet dhe duke futur edhe PIN-in përkatës. E gjithë koha që nga formimi i numrit deri në momentin e thirrjes së suksesshme quhet kohë e tarifimit, që do të thotë se përdoruesi i kartës është tarifuar për të gjithë kohën e këtyre veprimeve. Zakonisht kartat me parapagesë shiten nga distributorët të kontraktuar me OSHKP-të. Operatorët aktiv në tregun e telefonisë fikse me karta të parapaguara - OSHKP janë: Albtelecom, Primo, Abissnet, Mediatel, Alban Tirana dhe ASC¹. Ndërsa në bazë të regjistrimit pranë AKEP kanë njoftuar për ofrimin e shërbimit të kartave me parapagesë 18 sipërmarrës.

1 Shkresa AKEP nr 27/1, date 6.02.2012

- ***Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës në tregun e rrjedhës së poshtme.*** Shërbimi i kartës me parapagesë së telefonisë fikse përdoret për të realizuar kryesisht thirrje ndërkombëtare, por edhe lokale e kombëtare. Ky shërbim është i zëvendësueshëm nga ana e ofertës me anë të shërbimit të telefonisë fikse, telefonave publik, mobile, skype, VOIP, internet etj. Pra, tregu është elastik dhe shërbimi i zëvendësueshëm nga ana e ofertës.
 - ***Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës në tregun e rrjedhës së poshtme.*** Shërbimin me kartë të parapaguar në telefoninë fikse e ofrojnë gjithsej shtatë operatorë: Albtelecom, Primo, Abissnet, Mediatel, Alban Tirana dhe ASC. Përdoruesi i kartës me parapagesë ka mundësi të zgjedhë se cilin produkt/kartë do të përdorë, në varësi të çmimit, cilësisë etj. Pra tregu në rrjedhën e poshtme është elastik nga ana e kërkesës dhe plotësisht i zëvendësueshëm.
6. Pra, tregu përkatës i produktit është tregu i ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartës të parapaguar, i cili përfitohet nëpërmjet aksesit (origjinim, terminim dhe tranzitim).

II.1.b. Tregu përkatës gjeografik

- 7 Kartat me parapagesë mund të përdoren në të gjithë telefonat fiks, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pra tregu gjeografik përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë.

II.2. POZITA DOMINUESE E ALBTELECOM SHA

- 8 Ndërmarrja Albtelecom sh.a. në tregun e rrjedhës së sipërmë zotëron 100% të tregut të origjinimit, pa të cilin nuk mund të realizohet shërbimi i kartës me parapagesë të telefonisë fikse. E shpallur me fuqi të ndjeshme në treg nga AKEP me vendimin nr.1348, datë 26.07.2010, dhe në bazë të vlerësimit të bërë sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, rezulton se ndërmarrja ALBTELECOM SHA ka pozitë dominuese në tregun e aksesit, për shkak të pjesëve në tregun përkatës, konkurrencës potenciale, fuqisë kundërvepruese të blerësve, pengesat e hyrjes në treg, barrierat ekonomike që ekzistojnë, fuqisë ekonomike të saj dhe nga karakteristikat e tjera të tregut.
9. Bazuar në informacionin e ardhur nga AKEP, nuk ka pjesë tregu të specifikuar për kartat me parapagesë, pasi analizat e zhvilluara në tregun e telefonisë fikse janë trajtuar në mënyrë të përgjithshme për thirrjet telefonike. Kështu thirrjet e origjinuara drejt platformave OSHKP përbejnë 4% të thirrjeve totale telefonike të pajtimtarëve të Albtelecom.

III. ANALIZA E KONKURRENCËS

III.1. STRUKTURA DHE PJESËT E TREGUT

- 10 Për ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse me parapagesë janë të pajisura me “Autorizim të përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” nga AKEP 18 ndërmarrje. Sipas informacioneve të sjella nga shoqëritë², nga AKEP dhe Albtelecom rezulton se në treg për vitin 2011 këtë veprimtari e

2 Shkresa AKEP nr 27/1, date 6/02/2012

ushtrojnë vetëm 7 ndërmarrje.

11. Pas daljes së vendimit të AKEP nr. 1348, me miratimin e tarifave të rritura operatorët kanë ulur të ardhurat e realizuara për vitin 2011, madje kanë ulur interesin për te vazhduar biznesin në ofrimin e këtij shërbimi.
12. Nga te dhenat e administruara vërehet se numri total i thirrjeve me anë të kartave me parapagesë të telefonisë fikse nga operatorët që ofrojnë këtë shërbim është ulur nga 502151 thirrje për vitin 2010 në 424663, pra tregu në total është zvogëluar.
13. Nga të dhënat vihet re disa nga OSHKP-te kanë fituar pjesë tregu kështu operatori Alban Tirana në vitin 2011 ka 58% të tregut krahasuar me 46% në vitin 2010, operatori Mediatel më kartën Jona ka 19% të tregut ndërsa në vitin 2010 ka patur 18%, karta ALBLUE nga 3% në vitin 2010 është 6% në vitin 2011, karta Tring ka patur 1% në vitin 2010 është bërë 3% në vitin 2011, karta Qylfon ka patur 1% në vitin 2010 është bërë 2% në vitin 2011. Gjithashtu shoqëritë RSA, Sprig, Dimal kanë dalë nga tregu në vitin 2011.
14. Numri i thirrjeve të origjinuara në platformën e Albtelecom nga operatorët që ofrojnë shërbimin e kartës me parapagesë në telefoninë fikse dhe të ardhurat nga ky aktivitet nuk shkojnë në përpjesëtim të drejtë. Pra, ndërkohë që numri i thirrjeve është rritur të ardhurat kanë rënë³. Ky fenomen vihet re pas daljes së vendimit të AKEP-it, gjë që i ka vendosur në vështirësi OSHKP-të.
15. Aktiviteti i Albtelecom, si OSHKP me anë të kartës Alblue është i vështirë/i pamundur për tu bërë pasi nuk mbahet në llogari të veçantë, por në të njëjtën llogari me shërbimet e tjera që Albtelecom ofron për përdoruesit e tij.
16. Kjo ka bërë që edhe përdoruesit e kartave të telefonisë fikse me parapagesë, pas hyrjes në fuqi të vendimit të AKEP, të kenë kohë më të shkurtër bisede për kartat e përdorura, pavarësisht se çmimi i shitjes së tyre nuk ka ndryshuar.
17. Nga të dhënat e siguruara nga OSHKP-të dhe Albtelecom sha u informuam në lidhje me çmimin e shitjes për thirrje nga kartat përkatëse dhe koston minimale të nevojshme për realizimin e një thirrje (origjinim+terminim+tarifa fikse për thirrje) të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të strukturës e koston.
18. Në rrjedhën e poshtme të tregut/tregun me pakicë të kartave me parapagesë në telefoninë fikse, ka konkurrencë pasi janë disa operatore që ofrojnë këtë shërbim në këtë nivel tregu.
19. Nga analiza e tregut vihet re se çmimi i shitjes së produktit me anë të kartës Alblue të Albtelecom është i përafërt me koston minimale të nevojshme që OSHKP-të duhet të paguajnë për realizimin e një thirrje të suksesshme. Konkretisht bazuar në tabelën e më sipërme, çmimi i shitjes për klientët e kartës Alblue për destinacionin Angli është 8.32 lek/min ndërkohë që kosto minimale e nevojshme për realizimin e kësaj thirrje nga OSHKP- të shkon nga 7.3 lek/min deri 16.25 lek/min. Por, meqenëse këto çmime janë në varësi të tarifave të përcaktuara në vendimin e AKEP nr.1348, tarifat e përcaktuara dhe të rritura pothuajse mbi 200%, nuk janë të orientuara drejt koston, çka do të thotë që konkurrentët në rrjedhën e poshtme të tregut të kenë marzhe, apo hapësira për të krijuar të ardhura/përfitime nga biznesi shume të ulëta,

3 Në takimet e realizuara me shoqëritë na sqaruan se nqs një telefonatë e realizuar nuk kalon një limit të caktuar kohor ath kjo telefonatë nuk gjeneron të ardhura. Pra kjo vertetohet edhe nga grafiket e realizuar me lart ku numri i thirrjeve eshte ne rritje ndërkohë që të ardhurat janë në rënie.

gjë që vë në vështirësi zhvillimin e biznesit.

20. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se kjo dukuri, deformohet nga vendimi i AKEP për rritjen e tarifave. Pra në këtë rast sjellja e Albtelecom sha kushtëzohet nga vendimi i AKEP-it, i cili ka bërë që të kufizohen hapësirat konkuruese për operatorët OSHKP. Në këto kushte vërehet se nuk jemi para situatave të përshkruara në dispozitat e nenit 43 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 231, Datë 05.07.2012

“Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.05.2012, shqyrtoi çështjen me

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.

Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

KONSTATOI:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 204, datë 14.11.2011 vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë dhe me synim identifikimin në se kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

I. KUADRI LIGJOR RREGULLATOR

2. Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë rregullohen me anë të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim të përcaktuar në nenin 1 të tij parimin e asnjësisë teknologjike, promovimin e konkurrencës dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike si dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në RSH.
3. Operatorët e shërbimit të kartave me parapagesë (OSHKP), për të ushtruar veprimtarinë e tyre në ofrimin e shërbimeve elektronike, duhet të pajisen paraprakisht nga AKEP-i me një Autorizim të Përgjithshëm për të patur të drejtën e ofrimit të këtyre shërbimeve.
4. Këta operatorë, OSHKP, për të kryer veprimtarinë e tyre duhet të kenë patjetër akses dhe interkoneksion në rrjetin e ndërmarrjes ALBTELECOM SHA, duke marrë nga kjo ndërmarrje origjinimin, terminimin apo tranzitimin e thirrjeve. Aksesit dhe interkoneksioni janë të rregulluar në Ligjin Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe një ndër kompetencat e AKEP-it, e përcaktuar në nenin 8, pika (b) është rregullimi i aksesit dhe interkoneksionit midis rrjeteve të komunikimeve elektronike, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe të sigurojë që sipërmarrësit të mos diskriminohen dhe të kenë mundësi të barabarta, kushte transparente, objektive dhe të ndershme.
5. Në zbatim të nenit të mësipërm, AKEP-i ka miratuar Rregulloren Nr.19, datë 14.06.2010 “Për aksesin dhe interkoneksionin”, e cila ka si qëllim të nxitë dhe nëse është e nevojshme të detyrohet realizimi i aksesit dhe interkoneksionit, si dhe bashkëveprimi i shërbimeve, duke synuar nxitjen e konkurrencës së qëndrueshme dhe efçente, për përfitim maksimal të përdoruesve fundorë.
6. Referuar nenit 4 të kësaj Rregulloreje, të gjithë operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike kanë të drejtën dhe, kur iu kërkohet nga operatorët e tjerë të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike dhe /ose ofruesit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, detyrimin për të negociuar me njëri-tjetrin për akses dhe interkoneksion tek rrjetet e tyre respektive. AKEP-i vendos mbi operatorët me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për të ofruar akses dhe interkoneksion sipas procedurave të neneve 31-42 të Ligjit “Për Komunikimet Elektronike”, gjithashtu ky detyrim mund të vendoset edhe ndaj operatorëve që nuk kanë fuqi të ndjeshme në treg, nëse kjo është e nevojshme për të siguruar lidhjet.
7. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në zbatim të kompetencave të tij të përcaktuara në Ligj, ka hartuar Dokumentin “Analizë e Tregut të Telefonisë Fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjete fikse: Në zbatim të Analizës së mësipërme, duke vlerësuar dhe pozitën në tregjet përkatëse të sipërmarrësit ALBTELECOM SHA, Bordi Drejtues i AKEP-it, me Vendimin Nr.1348, datë 26. 07. 2010 Për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse” (Vendimi Nr. 1348), ka vendosur të përcaktojë sipërmarrësin Albtelecom Sh.a., sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në (i) tregun me pakicë për shërbimet ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruara nga vendndodhje fikse, për klientët jo-familjare, (ii) tregun përkatës të origjinimit të thirrjeve nga vendndodhje fikse dhe (iii) tregun përkatës të tranzitimit

të thirrjeve kombëtare në rrjet fiks. Zona gjeografike e tregjeve përkatëse me FNT është kombëtare apo territori i Republikës së Shqipërisë.

II. FUNKSIONIMI I TREGUT TË KARTAVE ME PARAPAGESË

8. Sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga AKEP-i (akep.gov.al), janë 18 shoqëri tregtare (operatorë) të licencuara për ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse me kartat e parapaguara (OSHKP). Këta operatorë, për të kryer veprimtarinë e tyre e kanë të domosdoshëm aksesin në rrjetin e ndërmarrjes ALBTELECOM SHA, pasi klientët e tyre duhet të kenë një numër telefoni fiks për të përdorur kartat me parapagesë të OSHKP.
9. Elementët kryesorë që nevojiten për të ofruar thirrje (shërbime) telefonike (fikse) me karta me parapagesë në nivel pakice janë origjinimi i thirrjes, tranzitimi i thirrjes midis centraleve tranzite dhe terminimi i thirrjes. Për të ofruar shërbime telefonike me pakicë një OSHKP mund t'i blejë këto elemente veç e veç ose së bashku, t'i prodhojë të gjitha vetë duke ndërtuar një rrjet gjithëpërfshirës, ose të blejë disa elemente dhe të prodhojë të tjerat.
 - Origjinimi i thirrjes përfshin përcjelljen e thirrjes nga linja e përdoruesit fundor deri tek elementi tjetër i thirrjes (tranzitim apo terminim) në central lokal apo tranzit.
 - Tranzitimi përcjell thirrjet telefonike nga centrali lokal deri ne elementin e terminimit të thirrjes në central lokal apo tranzit. Tranzitimi përfshin të paktën një central tranzit.
 - Terminimi i thirrjes përcjell thirrjen telefonike nga centrali lokal apo tranzit tek linja e përdoruesit fundor.
10. Fillimisht klienti në telefonin fiks formon numrin 0 801, pastaj formon prefiksin e OSHKP-së, i cili është një numër me 3 shifra, më pas formon numrin PIN të kartës me parapagesë dhe në fund formon numrin e telefonit që dëshironi të telefonojë të ndjekur nga butoni #. Për kryerjen e një thirrjeje të suksesshme këta operatorë shfrytëzojnë terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve në rrjetin ALBTELECOM, kjo në varësi të drejtimit të thirrjes.
11. Shërbimi i telefonisë fikse me karta te parapaguara kryhet nëpërmjet marrëveshjeve të Interkoneksionit që operatorët të cilët ofrojnë këtë shërbim lidhin me ndërmarrjen ALBTELECOM SHA. Ky i fundit zotëron facilitetet e nevojshme për aksesin, terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve, me anë të të cilave operatorët e tjerë të tregut kryejnë apo ofrojnë për klientët shërbimin e kartës me parapagesë.
12. Tarifat e shërbimit të origjinimit, terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve për bartësit e thirrjeve nëpërmjet zgjedhjes/parazgjedhjes së bartësit dhe për ofruesit e shërbimeve me kartë të parapaguar, të ofruara nga ndërmarrja ALBTELECOM SHA, janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP-i, i cili në Vendimin Nr.1348 ka rregulluar ato, duke vendosur tarifën maksimale të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetin ALBTELECOM për periudhën deri më 21.08.2010 dhe për periudhën nga 01.09.2010 dhe në vazhdim.
13. Tarifat e origjinimit, terminimit dhe tranzitimit nga data 01.09.2010 kanë pësuar një rritje të ndjeshme, pasi referuar Analizës së AKEP, tarifën me shumicë të ALBTELECOM SHA (interkoneksioni) rezultojnë të jenë nën-koston e ofrimit eficient BULRAIC (sipas rezultateve të modelit BULRAIC publikuar në faqen e internetit të AKEP), gjithashtu aplikimi i një tarife fikse për thirrje është i justifikuar nga kostot e vendosjes së thirrjes (set up) dhe karakteristikë në shumë vende të BE-së.

14. Gjithashtu referuar Analizës së AKEP-it: “.....tarifat e ALBTELECOM për shërbimet me pakicë të ofruara pajtimtarëve dhe për shërbimet me shumicë të interkoneksionit kanë qenë nën-rregullim për një kohë të gjatë në Albtelecom, dhe AKEP gjykon se është e nevojshme dhe e justifikueshme që tarifat me shumicë dhe me pakicë të Albtelecom të vazhdojnë të jenë nën-rregullim. Rregullimi i aplikuar deri më tani (përpara miratimit nga AKEP-i të Vendimit Nr.1348) është kryer pa pasur rezultate të kostove të shërbimeve të Albtelecom, dhe metodologjia e fundit është bazuar në tarifa benchmark, si dhe në praktikat më të mira për strukturën e kostove dhe tarifave, për një ribalancim gradual deri në përcaktimin e kostove të Albtelecom, i cili do të lejonte edhe një ribalancim më të shpejtë dhe të justifikuar”.
15. Sipas Vendimit Nr.1348, për ofruesit e shërbimeve me kartë të parapaguar, tarifat e origjinimit, terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve, aplikohen vlerat sipas segmentit përkatës dyfish në rrjetin Albtelecom. Pra, një Operator i Shërbimeve të Kartave të Parapaguara (OSHKP) nëse merr nga ndërmarrja ALBTELECOM SHA shërbimin e origjinimit të thirrjes paguan 3.5 lekë/min pa TVSH (4.2 lekë/min me TVSH), për shërbimin e terminimit të thirrjes paguan 3.5 lekë/min pa TVSH (4.2 lekë/min me TVSH) dhe për shërbimin e tranzitimit të thirrjes paguan 2.5 lekë/min pa TVSH (3 lekë/min me TVSH), si dhe për çdo thirrje paguan 0.83 lekë/thirrje pa TVSH (0.996 lekë me TVSH).
16. Kundër Vendimit Nr. 1348 të AKEP-it, kanë ushtruar Ankim administrativ Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatoreve (ZMK), Shoqata e Operatoreve Alternative, 7 Operatorë Alternative (“Alban Tirana Nascendo AL” sh.p.k, “Albanian Satellite Communications” sh.p.k, “Albfrut 2005” sh.p.k, “EJ & BI” sh.p.k, “Voskopit” sh.p.k, “Nisatel” sh.p.k, “FBD” sh.p.k), Vodafone Albania sh.a, AMC sh.a dhe Albtelecom sh.a.
17. Në ankimin e tyre operatorët alternative vlerësojnë se AKEP-i nëpërmjet Vendimit nr. 1348, ka rritur tarifat dhe ky vendim është diskriminues për Operatorët Alternativë duke dëmtuar rëndë aktivitetin e tyre, duke favorizuar Operatorët FNT nëpërmjet rritjes së çmimeve të shërbimit të interkoneksionit pa u bazuar në analizën e kostos, metodologjinë e rregullimit të tarifave, duke rënë në kundërshtim me vendimin Nr. 1182, datë 10.03.2010 ku tarifa e propozuar nga ALBTELECOM SHA është më e ulët nga tarifa e miratuar prej Këshillit Drejtues të AKEP. OFNT me argumentet e tyre për çmimet e ofruara në treg tregojnë të kundërtën e atyre që pretendohet nga vendimet e AKEP-it.
18. Këshilli Drejtues i AKEP-it, pas shqyrtimit të Ankimit të mësipërm, me Vendimin Nr. 1368, datë 28. 08. 2010 ka vendosur mos-pranimin e kërkesave të mësipërme për anulimin dhe/ose ndryshimin e tarifave të interkoneksionit të përcaktuara në vendimin Nr. 1348 dhe përcaktimeve të tjera të këtij vendimi.
19. Kjo rritje, që ka sjellë rritjen e tarifave për thirrje që ofrohet nga OSHKP-të, ka ardhur edhe si pasojë e vendimit të AKEP, i cili nuk është i orientuar nga kosto ashtu siç është përcaktuar nga metodologjia BULRAIC, por është përdorur metoda e kompensimit të tarifave. Pra me qëllim kompensimin e tarifave të pajtimit mujor në telefoninë fikse, të cilat aktualisht janë nën kosto nga AKEP është menduar të rriten tarifat e aksesit me qëllim që të kompensohen tarifat e pajtimit mujor te telefonisë fikse. Kjo bën që tarifat për shërbimet e aksesit të jenë të deformuara dhe të rëndojnë mbi operatorët të cilët duhet të marrin shërbimin e aksesit.
20. Ndërmarrja ALBTELECOM SHA, përveç shërbimeve të tjera në fushën e komunikimeve elektronike, duke filluar nga muaji Tetor 2009 ka filluar dhe ushtrimin e veprimtarisë në ofrimin e shërbimit të kartave me parapagesë, duke hedhur në treg kartën ALBLUE, për të cilën ankohet dhe ndërmarrja “ALBAN-TIRANA NASCENDO AL” SHPK.

21. Gjatë procedurës së hetimit paraprak u kërkua informacion për mënyrën e funksionimit të shërbimit të kartës ALBABLUE, pra në se ky aktivitet pasqyrohej/kontabilizohet në pasqyra të veçanta financiare. Nga përgjigja e ardhur rezultoi se ky aktivitet, pra shërbimi i kartave me parapagese mbahet i ndarë në llogari të veçantë, por nuk ndahet nga karta tjetër me parapagese që ofrohet (ALBRED-karta e parapaguar e përdorur në kartofonat-telefonat publike). Pra te dyja kartat paraqiten në një llogari të vetme. Kjo gjë e vështirëson punën për të kuptuar nëse ky aktivitet është fitimprurës apo është një aktivitet jofitimprurës.
22. Kjo mund të krijojë kushte të përshtatshme që një operator me pozitë dominuese/OFNT të zhvillojë aktivitete të cilat mund të mos jenë fitimprurëse për operatorin, por që ndërfinancohen/subvencionohen nga aktivitete të tjera fitimprurëse të OFNT-së, duke vendosur në vështirësi konkurrentët e tjerë që operojnë në të njëjtin nivel tregu.
23. Vendimi i AKEP nr.1348, nëpërmjet rritjes së tarifave ka ulur interesin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e kartës së parapaguar me ane të telefonisë fikse për të investuar në këtë treg, pasi norma e fitimit është shumë e ulët. Kjo ka për pasojë që përdoruesit e kartës me parapagesë në telefoninë fikse të kenë kohë bisede në dispozicion me të shkurtër për të njëjtin çmim të shitjes së kartës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. Të vendosë detyrimin për ndërmarrjen Albtelekom që gjithë shërbimet apo produktet që ALBTELEKOM ofron për konsumatorin të pasqyrohen apo të mbahen në llogari financiare të veçanta, duke përfshirë edhe kartën me parapagesë në telefoninë fikse ALBLUE. Kjo do të krijojë kushte që shërbimet/produktet të kenë transparencë në përcaktimin e kostove, si dhe do të parandalojë fenomenet antikonkurruese që mund të jenë pasojë e kostove joreale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e AKEP dhe Albtelekom.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 232, Datë 16.07.2012

Për një ndryshim në vendimin Nr. 218, datë 23. 02 .2012 “Mbi hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|------------|
| • Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| • Rezana Konomi | Zv/Kryetar |
| • Servete Gruda | Anëtar |
| • Koço Broka | Anëtar |
| • Iva Zajmi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 16.07.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Raportit të hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d); 26; 28, shkronja b) dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës,
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe materialeve të depozituara nga drejtori i Drejtorisë të Mbikëqyrjes së Tregut dhe ai i Drejtorisë Juridike e Çështjeve Ligjore.

VËREN SE:

1. Në tregun përkatës, transporti detar i pasagjerëve dhe mallrave Vlorë-Brindisi gjatë periudhës hetimore kanë ndodhur ndryshime strukturore. Njëri nga konkurrentët “FLANMARE LINES” INC nuk e ushtron aktivitetin për shkak të pezullimit nga

autoritetet italiane dhe në këtë mënyrë struktura e tregut ndryshon nga duopol në monopol.

2. Ardhja e sezonit të verës (“peak”) e gjen tregun përkatës me një operator të vetëm në kushtet kur kërkesa ka rritje të fortë dhe fuqia kundërvepruese e blerësve në tregun përkatës është e ulët.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Zgjatjen e afatit të hetimit praparak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe hartimin dhe paraqitjen e raportit të hetimit praparak jo më vonë se data 30.09.2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()
Zv/Kryetare

()
Anëtare

()
Anëtar

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 233, Datë 16.07.2012

**“Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/
importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.07.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i “Raportit të monitorimit në tregun e prodhimit/Importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”;

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- “Raportit të monitorimit në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Autoritetit të Konkurrencës në bazë të informacioneve se në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos dyshohej për një marrëveshje të fshehtë për rritjen e çmimit të çimentos, ka monitoruar tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të produktit çimento.
2. Në vijim të procedurës së monitorimit, Autoriteti i Konkurrencës kërkoi informacion nga Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, dhe ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të çimentos.”

II. Përshkrimi i situatës në tregun e çimentos

3. Tregu i importit të çimentos për periudhën Janar-Prill 2012 është një treg shumë i përqendruar pasi janë vetëm dy ndërmarrje që importojnë këtë produkt.
4. Tregu i prodhimit/shitjeve me shumicë për periudhën Janar – Prill 2012 është shumë i përqendruar. Në këtë treg janë 4 ndërmarrje të cilat prodhojnë/tregtojnë produktin çimento. Ky numër i vogël ofruesish të këtij produkti reflektohet në përqendrimin e lartë të tregut.
5. Tregu i çimentos shfaq barriera për hyrje të reja në treg si marrja e lejeve përkatëse minerare për shfrytëzimin e mineraleve ndërtimore të cilët përdoren si lëndë e parë për prodhimin e çimentos, leje mjedisore për instalimet e tyre të cilat mund të ndikojnë në shkarkimet dhe ndotjen etj...
6. Nga të dhënat e administruara rezulton se në një periudhë të caktuar të këtij viti, gjysma e dytë e muajit shkurt dhe fillimet e muajit mars, çmimi i shitjes së çimentos ka patur një tendencë rritjeje të fortë dhe drejt një çmimi rreth 60 euro/ton, që tregon që konkurrenca në treg mund të jetë kufizuar.

Sa më lart, sjellja e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 24, shkronja d si dhe nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.
2. Periudha objekt hetimi do të jetë nga 01.01.2012 deri në 30.09.2012 përfundimin e procedurave hetimore.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore dhe hartimin dhe paraqitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se 4 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()

Zv/Kryetare

Servete Gruda

()

Anëtare

Koço Broka

()

Anëtar

Iva Zajmi

()

Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 234, Datë 19.07.2012

Mbi miratimin e Rregullores
“Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe
praktikave të bashkërenduara”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.07.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e Projekt-Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”;

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, germa d) dhe dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Projektit të Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”,
- Relacionit shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm për këtë qëllim, dhe
- Opinioneve të paraqitura nga palët e interesuara:

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

(_____)
Zv/Kryetare

Servete Gruda

(_____)
Anëtare

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Iva Zajmi

(_____)
Anëtare**Lindita Milo (Lati)**

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 235, Datë 19.07.2012

Mbi miratimin e Rregullores
“Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.07.2012, shqyrtoi çështjen me

Objekt: Shqyrtimin e Projekt-Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike”;

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, geramat d) dhe dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Projektit të Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike”,
- Relacionit shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm për këtë qëllim, dhe
- Opinioneve të paraqitura nga palët e interesuara:

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorrike”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 236, datë 19.07. 2012

**Për miratimin e Udhëzimit
“Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.07.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar)

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Projekt Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe
- Opinioneve të paraqitura nga palët e interesuara:

VENDOSI:

1. Të miratojë Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi.

2 Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 237, datë 26.07.2012

“Mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet dy transaksioneve sipas të cilave shoqëritë Ost Holding Gmbh dhe Media Holding Beteiligungs AG i japin kontrollin e plotë mbi shoqërinë Media Vizion”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.07.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet dy transaksioneve sipas të cilave shoqëritë Ost Holding Gmbh dhe Media Holding Beteiligungs AG i japin kontrollin e plotë mbi shoqërinë Media Vizion aksionerëve Artan Dulaku, Genc Dulaku dhe Adrian Dulaku.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 2, nenet 10-12, 13 dhe 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet dy transaksioneve sipas të cilave shoqëritë Ost Holding Gmbh dhe Media Holding Beteiligungs AG i japin kontrollin e plotë mbi shoqërinë Media Vizion aksionerëve Artan Dulaku, Genc Dulaku dhe Adrian Dulaku dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi i realizuar është pasojë e dy marrëveshjeve:

- A. Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet shoqërisë Ost Holding GmbH dhe aksionerëve Artan Dulaku, Genc Dulaku dhe Adrian Dulaku më datë 14.05.2012 me objekt transferimin e 40 % të aksioneve të saj tek këta të fundit.
- B. Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet shoqërisë Media Holding Beteiligungs AG dhe aksionerëve Artan Dulaku, Genc Dulaku dhe Adrian Dulaku më datë 14.05.2012 me objekt transferimin e 27 % të aksioneve të saj tek këta të fundit

Ky transaksion, në kuptim të nenit 10/1/b dhe 12 të Ligjit është përqendrim që plotëson kriteret e xhiros dhe duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës.

Në këtë kuadër, ky transaksion i është nënshtruar procedurës së Kontrollit të Përqendrimeve, të parashikuara në Kreun e IV, nenet 53-64 të Ligjit dhe në “Rregulloren për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

II. Palët në transaksion

Media Vizion Sh.A në cilësinë e Blerësit është një shoqëri anonime e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar që prej vitit 2000, me seli në Tiranë. Objekti i shoqërisë është ushtrimi i veprimtarisë Radio – Televizive, i cili konsiston në krijimin e një rrjeti me një shtrirje në të gjithë vendin si nëpërmjet mbulimit direkt të territorit të republikës së Shqipërisë ashtu edhe nëpërmjet mbështetjes me median rajonale me shpërndarje, nëpërmjet valëve si dhe via kavo, prodhimin, tregtimin dhe shpërndarjen e programeve të ndryshme radio televizive si dhe çdo aktivitet tjetër radio televiziv.

Ost Holding GmbH (shitësi) i pjesës prej 40% të kuotave është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli në Vjenë dhe seli në Tuchlauben 17, 1014 dhe e regjistruar në regjistrin tregtar nën numrin FN 177252, Austri.

Media Holding Beteiligungs (shitësi) i pjesës prej 27% të kuotave është një shoqëri me seli në Zvicër

III. ANALIZA E KONKURRENCËS

Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në përqendrim në tregun ndërkombëtar për vitin 2011 është afërsisht XXXX miliard Lek e XXXX milionë lekë

- Xhiro e OST Holding GmbH = XXX euro (X 137.5 Lekë/eur)= XXX miliardë e XXX milionë lekë
- Xhiro e Media Holdings Beteiligungs = XXX mije franga (x114.5 CHF/leke)=XXX leke

Ndërkohë, xhiro totale e shoqërisë Media Vizion sh.a për vitin 2011 është XXX Lek, duke plotësuar në këtë mënyrë kriterin e xhiros në tregun e brendshëm.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

3.1 Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

a) tregu i produktit, dhe b) tregu gjeografik.

3.1.a Tregu i produktit:

Në tregun përkatës të produktit do të përfshihen të gjitha shërbimet dhe/ose produktet që ofron shoqëria objekt transaksioni pasi dy shoqëritë e tjera e ushtrojnë veprimtarinë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe për pasojë jashtë juridiksionit të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’, i ndryshuar.

Aktiviteti ekonomik i shoqërisë Media Vizion Sh.a është ushtrimi i veprimtarisë radio – televizive, e cila konsiston, në krijimin e një rrjeti me një shtrirje në të gjithë vendin si nëpërmjet mbulimit direkt të territorit të Shqipërisë ashtu edhe nëpërmjet mbështetjes me median rajonale me shpërndarje , nëpërmjet valëve si dhe via kavo, prodhimin, tregtimin, dhe shpërndarjen e programeve të ndryshme radio televizive si dhe çdo aktivitet tjetër radio televiziv.

3.1.b Tregu përkatës gjeografik:

Për analizimin dhe vlerësimin e efekteve që do të shkaktojë ky transaksion në tregun përkatës të produktit, treg përkatës gjeografik është konsideruar tregu kombëtar.

3.2 Struktura e tregut dhe vlerësimi i konkurrencës

Referuar të dhënave të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT)¹, operatorët televizivë të cilët transmetojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, janë televizioni publik, 2 televizione kombëtare, 73 televizione private vendore(ku bën pjesë Vizion plus) dhe dy televizione private dhe satelitore(ku bën pjesë Vizion + tv satelitor).

Sipas palës njoftuese, nga sondazhet e kryera nga Televizioni Vizion +, tre operatorët e tregut mediatik, konkurrentë kryesor të shoqërisë Media Vizion sh.a janë: Tv Publik Shqiptar; Tv Top Channel dhe Tv Klan. Kjo bazuar tek monitorimi i herëpashershëm i shitjes së kohës publicitare si burimi kryesor i shoqërive të cilat operojnë në këtë treg. Referuar Ligjit nr. 8410 “Mbi Radion dhe Televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, këto subjekte konsiderohen dhe si pjesëmarrëse të së njëjtës kategori, duke marrë në konsideratë dhe vlerën financiare të detyrimit të licencës vjetore për përdorimin e frekuencave të akorduara nga KKRT.

Nga të dhënat e M.C Monitoring , të mundësuar për palën njoftuese rezulton se të ardhurat më të mëdha nga reklamat e transmetuara i ka Tv Klan, i ndjekur nga televizionet Top Channel, Ora News, dhe Vizion Plus me 11 % te tregut.

Përfutjesit e kontrollit kanë pjesëmarrje në disa shoqëri shqiptare, kryesisht me objekt veprimtarie në fushën e ndërtimit duke mos shkaktuar mbivendosje të aktivitetit ekonomik

1 kkrt.gov.al

me shoqërinë objekt transaksioni. Gjithashtu përftuesit e kontrollit (z. Artan Dulaku, Adrian Dulaku, Genci Dulaku) zotërojnë së bashku rreth 77% të aksioneve të shoqërisë Albanian Satellite Communication (platformës private numerike satelitore Tring Tv) e cila është pjesë e një tjetër tregu përkatës (shërbimi televiziv me parapagese).

Ky transaksion nuk sjell ndryshime në strukturën e tregut pasi kemi të bëjmë vetëm me një ndryshim kontrolli në shoqërinë Media Vizion sh.a që nuk ka shkaqe të arsyeshme të shfaqjes së shenjave të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet dy transaksione sipas të cilave shoqëritë Ost Holding GmbH dhe Media Holding Beteiligungs AG i japin kontrollin e plotë mbi shoqërinë Media Vizion aksionerëve Artan Dulaku, Genc Dulaku dhe Adrian Dulaku.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()
Zv/Kryetare

()
Anëtare

()
Anëtar

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 238, datë 26.07.2012

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të plotë të kontrollit në shoqërinë V.D.M Invest Comm. VA, nëpërmjet blerjes së 99.99% të aksioneve nga shoqëria Japan Tobacco International Holding B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.07.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të plotë të kontrollit në shoqërinë V.D.M Invest Comm. VA, nëpërmjet blerjes së 99.99% të aksioneve nga shoqëria Japan Tobacco International Holding B.V.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (indryshuar), neni 24, shkronja d, neni 2, nenet 10-12, 13 dhe 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Japan Tobacco International Holding B.V / V.D.M Invest COMM. Va, dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të ‘Marrëveshjes për Shitje Aksionesh’ e lidhur më datë 23 Maj 2012, ndërmjet palëve GT & Co (askionerit të shoqërisë Target) dhe JT International Holding B.V (blerësi) me qëllim përfitim i kontrollit të V.D.M Invest Comm. VA dhe shoqërive të saj bija.

Transaksioni përfshin blerjen 99.99% të aksioneve të shoqërisë target dhe bijave të saj dhe si pasojë edhe kontrollin dhe menaxhimin në këto shoqëri.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën e ndryshimit të pronësisë. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit për sa i përket xhirove (neni 12/1) dhe është njoftuar brenda afatit të parashikuar (neni 12/2).

II. Palët në transaksion

1. Jappan Tobacco International Holding B.V (JTI Holding B.V), në cilësinë e blerësit, me seli në Hollandë, kryen aktivitet në fushën e prodhimit dhe shitjes së cigareve të prodhuara nëpërmjet makinerive gjithashtu edhe në prodhimin dhe shitjen e produkteve të tjera të duhanit përfshirë atë të dredhur, duhanin që thithet me hundë, purot dhe purot e holla.
2. V.D.M Invest Comm. VA në cilësinë e shoqërisë target, me seli në Belgjikë, është një biznes familjar në Flander-in perëndimor. Shoqëria target ofron një seri të gjerë përzierjesh dhe shijesh duke përfshirë dhjetë deri në pesëmbëdhjetë tipe duhani i cili kryesisht vjen nga Brazili, India, Indonezia, Malau, Zambia, Polonia, Italia, Franca.

III. ANALIZA E KONKURRENCËS

Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në përqendrim në tregun ndërkombëtar për vitin 2011 është XXX miliard Lekë:

- Japan Tobacco Group: XXX miliard JPY = XXX miliard Euro¹ = XXX miliard Lekë
- VDM Invest.: XXX milion Euro = XXX miliard Lekë

Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në përqendrim në tregun e brendshëm, për vitin 2011 është XXX miliard Lekë:

- JT International Tirana : XXX miliard Lekë
- VDM Invest ka realizuar shitje në vendin tonë me vlerë XXX Euro = XXX milion Lekë

¹ Periudha 01.04.2011-31.03.2012, Kursi i këmbimit 1JPY:0.00927 Euro. Kursi mesatar i këmbimit; 1 Euro= 140.33 lek Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.1. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

a) tregu i produktit, dhe b) tregu gjeografik.

3.1.a Tregu i produktit:

Japan Tobacco është aktive në prodhimin dhe shitjen e cigareve të prodhuara nëpërmjet makinerive përmes filialit të saj JTI HBV dhe filialet e kësaj të fundit (JTI). Në Shqipëri, JTI HBV është prezent vetëm në tregun e cigareve të prodhuara nga makineritë nëpërmjet filialit të saj, JT International Tirana Shpk. V.D.M Invest Comm. VA, shoqëria target e këtij transaksioni në nivel ndërkombëtar është prodhues dhe distributor i duhanit të dredhur. Veprimtaria e kësaj shoqërie në vendin tonë konsiston vetëm në shitjen e produkteve të saj (duhanit dridhe/ përgatite vetë) tek distributorët vendas.

Referuar veprimtarisë së palëve, analiza e efekteve që do të sjellë transaksioni në fjalë do të përqendrohet në tregun e cigareve të prodhuara nëpërmjet makinerive dhe duhanit me të dredhur.

3.1.b Tregu përkatës gjeografik:

Për analizimin dhe vlerësimin e efekteve që do të shkaktojë ky transaksion në tregun përkatës të produktit, treg përkatës gjeografik është konsideruar tregu kombëtar.

3.2 Struktura e tregut dhe vlerësimi i konkurrencës

Palët pjesëmarrëse në transaksion në vendin tonë nuk janë të pranishëm në të njëjtin treg përkatës produkti. JT International Tirana është prezent në tregun e cigareve të prodhuara nëpërmjet makinerive, ndërsa veprimtaria e shoqërisë target V.D.M Invest Comm. VA në vendin tonë konsiston vetëm në shitjen e produkteve të saj si duhani i dredhur. Kjo shoqëri nuk është prezent në tregun shqiptar nëpërmjet ndonjë shoqërie të zotëruar prej saj. Produktet e saj shiten nëpërmjet një distributori, i cili nuk zotërohet nga kjo e fundit.

Për vitin 2011 rezulton se JT International Tirana ka patur rreth 15% të tregut të importit të cigareve të prodhuara nëpërmjet makinerive. Konkurrentët kryesorë të JTI në këtë treg janë subjektet Philip Morris Albania Shpk (PM), AGNA dhe British American Tobacco Albania (BAT). Philip Morris Albania dhe AGNA ngelen kompanitë kryesuese në treg sa i takon importit me respektivisht rreth 31.4% dhe 30% të totalit të fijeve të cigareve të importuara

Për sa më lart, përqendrimi në fjalë nuk shkakton mbivendosje të aktivitetit të palëve dhe as rritje të pjesëve të tyre të tregut në nivel horizontal.

Sa i takon aspekteve vertikale, ekziston një marrëdhënie e kufizuar vertikale mes palëve në nivel ndërkombëtar. Në tregun e brendshëm, sa i takon shpërndarjes së produkteve, JT International Tirana e kryen vetë shpërndarjen dhe shitjen e produkteve të saj. Aktiviteti shpërndarës i saj është i limituar vetëm tek produktet e veta të duhanit. Ndërkohë, produktet e shoqërisë target VDM Invest COMM VA. shpërndahen në tregun tonë nëpërmjet një distributori tjetër, shoqërisë IGLA Shpk. Të dy shoqëritë përdorin kanale të ndryshme

shpërndarjeje dhe shitjeje të produkteve të tyre. Pra, nuk ka mbivendosje të aktivitetit të palëve dhe në këtë veprimtari.

Përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të plotë të kontrollit në shoqërinë V.D.M Invest Comm. VA, nëpërmjet blerjes së 99.99% të aksioneve nga shoqëria Japan Tobacco International Holding B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()

()

()

()

Zv/Kryetare

Anëtare

Anëtar

Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 239, datë 26.07.2012

Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë “Media Vizion” për njoftimin jashtë afatit të përqendrimit të realizuar

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.07.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e relacionit mbi njoftimin jashtë afatit ligjor të përqendrimit të realizuar nëpërmjet dy transaksione sipas të cilave shoqëritë Ost Holding Gmbh dhe Media Holding Beteiligungs AG i japin kontrollin e plotë mbi shoqërinë Media Vizion aksionerëve Artan Dulaku, Genc Dulaku dhe Adrian Dulaku.

Baza ligjore: Nenet 10, 12, 24, shkronja d, neni 71 të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe rregullorja e Komisionit të Konkurrencës “Për gjokat dhe lehtësimin prej tyre”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin jashtë afatit ligjor të përqendrimit të realizuar nëpërmjet dy transaksione sipas të cilave shoqëritë Ost Holding Gmbh dhe Media Holding Beteiligungs AG i japin kontrollin e plotë mbi shoqërinë Media Vizion aksionerëve Artan Dulaku, Genc Dulaku dhe Adrian Dulaku

V Ë R E N S E:

I. Procedura e ndjekur

Përqendrimi i realizuar është pasojë e dy marrëveshjeve:

- A. Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet shoqërisë Ost Holding GmbH dhe aksionerëve Artan Dulaku, Genc Dulaku dhe Adrian Dulaku më datë 14.05.2012 me objekt transferimin e 40 % të aksioneve të saj tek këta të fundit.
- B. Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet shoqërisë Media Holding Beteiligungs AG dhe aksionerëve Artan Dulaku, Genc Dulaku dhe Adrian Dulaku më datë 14.05.2012 me objekt transferimin e 27 % të aksioneve të saj tek këta të fundit

Ky transaksion, në kuptim të nenit 10/1/b dhe 12 të Ligjit është përqendrim që plotëson kriteret e xhiros dhe duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës.

Në këtë kuadër, ky transaksion i është nënshtruar procedurës së Kontrollit të Përqendrimeve, të parashikuara në Kreun e IV, nenet 53-64 të Ligjit dhe në “Rregulloren për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

II. Njoftimi i përqendrimit në shkelje të afatit ligjor

Njoftimi i përqendrimit është realizuar jashtë afatit ligjor të parashikuar në nenin 12/2 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Gjithsesi ky njoftim është bërë pas një periudhe të shkurtër kohe dhe transaksioni nuk ka efekte në treg në kuptim të ndryshimit të strukturës së tregut

Përqendrimi i realizuar nuk sjell asnjë efekt anti-konkurrues në tregun përkatës pasi përqendrimi shfaqet si një ndryshim kontrolli dhe nuk ka tregje të prekura dhe nuk ka efekte në strukturën e tregut (pra thjesht ka ndryshuar kontrolli në shoqërinë e përbërë dhe nuk ka bashkim mes ndërmarrjeve në treg që mund të sillte ndryshimin e pjesëve të tregut, indeksin e përqendrimit apo strukturës së tregut).

Njoftimi jashtë afatit ligjor të parashikuar në nenin 12 të Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës, që në kuptim të nenit 73 pika 1 shkronja dh e Ligjit cilësohet si shkelje e lehtë dhe është e dënueshme më gjatë në masën deri në 1 % të xhiros totale të vitit financiar paraardhës.

Megjithatë njoftimi është bërë jashtë afatit, sjellja e palës njoftuese ka qenë bashkëpunuese për të përmbushur detyrimet ligjore si për njoftimin ashtu edhe për dhënien e informacionit në lidhje me këtë procedurë të kontrollit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të Ligjit dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës në vendimmarrjen e tij synon zbatimin e ligjit dhe të advokacisë së konkurrencës si instrumente kryesore për konkurrencën e lirë dhe efektive në treg dhe rritjen e kulturës së konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 24, (shkronja d); nenit 12, pika 2, nenit 53, pika 1, germa a, nenit 73, pika 1, germa dh e Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), dhe nenit 12 të Rregullores

V E N D O S I:

1. Të gjobisë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë shoqërinë Media Vizion si njoftuese e përqendrimit të realizuar nëpërmjet dy transaksioneve sipas të cilave shoqëritë Ost Holding GmbH dhe Media Holding Beteiligungs AG i japin kontrollin e plotë mbi shoqërinë Media Vizion aksionerëve Artan Dulaku, Genc Dulaku dhe Adrian Dulaku.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()

()

()

()

Zv/Kryetare

Anëtare

Anëtar

Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 240, datë 26.07.2012

Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Nazëri – 2000” Sh.p.k, dhe “Dea Security” Sh.p.k për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.07.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e marrëveshjes në oferta ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazëri – 2000” Sh.p.k, dhe “Dea Security” për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d); neni 26; neni 4, pika 1; neni 74 pika 1, shkronja a) dhe neni 75, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”;
 Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të grupit të punës mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k,

“Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”, të hapur me Vendimin nr. 219, datë 16.03.2012 të Komisionit të Konkurrencës;

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Pretendimeve të ndërmarrjeve nën hetim “Eurogjici Security” sh.p.k, “Eurogjici Security 1” sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k, në Seancat Dëgjimore të datës 17/07/2012, si dhe ato me shkrim të dërguara pranë Autoritetit të Konkurrencës, përkatësisht me shkresat Nr. 503/1 Prot, datë 17.07.2012; Nr. 504 Prot, datë 17. 07. 2012; Nr. 505 Prot, datë 17.07.2012; Nr. 503 Prot, datë 17. 07. 2012; Nr. 506 Prot, datë 17. 07. 2012.

VËREN SE:

I. PROCEDURA

1. Procedura e ndjekur gjatë hetimit është bazuar në Kreun II dhe III të pjesës II të Ligjit Nr. 9121, datë 8.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (këtu e me poshtë “Ligji”) dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe të nenit 12 dhe 21, pika 4 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 219, datë 16.03.2012 të Komisionit të Konkurrencës vendosi: Hapjen e Hetimit të Thelluar në Tregun e Prokurimit të Shërbimit të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security”, “Eurogjici Security 1”, “Toni Security”, “Sajmiri AL”, “Nazeri 2000” dhe “Dea Security”, me objekt ekzistencën ose jo të marrëveshjeve në oferta që kufizojnë konkurrencën në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike për periudhën kohore 2009-2011.
3. Në bazë të vendimit Nr. 219, datë 16.03.2012 të Komisionit të Konkurrencës, Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me Ligjin dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës Raportin e Hetimit të Thelluar.
4. Raporti i hetimit të thelluar iu komunikua ndërmarrjeve: “Eurogjici Security”, “Eurogjici Security 1”, “Toni Security”, “Sajmiri AL”, “Nazeri 2000” dhe “Dea Security” me anë të shkresës Nr. 486 prot, datë 04/07/2012 të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.
5. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit palët nën hetim paraqitën pretendimet e tyre mbi raportin e hetimit të thelluar në seancat dëgjimore të mbajtura, si dhe me shkrim, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës.

II. PERIUDHA E HETIMIT DHE NDËRMARRJET NËN HETIM

6. Periudha e hetimit, e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr. 219, datë 16.03.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri

AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”, përfshin periudhën kohore 2009-2011.

7. Ndërmarrjet nën hetim janë përcaktuar në Vendimin Nr. 219, datë 16.03.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Ndërmarrjet nën hetim të përcaktuara në vendimin e mësipërm të Komisionit të Konkurrencës janë:
 - 1) Shoqëria **“Eurogjici Security” Sh.p.k**, me NIPT: K31929010K, me seli në: Rr. “Adem Jashari”, Lagjia nr. 8, Ndërtesa 4, Hyrja 10, Ap 3, Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë;
 - 2) Shoqëria **“Eurogjici Security 1” Sh.p.k**, me NIPT K72007048K, me seli në: “L.Prizrenit”, Tiranë;
 - 3) Shoqëria **“Toni Security” Sh.p.k**, me NIPT K94010201F, me seli në: Rr. “Adem Jashari”, Lagjia nr. 8, Pallati 4, Apartamenti 3, Tiranë;
 - 4) Shoqëria **“Sajmiri AL” Sh.p.k**, me NIPT K37508220Q; me seli në: Lagjia 5, Pranë Telekomit, Kukës.
 - 5) Shoqëria **“NAZERI – 2000” Sh.p.k**, me NIPT K31422029Q, me seli në: “Rruga Kavajes”, Qendra Condor, Kulla H, Ap 27, Tiranë;
 - 6) Shoqëria **“DEA SECURITY” Sh.p.k**, me NIPT K51521007J; me seli në: Rruga “Artin Basha”, përballë kompleksit “Çabej”, Kombinat, Tiranë;

III. STRUKTURA E TREGUT

8. Tregu përkatës, në bazë të nenit 3 pikës 7 të Ligjit dhe të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 76, datë 07. 04. 2008 “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës” përcaktohet në dy dimensione:
 - a. Tregu i produkteve
 - b. Tregu gjeografik

III.1 Tregu përkatës i produktit

9. Tregu i produktit përfshin tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, shërbim i cili ofrohet nga Shoqëritë e Shërbimit të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike (SHRSF) dhe ka për mision: sigurimin e objekteve publike e private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë; sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave fizikë, shtetas shqiptarë ose të huaj; shoqërimin e vlerave monetare e materiale ose të sendeve të çmuara gjatë transportimit të tyre.
10. Veprimtaria e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, përfshihet në kategorinë I.3 të shtojcës së Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Kjo veprimtari ndahet në dy nënkategori si vijon:
 - α) “Shërbime të ruajtjes së personave, objekteve e veprimtarive” me kodin I.3.A;
 - β) “Shërbime të ruajtjes, transportimit e shoqërimit të vlerave monetare e sendeve të çmuara” me kodin I.3.B.

11. Duke u bazuar në kriterin e zëvendësueshmërisë, si kriteri kryesor në përcaktimin e tregut përkatës, shërbime të zëvendësueshme nga ana e ofertës i ofrojnë të gjitha ndërmarrjet ofruese të shërbimit të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike. Ndërsa zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, përcaktohet në varësi të specifikimeve teknike që kërkojnë në një prokurim publik të organizuar nga ana e një Autoriteti Kontraktor.
12. Pra për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, **treg përkatës produkti është tregu i prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të përfshira në kodin I.3.A.**

III.2 Tregu gjeografik

13. Të gjitha ndërmarrjet nën hetim, janë aktive në tregun e produktit, nëpërmjet ofertimit të tyre, në të gjithë territorin e Shqipërisë. Për vlerësimin e impaktit që shkaktonte ofertimi, Tregu Gjeografik do të konsiderohet, Territori i Republikës së Shqipërisë.

IV. SJELLJA E NDËRMAREJVE NË TREG

14. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar për sjelljen e ndërmarrjeve nën hetim: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k” në tregun e Prokurimit të Shërbimit të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike, janë administruar një sërë evidencash për të parë sjelljen e tyre në treg, në këndvështrim të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
15. Nga analiza e konkurrencës në tregun e Prokurimit të Shërbimit dhe Ruajtjes së Sigurisë Fizike, bazuar dhe në Metodologjinë “Për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike” rezultoi:
16. Në dokumentat e dorëzuara nga Autoritetet Kontraktore mbi ofertat e Eurogjici Security, Eurogjici Security 1 dhe Toni Security, Nazeri 2000 dhe Dea Security (Irezan), bazuar edhe në Metodologjinë “Për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike” janë gjetur shenja të njëjta si:
 - ☐ Formularë të sigurimit të ofertës: lëshuar nga e njëjta kompani sigurimi; në të njëjtën datë; dhe numer serial të njëpasnjeshëm;
 - ☐ Vërtetim nga Zyra e Përmbarimit: lëshuar në të njëjtën datë; dhe me numera serial të njëpasnjeshëm;
 - ☐ Formulari i deklarimit të ofertës: i njëjti gabim drejtshkrimor, të njëjtin formulim, formatim dhe të njëjtën madhësi dhe lloj shkrimi;
 - ☐ Formulari çmimit të ofertës: i njëjti gabim drejtshkrimor, i njëjti format, me të njëjtin lloj shkrimi;
 - ☐ Vërtetim nga Tatimet: data e lëshimit e njëjtë, si dhe Nr. Prot. të njëpasnjeshëm;
 - ☐ Ekstrakti i Regjistrimit në QKR: data e lëshimit është e njëjtë;
 - ☐ Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e përmbarimit Tiranë: Data e lëshimit e njëjtë, numër prot. të njëpasnjeshëm;
 - ☐ Vërtetimi i lëshuar nga ISSH: Data e lëshimit e njëjtë, numër prot. të njëpasnjeshëm;
 - ☐ Deklaratë e grupit të gatshëm: me të njëjtën përmbajtje dhe titull të njëjtë.

17. Këto shenja dhe gabime të shumta, të evidentuara gjatë shqyrtimit të ofertave të paraqitura në prokurime të ndryshme nga ndërmarrjet nën hetim, tregojnë që përgatitja e ofertave për pjesëmarrjen në prokurimet publike është bërë nga një numër punonjësish të përbashkët të cilët punojnë ngushtësisht me njëri-tjetër, karakteristikë kjo e marrëveshjeve në oferta.
18. Nga evidencat e gjetura gjatë inspektimeve u konstatua se:
- α) Në ndërmarrjen “Eurogjici Security” janë gjetur dokumente tenderi të ndërmarrjeve “Toni Security”, “Eurogjici Security 1” në faza të ndryshme të përgatitjes së tyre. Dokumentat e gjetura ndërmarrjet “Eurogjici Security”, “Toni Security” dhe “Eurogjici Security 1” kanë: të njëjtën adresë të vendodhjes; numra tel/fax të njëjtë; salla operative të njëjta si dhe të njëjtët punonjës që merren me përgatitjet e dokumentave të tenderit. Kështu psh: në ambientet e “Eurogjici Security” është gjetur Draft shtes-kontrata të ndërmarrjes “Toni Security”, për vitin 2012, me Autoritetet Kontraktore, në procedurat e prokurimit të cilave është shpallur fitues dhe ka lidhur kontrata shërbimi gjatë vitit 2011, si: psh. “Universiteti Politeknik”. Këto draft shtes-kontrata përmbajnë numrat e protokollit dhe datat e kontratave kryesore të lidhura midis “Toni Security” dhe Autoriteteve Kontraktore të mësipërme, gjatë vitit 2011. Në secilën prej shtes-kontrateve gjendet e njëjta tabelë me emrat e punonjësve që merren me përgatitjen e dokumenteve të tenderit, e cila gjendet edhe në dokumentet për “Eurogjici Security” dhe “Eurogjici Security1”. Adresa e “Toni Security” në këto dokumente, si dhe nga vet stema e kësaj shoqërie, paraqitet e njëjtë me atë të ndërmarrjeve “Eurogjici Security” dhe “Eurogjici Security 1” në dokumentet e sipër përmendura: “Rruga “Adem Jashari” Lagjia nr. 8, Pall. 4, Ap.3”. Kjo në një kohë që Toni Security dhe Eurogjici Security kanë qenë konkurrentë në këtë tender. ***Të gjitha këto tregojnë se: përgatitja e ofertave për pjesëmarrjen në prokurimet publike të shoqërive në fjalë bëhet në të njëjtin vend (ndërmarrjen “Eurogjici Security”) dhe nga një numër punonjësish të përbashkët të cilët punojnë ngushtësisht me njëri-tjetër, karakteristikë kjo e marrëveshjeve në oferta***, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 4 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
- β) ***Në ndërmarrjen “Nazeri 2000” janë gjetur dokumentet e tenderave të “Dea Security” (Irezan)***, të lëshuara nga institucione të ndryshme shtetërore për efekt tenderi, të grupuara sipas Autoriteteve Kontraktore, të gatshme për t’u hedhur në sistemin on-line të prokurimeve. Nga shqyrtimi i këtyre dokumenteve të grupuara sipas ndërmarrjeve, për të njëjtët tendera, u vunë re shenja të ngjashme. Këto evidenca tregojnë që dokumentat janë përgatitur nga të njëjtët persona, në të njëjtin vend. Gjithashtu këto ndërmarrje përdorin edhe sallë operative të njëjtë. Kështu psh. Në ambientet e ndërmarrjes “Nazeri-2000” sh.p.k u gjenden, në formë të shkruar (kopje):
- Folderin me emer “2 TENDER ELEKTRONIK IRE-ZAN” ku gjenden dokumenta të skanuara nga origjinali të ndërmarrjes Dea Security (IRE-ZAN) të grupuara sipas autoriteteve kontraktore si: psh “Instituti i Statistikave Dt 21-07-2011”; Brenda foldera-ve me emërtimet e mësipërme gjenden dokumentet faktike, ekonomike dhe teknike të ndërmarrjes Dea Security (Irezan) të gatshme për t’u hedhur në sistemin elektronik të prokurimit. Në këtë tender të zhvilluar nga INSTAT me fond Limit 619 000 leke marrin pjesë në mënyrë të pavarur Irezan, Nazeri 2000, Tony security, Eurogjici dhe Eurogjici 1.

19. ***Ndërmarrjet nën hetim përdorin skemën e ofertës së mbuluar¹*** duke rënë dakord më përpara, se cili do paraqesë ofertën fituese në procesin e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët.

Vihet re se në rastet kur ofertues janë vetëm ndërmarrjet nën hetim, ofertat e paraqitura janë shumë afër fondit limit dhe lëvizin shumë pak njëra nga tjetra, duke realizuar objektivin e rritjes së ofertës fituese dhe si rezultat dhe shumës që fituesi i ofertës do të marrë. Është vërtetuar se në rastet kur pjesëmarrës në tender janë edhe ndërmarrje të tjera përveç atyre nën hetim, sjellja e ndërmarrjeve nën hetim ndryshon duke paraqitur oferta me një ulje domethënëse ndaj fondit limit krahasuar me rastet kur pjesëmarrës janë vetëm këto ndërmarrje nën hetim. Kështu psh:

- α) ***Në tenderin e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Drejtorja e Stacioneve Transmetuese RTV, datë 30/06/2011***, me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve të RTSH-së” për Lotin I: Drejtorja e Përgjithshme e RTSH-se, Drejtorja e Stacioneve Transmetuese, me fond limit: 20,039,800 lekë, pa TVSH; kanë marrë pjesë: “Eurogjici Security” dhe bashkimi i operatoreve “Toni Security & Nazeri 2000” dhe fiton Eurogjici Security me 99.99% të Fondit limit mbështetur nga “Toni Security & Nazeri 2000” me 99.99% të Fondit limit. Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga ofertuesit rezultoi se: dokumentat e dorëzuara nga ofertuesit “Eurogjici Security” Sh.p.k dhe bashkimit “Toni Security” & ”Nazeri 2000” kanë shenja të ngjashme. Kjo skemë tregon se kur pjesëmarrës në tender janë vetëm ndërmarrjet nën hetim vlerat e ofertave të paraqitura janë shumë afër fondit limit dhe me një ndryshim shume të vogël nga njëra tjetra.

Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga ofertuesit rezultoi se: Formulari i deklarimit të ofertës të dy konkurrentëve: “Eurogjici Security” – “Toni Security &Nazeri 2000”: kanë të njëjtin lloj shkrimi, datë të njëjtë, të njëjtin bold, underline, të njëjtat gabime drejtshkrimore;

Formulari i cmimit të ofertës të dy konkurrenteve “Eurogjici Security” – “Toni Security &Nazeri 2000”: kanë të njëjtin lloj shkrimi, i njëjti bold, i njëjti align text (majtas) dhe ne mes;

Formulari i sigurimit të ofertës të dy konkurrentë “Eurogjici Security” – “Toni Security &Nazeri 2000”: është e lëshuar nga e njëjta shoqëri sigurimi dhe në të njëjtën datë;

Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe termave të referencës të “Eurogjici Security” – “Toni Security &Nazeri 2000”: kanë të njëjtin lloj shkrimi, e njëjta date, te njëjtin bold, underline, te njëjtat gabime drejtshkrimore;

Deklaratë mbi konfliktin e interesave të “Eurogjici Security” – “Toni Security &Nazeri 2000”: Tek dy konkurrentet pjesa e plotësuar ka të njëjtin lloj shkrimi, e njëjta date, te njëjtin bold, underline, te njëjtat gabime drejtshkrimore.

- β) ***Në tenderin e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Universiteti Politeknik, datë 28/07/2011***, me fond limit 9,950,304 lekë; marrin pjesë “Toni Security” me vlerën 9,937,200 lekë; “Eurogjici Security” me vlerën 9,946,560; “Eurogjici Security 1” me vlerë 9,949,992; si dhe Therepeli (i skualifikuar) me vlerë 8.330.088 lekë dhe fiton Toni security me 99.87% të fondit limit mbështetur nga

1 Këto oferta njihen edhe si plotësuese, gentile, dhuratë. Kjo ndodh atëherë kur një ndërmarrje, pranon të ofertojë më lart se sa oferta e fituesit të zgjedhur. Ofertat e mbuluara kanë për qëllim të japin përshtypjen e një oferte të pastër dhe një konkurrence të sinqertë.

“Eurogjici Security” me 99.96% te Fondit Limit dhe Eurogjici Security 1 me 100% të Fondit limit. Sipas këtyre vlerave të paraqitjes së ofertave rezulton se ndërmarrjet nën hetim kanë zbatuar skemën e ofertës së mbuluar, duke paraqitur një ofertë më të lartë për të mbuluar ndërmarrjen fituese “Toni Security”.

Edhe në këtë rast, gjatë shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga ofertuesit në këtë tender është vënë re se ka shenja te ngjashme si: Formulari i Deklarimit të Ofertës tek te tre konkurrentet “Eurogjici Security”- “Toni Security”-“Eurogjici Security 1”: ka te njejtin lloj shkrimi, te njejten date, te njejten fjalë me bold;

Formulari i Cmimit të Ofertës: “Eurogjici Security”- “Toni Security”-“Eurogjici Security 1”: Tek të tre konkurrentët është i njëjti lloj shkrimi, i njëjti bold, i njëjti gabim tek fitimi i shoqërisë, preventivat e llogaritjes kanë te njejtin lloj shkrimi, thonjëzat e përdorura në përshkrimin e emrit janë të vendosura mbrapsht për të tre ndërmarrjet, si dhe tek përshkrimi i kontratës ka thonjëza vetëm mbyllëse për të treja;

Ekstrakti i Regjistrimit në QKR: Toni Security - Eurogjici Security 1”: Data e leshimit është e njëjta për te dy konkurrentet - 31.03.2011;

Vertetimi i leshuar nga Zyra e përmbarimit Tiranë: Eurogjici Security-Eurogjici Security 1: Data e leshimit është e njëjta për te dy konkurrentet 04.04.2011 dhe me numer të prot. të njepasnjëshëm 1752-1753;

Vertetimi i leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane për xhiron vjetore: “Eurogjici Security”, “Eurogjici Security 1”: Data e leshimit është e njëjta për te dy konkurrentet 25.03.2011;

Vërtetimi i leshuar nga Instituti i sigurimeve shoqërore për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore i Eurogjici Security dhe Eurogjici Security 1: Data e leshimit është e njëjta për te dy konkurrentet 26.01.2011; “Toni Security” - “Eurogjici Security 1”:

Janë paraqitur të njëjtat foto të punonjësve të shërbimit;

2 (dy) Fatura tatimore shitje me nr. të njepasnjëshëm 25 dhe 26, date 25.01.2011, njera e “Toni Security” dhe tjetra e “Eurogjici Security 1” në ane të cilave blejnë të njëjtat materiale nderlidhje nga firma Union shpk;

Kontratë qeraje me numër të njepasnjëshëm 290, 291, të datës 21.03.2011, midis “Toni Security, “Eurogjici Security 1” me “Eurogjici Security” me objekt të njëjtë “Dhënie me qera ambjenti për zyrë”; Deklaratë e grupit të gatshëm Toni Security, Eurogjici Security 1, Eurogjici Security shpk me përmbajtje të njëjte dhe titull të njëjtë;

Leje armësh kolektive lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë me nr. të njepasnjëshëm 979, 980, 981, 982 të datës 29.06.2010 lëshuar për Toni Security, Eurogjici Security 1. Shtojca nr. 5 dhe shtojca nr. 6 e të tre ndërmarrjeve Eurogjici Security- Toni Security- Eurogjici Security 1: ka të njëjtin format shkrimi;

Vërtetimi i Bankës për: “Eurogjici Security”, “Eurogjici Security 1”, “Toni Security” është lëshuar në të njëjtën datë për te tre ndërmarrjet 03.06.2011; për ndërmarrjet Eurogjici – Tony Security ky vërtetim është lëshuar nga e njëjta bankë, e njëjta degë, në të njëjtën datë. Dega ETC 043 – 03.06.2011.

Ndërsa kur pjesëmarrës janë ofertues të tjerë, (përveç ndërmarrjeve nën hetim), vlerat e ofertave fituese bien poshtë fondit limit, si dhe përqindja e ofertës së ndërmarrjeve nën hetim në raport me fondin limit zvogëlohet.

Kështu për shembull:

- χ) **Në tenderin e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Gjykata Shkallës Parë Kavajë** datë 15/03/2011 me fond limit 1.125.000 lekë marrin pjesë disa ndërmarrje ku fiton Nazeri 2000 me 67.41% te Fondit Limit me vlerë 758.376 lekë. Në këtë tender ka marre pjesë edhe Irezan me 68.14% te fondit Limit duke mbuluar ndërmarrjen Nazeri 2000. Paraqitja e ofertave dhe lëvizja njëra nga tjetra është shume e vogël ndërsa në raport me fondin limit ka difference duke rënë rreth 32% nga fondi limit pasi në këtë tender kanë hyre edhe ndërmarrje të tjera jashtë grupit. Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga ofertuesit në këtë tender është vënë re se ndërmarrja Nazeri 2000 dhe Irezan kanë shenja të ngjashme si:

Numri serial i certifikatës është i njëpasnjëshëm (80190038 -39; Preventivi i çmimit: Nazeri 2000 - Dea Security (Irezan) është i plotësuar në të njëjtën mënyrë dhe të njëjtën formë paraqitje grafike; në këtë preventiv ka të njëjtat detajime në tabelën e kostos. Gjithashtu shënimi shpjegues i tabelës është i formuluar në mënyrë të njëjtë.

Sipas vlerave të paraqitjes së ofertave nga ndërmarrjet nën hetim “Nazeri 2000” dhe Dea Security (Irezan) rezulton se përveçse kanë shenja të ngjashme në përgatitjen e dokumenteve, bazuar në ofertat e paraqitura ndërmarrjet kanë zbatuar skemën e ofertës së mbuluar. Kështu Dea Security (Irezan) ka paraqitur një ofertë pak më të lartë se “Nazeri 2000” duke e mbështetur atë.

20. Në të gjithë tenderat e janë gjetur shenja të ngjashme mbi formulimin e ofertave nga ndërmarrjet nën hetim, gjë e cila vërteton bashkëpunimin dhe njohjen e ofertave të njëri-tjetrit.
21. Nga hetimi ka rezultuar se ndërmarrjet nën hetim kryesisht bashkëpunojnë të ndarë në dy grupe: Grupi 1 “Eurogjici Security, Eurogjici Security 1 dhe Toni Security”; dhe Grupi 2 “Nazëri 2000 dhe Dea Security (Irezan)”. Por ka raste kur këto dy grupe bashkëpunojnë edhe midis tyre.
22. Ndërmarrjet Eurogjici Security, Eurogjici Security 1 dhe Toni Security përdorin ***skemën e nënkontraktimit² me konkurrentët në të njëjtën procedurë prokurimi, duke*** koordinuar sjelljen e tyre gjatë procedurave të prokurimit. Nëpërmjet kësaj skeme ofertuesi fitues pas shpalljes së ofertës fituese nënkontraktton shërbimin objekt prokurimi ofertuesve jo fitues.
23. Gjatë inspektimeve të kryera në selitë e ndërmarrjeve nën hetim si dhe nga dokumentacioni i sjelle nga këto ndërmarrje në përgjigje të kërkesave për informacion në fazën e hetimit të thelluar, është vënë re se, në disa nga tenderat e marrë në shqyrtim, pasi shpallet oferta fituese, ofertuesit fitues ju nënkontrakttojnë shërbimin objekt prokurimi ofertuesve jo fitues. Për shembull: Në tenderin e zhvilluar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, viti 2011, pjesëmarrës janë: “Eurogjici Security”, “Eurogjici Security 1” dhe “Tony Security”. Fitues është shpallur “Tony Security”,

2 Nënkontraktimi në këtë rast vjen si rezultat i marrëveshjes së ndaluar midis konkurrentëve që të mos ofertojnë ose të paraqesin një ofertë jofituese, në këmbim të nënkontraktimeve apo kontratave të furnizimit për ofertuesin e suksesshëm në mënyrë që të ndahet fitimi midis ndërmarrjeve pjesëmarrëse. Në një marrëveshje të fshehtë. Pra një ofertues me ofertë më të ulët, bie dakord të tërheq ofertën e tij fituese në favor të ofertuesit tjetër vijues me oferte më të lartë në këmbim të një nënkontraktimi fitimprurës që do të ndajë shumën (cmimin) e lartë të fituar në mënyrë të padrejte midis tyre.

ndërkohë që shërbimet i nëkontraktohen operatorëve të tjerë ofertues jo fitues (Nënkcontratë Shërbimi, date 01/09/2011, me Kontraktues: “Tony Security” dhe Nënkcontraktues “Eurogjici Security 1”).

Kjo sjellje përbën një skemë të mirëfilltë nënkcontraktimi midis dy operatorëve “Toni Security” dhe “Eurogjici Security”, të cilët njëkohësisht janë konkurrentë në tenderin e zhvilluar nga Drejtoria Rajonale e Shendetit Publik Durrës dhe duhet të paraqiteshin në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri. Kjo skemë e përdorur vërteton bashkëpunimin e vazhdueshëm midis këtyre operatorëve.

24. Për sa më sipër, ndërmarrjet “Eurogjici Security”, “Eurogjici Security 1” dhe “Toni Security” bashkëpunojnë gjatë procedurave të prokurimit duke përdorur skemën e nënkcontraktimit. Nëpërmjet kësaj skeme ofertuesi fitues pas shpalljes së ofertës fituese nënkcontrakton shërbimin objekt prokurimi ofertuesve jo fitues në procedurat e prokurimit. Kjo sjellje vërteton se ndërmarrjet Eurogjici Security, Eurogjici Security 1 dhe Toni Security nuk konkurojnë në mënyrë të pavarur gjatë procedurave të prokurimit duke vepruar në kundërshtim me nenin 4 pika 1, germa a) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar) pasi kufizon konkurrencën në procedurat e prokurimit.
25. Ndërmarrjet konkurrencte në të tre vitet kanë ndarë klientët (autoritetet kontraktore) duke mos konkuruar ose duke i mbuluar njëra –tjetrën. Kjo ndarje paraqitet si një nga format e **marrëveshjeve në oferta që është shpërndarja e tregut**. Kështu për shembull:
 - α) Ndërmarrja “Eurogjici Security” në dy vite ka fituar ofertën në tenderin e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, ndërsa për vitin 2011 është fituar nga ndërmarrja “Tony Security”, i cili gjatë procedurave të tenderimit është mbuluar nga Eurogjici Security dhe Eurogjici Security 1. Ofertues konkurrentë në të tre vitet kanë qënë ndërmarrjet brenda grupit. Vlera e ofertës fituese në raport me fondin limit ka qënë shumë e afërt përkatësisht 100.0%, 99.4% dhe 99.9%. Në këtë tender janë konstatuar shenja të ngjashme.
 - β) Ndërmarrja “Eurogjici Security” në tre vite ka fituar tenderin e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor SUOGJ “Mbreteresha Geraldine”. Ofertues konkurrentë në të tre vitet kanë qënë ndërmarrjet brenda grupit ku janë gjetur edhe shenja të ngjashme në oferta. Vlera e ofertës fituese në raport me fondin limit ka qënë shumë e afërt përkatësisht 99.7%, 2009 dhe 100% në vitin 2011 ndërsa në vitin 2010 e ul këtë vlerë në 83.3%, sepse futen edhe konkurrentë jashtë grupit.
 - χ) Ndërmarrja “Nazeri 2000” në tre vitet 2009-2011 ka fituar ofertën me tenderin e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria rajonale e Bujqësisë, dhe klinika Stomatologjike Universitare. Ofertues konkurrentë në të tre vitet kanë qënë ndërmarrjet brenda grupit.
26. Gjetjet e mësipërme tregojnë për një bashkëpunim në tregun e prokurimeve publike të Shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni Security”, Eurogjici Security 1”, “NAZERI – 2000”, dhe “DEA SECURITY”, sjellje të cilat bien në kundërshtim me nenin 4, pika 1, germa a), të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.

27. Përsa i përket ndërmarrjes “Sajmiri AL” nga gjetjet e mësipërme nuk u provua në asnjë rast përfshirja e saj në marrëveshje në oferta me ndërmarrjet e tjera nën hetim. Kjo ndërmarrje bashkëpunon me ndërmarrjet e tjera nën hetim në formën e marrëveshjes së bashkimit të operatorëve, të lidhura në bazë të ligjit të prokurimit publik, kryesisht për qarkun e Kukësit.
28. Për sa më sipër sjellja në tërësi e ndërmarrjeve ku:
- janë gjetur evidenca, në formë elektronike dhe shkresore, të bashkëpunimit midis ndërmarrjeve, ku ky bashkëpunim shfaqet në formën e shkëmbimit të informacionit të detajuar dhe përgatitjen e ofertave sic evidentohet nga shenjat e njëjta në përgatitjen e dokumentave të tenderit, stafet e njëjta që punojnë për përgatitjen e këtyre oferta, adresat e njëjta të selive dhe sallave operative;
 - ndërmarrjet nën hetim përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakort më përpara se cili do të paraqesë ofertën fituese në procesin e prokurimit ku ato do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët. Vihet re se në ndërmarrjet paraqesin oferta shumë afër fondit limit, (derirreth 99.99%) në rastet kur marrin pjesë vetëm ndërmarrjet pjesëmarrëse në marrëveshje, ndërsa në rastet kur marrin pjesë ndërmarrje të tjera jashtë marrëveshjes ofertat janë më të ulëta (rreth 20%-30%) nga fondi limit;
 - ndërmarrjet përdorin skemën e nënkontraktimit, ku nëpërmjet kësaj skeme ofertuesi fitues pas shpalljes së ofertës fituese nënkontraktin shërbimin objekt prokurimi ofertuesve jo fitues duke ndarë në këtë mënyrë fitimin nga marrëveshja e ndaluar;
 - ndërmarrjet konkurrencte në të tre vitet kanë ndarë klientët (autoritetet kontraktore) duke mos konkuruar ose duke i mbuluar, vërtetojnë ekzistencën e një marrëveshje në oferta në tregun e prokurimeve publike të Shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni Security”, Eurogjici Security 1”, “Nazëri – 2000”, dhe “Dea Security”.
29. Kjo marrëveshje në kuptim të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nen 4, pika 1, gërma a), konsiderohet marrëveshje e ndaluar, pasi ka për objekt dhe pasojë kufizimin në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, pika 1, gërma a), nenit 24, shkronja d), nenit 45, pika 1, nenin 74, pika 1, gërma “a” dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V E N D O S I:

- Mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.
- Ndalimin e marrëveshjes në oferta në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni

Security”, “Eurogjici Security 1”, “Nazëri – 2000” dhe “Dea Security”, si marrëveshje e ndaluar në kuptim të nenin 4, pika 1, gërma a), të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

- III. Të gjobisë ndërmarrjen “Eurogjici Security” sh.pk, për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta, në shumën prej 1,050,000 (njemilonepesdhjetemije) Lekë;
- IV. Të gjobisë ndërmarrjen “Toni Security” sh.pk, për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta, në shumën prej 407,000 (katerqindeshtatemije) Lekë;
- V. Të gjobisë ndërmarrjen “Eurogjici Security 1” sh.pk, për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta, në shumën prej 416,000 (katerqindegjashtembedhjetemije) Lekë;
- VI. Të gjobisë ndërmarrjen “Nazeri–2000” sh.pk, për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta, në shumën prej 530,000 (peseqindetridhjetemije) Lekë;
- VII. Të gjobisë ndërmarrjen “Dea Security” sh.pk, për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta, në shumën prej 128,000 (njqindenjezetetetemije) Lekë;
- VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për komunikimin e tij ndërmarrjeve të mësipërme, si dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()
Zv/Kryetare

()
Anëtare

()
Anëtar

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 241, datë 03. 08. 2012

Për nje shtese në VKK Nr.225, datë 28.05.2012 mbi “Përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive në tregun e sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për shërbimin e “Policës Kufitare të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.08.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e nje shtese në VKK Nr.225, datë 28.05.2012 mbi “Përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimit mbi shkëmbimin e informacionit për shërbimin “Policë Kufitare e mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”.

Baza ligjore: Nenet 24, germa d, dhe 51, germa a, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës mbi kërkesën e operatorit ANSIG sha për përfshirjen në përjashtimin nga marrëveshja e bashkëpunimit mes shoqërive që operojnë në tregun e sigurimeve,

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Byroja Shqiptare e Sigurimeve (këtu e si vijon BSHS) bashkërisht me “ANSIG” Sh.a., me shkresën nr. 41 prot të datës 12.07.2012 (me nr.497prot. brendshëm, dat.12.07.2012),

paraqiti një kërkesë për përfshirjen edhe të ndërmarrjes “ANSIG” Sh.a. me nr. NIPT-i Nr. L21319037M dhe datë të Regjistrimit 10.01.2012 në VKK Nr.225, datë 28.05.2012, i cili lidhet me “Përfshirjen nga ndalimi të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimit mbi shkëmbimin e informacionit për shërbimin “Policë Kufitare e mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, (e cila në vetvete nuk është veçse një marrëveshje për bashkëpunim mes antarëve të saj).

2. Kërkesa në vetvete shoqërohej edhe me dy vendimet e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (në vijim AMF-së) përkatësisht VAMF Nr.155, dat.23.11.2011 “Mbi miratimin paraprak të shoqërisë ANSIG Sh.a. për ushtrim veprimtarie në sigurime për klasat e jo-jetës”; VAMF Nr.76, dat.22.06.2012 “Për miratimin e dhënies së licencës për ushtrim veprimtarie sigurimi për klasat e jo-jetës”.
Njëkohësisht konfirmohej se me Vendimin e Asamblesë së Shoqërive të Sigurimit të datës 09.07.2012 ishte pranuar aderimi i ndërmarrjes “ANSIG” Sh.a. në marrëveshjen e tyre të bashkëpunimit të përjashtuar nga VKK Nr.225, objekt-ndryshimi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 24, (shkronja d); dhe 51, (germa a); të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V E N D O S I:

1. Në pjesën konstatuese (vërejtëse) të VKK Nr.225, datë 28.05.2012 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - α) Në pikën I “Procedura e ndjekur”, pas emrit të ndërmarrjes “ALBSIG” Sh.a. shtohet edhe shprehja “**ANSIG” Sh.a.**”
 - β) Në pikën II “Palët në marrëveshje”, në paragrafin e dytë të saj pas “ATLANTIK” Sh.a. shtohet edhe shprehja: “**Shoqëria e Sigurimeve ‘ANSIG’ Sh.a.**”
2. Ndërsa pika 1 e dispozitivit të këtij vendimi Nr.225, datë 28.05.2012 ndryshohet sa vijon:
-“Të përjashtojë individualisht nga ndalimi në marrëveshjen e bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit për ofrimin e shërbimit të Policës Kufitare të Sigurimit të Detyrueshëm të mjeteve motorrike për Përgjegjësitë ndaj Palëve të Treta, midis shoqërive të sigurimit: “INSIG” Sh.a, “SIGMA VIG” Sh.a, “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” Sh.a, “INTERSIG VIG” Sh.a, “INTERALBANIAN VIG” Sh.a, “ATLANTIK” Sh.a, “EUROSIG” Sh.a, “ALBSIG” Sh.a. dhe “ANSIG” Sh.a.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi
()
Zv/Kryetare

Servete Gruda
()
Anëtare

Koço Broka
()
Anëtar

Iva Zajmi
()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr.242, datë 03/09/2012

**“Për disa ndryshime në rregulloren e caktimit të shpenzimeve për ndjekjen e
procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03/09/2012, në bazë të nenit 24, germa c, i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit,

VENDOSI:

Përmbajtja e Nenit 1 të Rregullores “Për caktimin e shpenzimeve dhe ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 10, datë 29. 06.2004, ndryshuar me Vendimin nr 167, datë 21.12.2010, ndryshohet si vijon:

1. Tërheqja e “Formularit të njoftimit të përqëndrimit”, nga ndërmarrjet pjesmarrëse të përcaktuara në nenin 12, të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të cilat bashkohen, përftojnë kontrollin, si dhe për rastet kur pjesa e ndërmarrjes preket nga transaksioni i kryer) bëhet kundrejt pagesave me vlerë:
 - α) 7.500 Lekë për ndërmarrjet që përftojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore nga 200 milionë lekë deri në 1 miliardë lekë;

- β) 15.000 Lekë për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore më shumë se 1 miliardë lekë.
2. Autorizimi "Për realizimin e përkohshëm të përqëndrimit" që jepet nga Komisioni i Konkurrencës në bazë të kërkesës së ndërmarrjeve pjesmarrëse, në përputhje me nenin 60, pika 1, të Ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" do të jepet kundrejt pagesave me vlerë:
- α) 150.000 Lekë për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore nga 200 milionë lekë deri në 1 miliardë lekë;
- β) 300.000 Lekë për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore më shumë se 1 miliardë lekë.
3. Autorizimi "Për realizimin e përqëndrimit", që jepet nga Komisioni, në përputhje me nenin 56, të Ligjit merret kundrejt pagesës me vlerë:
- α) 250.000 Lekë për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore nga 200 milionë lekë deri në 1 miliardë lekë;
- β) 500.000 Lekë për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore më shumë se 1 miliardë lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()
Zv/Kryetare

()
Anëtare

()
Anëtar

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 243, datë 11. 09. 2012

“Për dhënien e disa rekomandimeve për rritjen e konkurrencës në prokurimet publike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e marrëveshjes në oferta ndërmjet ndërmarrjeve Shqyrtimi i raportit hetimor dhe projekt-ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”” për dhënien e rekomandimeve për rritjen e konkurrencës në prokurimet publike.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) e f), neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi vlerësimin e projekt-ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik””;

VËREN SE:

I. Për praktikën në hetimin e thelluar

1. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar për sjelljen e ndërmarrjeve nën hetim në

tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, janë administruar një sërë evidencash për të parë sjelljen e tyre në treg, në këndvështrim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

2. Nga analiza e konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit dhe ruajtjes së sigurisë fizike, bazuar dhe në metodologjinë “Për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike”, rezultoi ekzistenca e një marrëveshje në oferta (bid rigging) në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike konsiderohet marrëveshje e ndaluar, pasi ka për objekt dhe pasojë kufizimin në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike.
3. Një ndër skemat e marrëveshjes në oferta të përdorura nga ndërmarrjet nën hetim është edhe skema e nënkontraktimit. Nëpërmjet kësaj skeme ofertuesi fitues pas shpalljes së ofertës fituese, u nënkontraktton shërbimin objekt prokurimi ofertuesve jo fitues, ose jo pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.
4. Kuadri ligjor dhe nënligjor i prokurimeve publike lejon operatorin ekonomik fitues (kontraktorin) që të nënkontrakttojë një pjesë të kontratës së tij publike sipas kushteve të caktuara. Sipas rregullave të prokurimit publik *Autoriteti Kontraktor lejon, në veçanti, nënkontraktimin, për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve të vegjël e të mesëm, ekonomikë.*
5. Por, nisur nga natyra specifike e veprimtarisë së ruajtjes dhe sigurisë fizike, me qëllim marrjen e përgjegjësiwe direkt nga operatori kontraktues, si dhe konkurimin në mënyrë të pavarur të këtyre shoqërive, nuk është kjo rruga më e drejtë (nënkontarktimi) për të rritur mundësitë e pjesëmarrjes në prokurime të operatorëve të vegjël e të mesëm. Përkundrazi, nënkontraktimi rrit bashkëpunimin midis ofertuesve konkurrentë në kryerjen e këtij shërbimi, duke rritur mundësitë e komunikimit mes tyre në vazhdimësi, për vetë natyrën e vazhdueshme të shërbimit, si dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit midis tyre para dhe pas shpalljes së ofertës fituese, karakteritike kjo e cila ndihmon marrëveshjet në oferta.
6. Lejimi i nënkontraktimit pa asnjë kriter të mundshëm kufizues bëhet shkaktar i pajustificueshëm i kufizimit të konkurrencës midis operatorëve ekonomikë.

II. Për projektligjin

7. Bazuar në njoftimin e Agjensisë së Prokurimit Publik për projektligjin e publikuar për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (të ndryshuar), Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar vlerësimin e këtyre amendimeve nga këndvështrimi i Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
8. Amendimet e propozuara nëpërmjet këtij projekt-ligji prekin nënë të ndryshme të Ligjit ekzistues “Për prokurimin publik” dhe janë të aspektit procedural. Gjithsesi, ajo që vihet re në këtë projekt-ligj është se në të është pasqyruar ndryshimi i rekomanduar nga Komisioni i Konkurrencës nëpërmjet pikës I.1, të Vendimit Nr.158, datë 12.11.2010 “Për disa rekomandime për parandalimin e *marrëveshjeve në oferta* në prokurimet publike”,

9. Për të kuptuar sa më qartë së çfarë janë marrëveshjet në oferta është e rëndësishme dhënia e një përkufizimi të këtyre marrëveshjeve në ligjin e prokurimit publik, si ligji që përcakton procedurat e prokurimit gjatë të cilave ndodhin këto marrëveshje.
10. Me qëllim parandalimin dhe luftimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike, si dhe ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomik dhe punonjësve të prokurimit për pasojat e rënda të këtyre marrëveshjeve të ndaluara në kuptim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, mendojmë se është shumë pozitive që të përcaktohet qartë në Ligjin e “Prokurimit Publik” (LPP): *që oferta të jetë e vlefshme duhet që ajo të jetë përgatitur dhe paraqitur krejtësisht në mënyrë të pavarur nga ofertat e tjera konkurruese, si dhe operatorët e tjerë jo-ofertues.*
11. Me qëllim vënien në dispozicion për operatorët ekonomik të një kohe të mjaftueshme për të argumentuar ofertën anomalisht të ulët, duke mënjanuar në këtë mënyrë të drejtën “abuzive” të autoritetit kontraktor për të përcaktuar këtë afat rast pas rasti në mënyrë subjektive, si dhe për një trajtim të barabartë mes operatorëve ekonomikë, pjesmarrës në procedurat e prokurimit publik mendojmë të parashikohet një afat i paracaktuar kohor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Në projekt-ligjin e hartuar nga APP, në nenin 4, pika 2, përcaktohet se: Në nenin 13 “Agjencia e Prokurimit Publik”, pas shkronjës “ç” të pikës 3, shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) Kur ka një vendim të formës së prerë të Autoritetit të Konkurrencës për marrëveshje në oferta”.

Të zëvendësohet fjala Autoritet me fjalën Komision, pasi organi vendimarrës është Komisioni i Konkurrencës. Pra të bëhet:

“D) Kur ka një vendim të formës së prerë të Komisionit të Konkurrencës për marrëveshje në oferta”.
- II. T’i rekomandojë Agjencisë së Prokurimit Publik të marre nismën ligjore që:
 1. Në nenin 3 “Përkufizime” të shtohet një pikë me përmbajtjen vijuese:

“Marrëveshjet në oferta në prokurimet publike” janë një formë e marrëveshjeve për fiksimin e çmimit dhe/ose ndarjen e tregut në prokurime, të cilat ndodhin: Së pari, kur ndërmarrjet, që pritet të konkurojnë, në mënyrë të fshehtë bien dakord për vlerën e ofertës së paraqitur duke eliminuar në këtë mënyrë konkurrencën për çmimin; dhe së dyti, ndërmarrjet bien dakord se cila do të paraqesë ofertën më të ulët dhe të realizojnë rotacionin në atë mënyrë që çdo ndërmarrje të fitojë një vlerë të caktuar kontratash për të cilat është rënë dakord.”
 2. Në nenin 46 (ose në ndonjë nen tjetër të përshtashëm) të shtohet një dispozitë ku të përcaktohet se:

“Që një ofertë të jetë e vlefshme (kualifikueshme) duhet që ajo të jetë përgatitur dhe paraqitur krejtësisht në mënyrë të pavarur nga ofertat e tjera konkurruese, si dhe

operatorët e tjerë jo-ofertues”.

Kjo mund të vërtetohet nëpërmjet nënshkrimit nga ana e ofertuesve të “Çertifikatës për ofertë të pavarur”, rekomanduar APP-së për t’u përfshirë në dokumentet standarde të tenderit me anë të Vendimit Nr.158, datë 12.11.2010 “Për disa rekomandime për parandalimin e marrëveshjeve ne oferta ne Prokurimet Publike”.

3. Në nenin 56 “Oferta anomalisht e ulët” të ligjit, të përcaktohet një afat kohor i mjaftueshëm brenda të cilit operatorët ekonomikë duhet të paraqesin argumentat e tyre lidhur me ofertën anomalisht të ulët.
4. Në nenin 61 “Nënkontraktimi” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, të shtohet një pikë ku të përcaktohet se:
“Autoriteti Kontraktor nuk do të lejojë në asnjë rast nënkontraktimin midis ofertuesve pjesëmarrës në të njëjtën procedurë prokurimi, pasi kjo sjellje është në kundërshtim me parimin e ofertimit në mënyrë të pavarur, si dhe nuk do të lejojë nënkontraktimin për ato kontrata të cilat, për nga natyra e vazhdueshme dhe specifike e tyre, duhet të kryhen nga vetë kontraktuesi”.
 Gjithashtu mos lejimi i nënkontraktimit si më sipër të përcaktohet edhe në kreun përkatës të VKM-së mbi rregullat e prokurimit publik.
- III. Në funksion të rritjes të transparencës dhe të konkurrencës në prokurimet publike, gjatë zhvillimit dhe në përfundim të procedurave të prokurimit nga Autoritetet Kontraktore të publikohen të gjitha dokumentet lidhur me këto procedura (kryesisht: formularin e plote të njoftimit të fituesit dhe formularin e plotë të nënshkrimit të kontratës së lidhur), si dhe të mundësohet ruajtja e tyre në faqen zyrtare elektronike të APP-së, në vite.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi Agjencise së Prokurimit Publik dhe paleve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()
Zv/Kryetare

()
Anëtare

()
Anëtar

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 244, datë 20. 09. 2012

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit 100 % nga shoqëria Ferreri International S.A të Business NAT dhe të 49% të Bussines SL (të zotëruara nga Grupi Stelliferi)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.09.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit 100 % nga shoqëria Ferreri International S.A të Business NAT dhe të 49% të Bussines SL (të zotëruara nga Grupi Stelliferi).

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 2, nenet 10-12, 13 dhe 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Ferrero International S.A/ IF- Mariano Stelliferi S.p.a , dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni përqendrimit realizohet në bazë të “Kontratës së Investimit dhe të Marrëveshjes së Ortakëve” e lidhur ndërmjet përfaqësuesit e Grupti Stelliferi dhe Ferrero International S.A, më datë 30 Qershor 2012.

Me anë të këtij transaksioni shoqëria blerëse Ferrero International S.A përfton kontrollin e plotë të Bussines NAT, i cili zotërohet nga grupi Stelliferi dhe kontrollin e përbashkët nga Ferrero dhe IF- Mariano Stelliferi S.p.A të Bussines SL, i cili zotërohet nga grupi Stelliferi.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën e ndryshimit të pronësisë. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1) dhe është njoftuar brenda afatit të parashikuar (neni 12/2).

2. Palët në transaksion

- **Ferrero Interantional S.A** një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Luksenburgut me seli në adresën: Rue de Treves Findel, Business Center, Luksenburg. Ajo është shoqëria holding e grupit Ferrero. Grupi Ferrero ushtron aktivitet në mbarë botën në prodhimin dhe shitjen e ëmbëlsirave (ëmbëlsirave prej çokollate, karamele, snacks dhe ëmbëlsirave në formë kremi).

Ferrero nuk është i pranishëm në Shqipëri, por ka shitje nëpërmjet distributorit Interbrands Sh.a.

- **Interbrands Sh.a** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Autorstrada Tiranë-Durrës, kilometri i parë. Objekti i shoqërisë është importim-eksportim dhe tregtim mallrash me shumicë dhe pakicë të produkteve dhe artikujve të ndryshëm ushqimorë, cigareve, pijeve, të higjenës personale, etj.
- **IF- Mariano Stelliferi S.p.A** një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit italian me seli në adresën: Via Roinciglione, km 10,700,01032 Caparola, Itali. Ajo është shoqëria holding e grupit Stelliferi. Grupi Stelliferi ushtron aktivitet kryesisht në prokurimin dhe shitjen e lajthive (përfshirë lajthitë në gjëndje natyrore dhe produktet gjysmë të përpunuara, si miell e brumë lajthie) dhe të arrorëve të tjerë (fistik, fara të bohçes së pishës dhe bajame).

3. ANALIZA E KONKURRENCËS

Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në përqendrim në tregun ndërkombëtar për vitin 2011 është 1306 miliard Lek:

- Xhiro e Ferrero International S.A = xxxxxxxx Euro = xxxxxxxx Lek $\approx$ xxxxxx Lek.
- Xhiro e IF – Mariano Stelliferi Spa = xxxxxxxx Euro = xxxxxxxx Lek $\approx$ xxxxxxxx Lek.

Ndërkohë, **xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në përqendrim në tregun e brendshëm,**

për vitin 2011 është rreth xxxxxxxx Lek:

Në Shqipëri, grupi Ferrero është prezent me produktet e saj nëpërmjet distributorit Inter Trade & Distribution.

Për vitin 2011, xhiro e Ferrero në Shqipëri është xxxxxxxx Euro= xxxxxxxx Lek

3.1. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë: a) tregu i produktit, dhe b) tregu gjeografik.

3.1.a Tregu i produktit:

IF – Mariano Stelliferi vepron kryesisht në prokurimin dhe tregtimin e lajthive (përfshirë lajthitë në formë natyrore dhe produkteve gjysëm të përpunuar si miell dhe brume lajthie) si dhe arorëve të tjerë (festëk, fara të boçes së pishës dhe bajame). Në këtë treg shoqëritë blejnë produktet e sipërpërmendura dhe i shesin ato klientëve industrialistë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregje të ndryshëm.

3.1.b Tregu përkatës gjeografik:

Për analizimin dhe vlerësimin e efekteve që do të shkaktojë ky transaksion në tregun përkatës të produktit, treg përkatës gjeografik është konsideruar tregu kombëtar.

3.2 Struktura e tregut dhe vlerësimi i konkurrencës

Qëllimi kryesor i transaksionit qëndron në faktin se nëpërmjet tij Ferrero do të mund të mbulojë një pjesë të kërkesës së tij për lajthi në gjendje natyrale duke ulur kështu riskun nga luhatjet e çmimit të lëndëve të para (lajthi, kakao apo qumësht pluhur). Në këtë mënyrë Ferrero do të mund të planifikojë në mënyrë më të parashikueshme dhe efikase prodhimin e tij dhe të sigurojë cilësi të lartë të lëndëve të para duke siguruar kështu prezencën e tij në treg me çmime konkurruese dhe produkte të cilësisë së parë në tregun ndërkombëtar.

Në tregun e rrjedhës së sipërme (atë të lajthive), rezulton se IF Mariano Stelliferi nuk është prezent në tregun e brendshëm. Ndërsa sa i takon tregjeve të rrjedhës së poshtme (të produkteve të ëmbla me përmbajtje kakao dhe lajthie – çokolllatave dhe kremit të çokolllatës) rezulton se produktet e Ferrero-s janë të pranishëm në tregun shqiptar nëpërmjet distributorit të tij kryesor Inter Trade & Distribution dhe Conad Albania.

Ndër konkurrentët e Ferreros të hasur si në tregun ndërkombëtar por edhe atë të brendshëm mund të përmendim: Mars me produktet e saj Snickers, Mars, Bounty, Milky Way etj. - xxx% të tregut; Kraft (Milka, Toblerone, Lacta etj) – xxxx %; Nestle (çokolllatat Nestle, Kit Kat etj) – xxxx të tregut.

Sa i takon tregut të produkteve të ëmbla në formë kremi (krem çokolllate/ çokokrem), rezulton se sasia totale e importuar e këtij produkti gjatë periudhës janar 2011- korrik 2012 është xxxxxxx kg. Sasia e importuar e produktit Nutella – produkt i Grupit Ferrero – për të njëjtën periudhë është xxxxxx kg ose xxxx% e totalit.

Sa më sipër, realizimi i përqendrimit nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në tregjet e sipërpërmendura për vetë faktin se IF Mariano Stelliferi nuk është prezent në tregun shqiptar. Struktura e tregut të shitjes së lajthive, ëmbëlsirave prej çokolllate dhe kremit

të çokollatës në Shqipëri apo pozicioni i shoqërive të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në këtë treg nuk ndryshojnë. Pjesët e tregut të palëve pjesëmarrëse në transaksion nuk i japin njësisë së re të përqendruar një shkallë të konsiderueshme fuqie, në të paktën në një nga tregjet përkatëse. Si pasojë, ky transaksion nuk shfaq shqetësime për konkurrencën jo vetëm sa i takon tregut të brendshëm, por edhe atij ndërkombëtar.

Përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit 100 % nga shoqëria Ferreri International S.A të Business NAT dhe të 49% të Bussines SL (të zotëruara nga Grupi Stelliferi).
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()
Zv/Kryetare

()
Anëtare

()
Anëtar

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 245, datë 02. 10. 2012

**“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit
dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.10.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Relacionit mbi monitorimin e tregut të prodhimit/Importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të monitorimit në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal;

VËREN SE:

1. Autoriteti i Konkurrencës në bazë të një ankese mbi rritjen e çmimit të vajit vegjetal në treg, ka monitoruar tregun e prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal.

2. Nga analiza e tregut të prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal rezultoi se:
- Oferta për vaj vegjetal në tregun shqiptar sigurohet nga importi i vajit të rafinuar dhe nga prodhimi në vend i vajit vegjetal (rafinimi i vajit të papërpunuar të importuar);
 - Nga analiza e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave mbi importet e vajit vegjetal ka rezultuar se tregu i importit të vajit vegjetal është shumë i përqëndruar me një tregues HHI prej 2769. Shkalla e përqëndrimit ka ardhur duke u rritur nga 1746 në vitin 2010, në 2406.89 në vitin 2011 dhe në 2769 në 8 tetë mujorin (janar-gusht) 2012.
 - Në tregun e prodhimit të vajit vegjetal operojnë vetëm dy ndërmarrje, “Olim” sh.a dhe “Vajra Bimore” sh.a. Këto dy ndërmarrje importojnë vajin e papërpunuar, të cilin pasi e përpunojnë e hedhin në tregun e shitjes me shumicë. Treguesit e përqëndrimit në këtë treg janë shumë të lartë për vetë faktin se janë vetëm dy ndërmarrje prodhuese. Gjatë viteve 2011-2012 vihet re një ndryshim i strukturës së këtij tregu, ku ndërmarrja “Olim” gjatë 8(tetë) mujorit (janar-gusht) 2012 arrin në pjesën e tregut që kishte ndërmarrja “Vajra Bimore” në vitin 2011, konkretisht mbi 60% të tregut të prodhimit vendas, si dhe e kundërta, ndërmarrja “Vajra Bimore” gjatë 8 (tetë) mujorit (janar-gusht) 2012 arrin në pjesën e tregut që kishte ndërmarrja “Olim” në vitin 2011, konkretisht mbi 39% të tregut.
 - Tregu i shitjes me shumicë përfshin si ofertën nga ndërmarrjet prodhuese ashtu edhe ndërmarrjet importuese të vajit vegjetal. Në këtë treg vihet re një rritje e indeksit të përqëndrimit (nga 1697.34 në vitin 2011, në 1808 për 8(tetë) mujorit (janar-gusht) 2012). Gjithashtu në vitin 2012 edhe treguesi CR3 është rritur nga 63 në 68% duke shkuar në të njëjtën linjë me rritjen e HHI.
 - Nga analiza e çmimeve të paraqitura në ankesë si dhe të rezultuara nga monitorimi u konstatua se: ka marzhe të njëjta të rritjes së çmimit në afate të përafërta kohore; rritja e çmimit njoftohet më përpara në kohë se të ndodhe realisht kjo rritje; është vënë re mungesë oferte për një periudhë të shkurtër dhe furnizimi me çmime të rritura pas kësaj periudhe; rritja e çmimit të vajit vegjetal është reflektuar në tregun e shitjes me pakicë. Çmimet e shitjes me shumicë nuk kanë reflektuar në kohë zbritjet dhe kanë reaguar menjëherë ndaj rritjes së çmimeve të blerjes në tregjet ndërkombëtare.

Sa më lart, sjellja e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal, mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Të miratojë hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

- II. Periudha e hetimit do të jete Janar - Tetor 2012.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraparak jo më vonë se data 30.10.2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 246, datë 09. 10. 2012

“Mbyllja e hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL) dhe vendosje gjobe për kufizim të konkurrencës ndaj ndërmarrjeve “Sigal Uniq Group Austria Sha (Sigal)”, “Sigma Vienna Insurance Group Sha (Sigma)”, “Atlantik Sha”, “Intersig Vienna Insurance Group Sha (Intersig)”, “Interalbanian Sha”, “Alb - Siguracion Sha (Albsig)”, “Instituti i Sigurimeve Sha (Insig)” dhe “Eurosig Sha”.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjet e tij të datës 4.10.2012 dhe 9.10.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e marrëveshjes së ndaluar për fiksimin e çmimit në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL).

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d); neni 26; neni 4, pika 1; neni 74 pika 1, shkronja a) dhe neni 75, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (; Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999; dhe “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL), të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës dhe Relacionit të Sekretares së Përgjithshme;

- Pretendimeve të ndërmarrjeve nën hetim “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SHA (SIGAL)”, “SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SHA (SIGMA)”, “ATLANTIK SHA”, “ALB - SIGURACION SHA (ALBSIG)”, “INSTITUTI I SIGURIMEVE SHA (INSIG)”, dhe “EUROSIG SHA”, në seancat dëgjimore përkatëse: të datës 04/09/2012, 05/09/2012 dhe 18/09/2012, si dhe ato me shkrim të dërguara pranë Autoritetit të Konkurrencës, përkatësisht ndërmarrjet: “Sigma” Sh.a, “Insig” Sh.a. “Eurosig” Sh.a, “Atlantik” Sh.a dhe “Sigal” Sh.a.

VËREN SE:

I. PROCEDURA

1. Nisur nga informacionet e dhëna në mediat, sipas të cilave nga data 1 Shkurt 2012 midis operatorëve në tregun e sigurimeve është rënë dakort për të rritur çmimet e sigurimit të mjeteve motorrike, më datë 09.02.2012 Inspektorët e Drejtorisë së Mbikqyrjes dhe Hetimit të Tregut realizuan një monitorim të çmimeve duke mbledhur evidencat nga agjentët e shitjeve në këtë treg.
2. Nga monitorimi, u konstatua që të gjitha kompanitë e sigurimit në mënyrë të menjëhershme kanë aplikuar çmime të njëjta pothuajse për të gjitha produktet e MTPL-së së brendshme.
3. Tregu i sigurimeve funksionon në bazë të Ligjit nr. 10455, datë 21.7.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Në nenin 10, pika 2 cilësohet se “shoqëritë e sigurimit i përcaktojnë vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut”, si rrjedhojë rritja dhe fiksimi i çmimeve nga të gjitha kompanitë e sigurimit (8 shoqëri) në mënyrë të menjëhershme dhe në të njëjtin nivel mund të kishte ardhur si pasojë e një marrëveshje të ndaluar, e cila përbën shkelje të rëndë të nenit 4, pika 1, germa a të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.
4. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 215, datë 10.02.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (TPL)”, vendosi të miratojë hapjen e hetimit paraprak në këtë treg, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës.
5. Në përfundim të hetimit paraprak rezultoi se të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e MTPL-së së brendëshme, duke filluar nga data 1 shkurt 2012 deri në datë 16 shkurt kanë rritur në të njëjtën masë primin e sigurimit për të gjitha klasat e produktit MTPL e brendëshme, gjë e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, germa (a) e Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.
6. Bazuar në raportin e hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, germa (d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe të nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, , u shpreh me anë të Vendimit Nr. 222, datë 11.04.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”.
7. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, realizoi njoftimin e ndërmarrjeve nën hetim në lidhje me Vendimin Nr. 222, datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Ndërmarrja Sigal Sha me anë të shkresës

Nr Prot 2556 datë 24.05.2012, paraqiti pranë AK një kërkesë për revokimin e këtij vendimi. Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të kësaj kërkesë me Vendimin Nr 226 datë 08.06.2012 vendosi rrëzimin e saj.

8. Në vijim të procedurës, Sekretariati i paraqiti Komisionit të Konkurrencës raportin e hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL). Ky raport iu bë me dije ndërmarrëjeve objekt hetimi.
9. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës organizoi seancat dëgjimore, në të cilat ndërmarrjet nën hetim paraqitën në mënyrë verbale edhe me shkrim pretendimet e tyre mbi raportin e hetimit të thelluar. Pretendimet e palëve me shkrim u depozituan në protokollin e Autoritetit të Konkurrencës, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës.
10. Komisioni i Konkurrencës realizoi tryezën e rumbullakët me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, në të cilën u diskutuan gjetjet e raportit të hetimit të thelluar në tregun e MTPL-së, të cilat lidheshin me veprimtarinë rregulluese të këtij enti rregullator.
11. Procedura hetimore është bazuar në Kreun II dhe III të pjesës II të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”.

II. PERIUDHA E HETIMIT DHE NDËRMARRJET NËN HETIM

12. Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr. 222, datë 11.04.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”, vendosi që periudha objekt hetimi është nga 01.01.2011 deri në 30.04.2012.
13. Në vendimin e sipërcituar të Komisionit të Konkurrencës janë përcaktuar ndërmarrjet objekt hetimi, si më poshtë vijon:

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA (SIGAL), person juridik shqiptar, me seli në adresën: Bulevardi Zogu I, Nr. 1, Tiranë. Paketa kontrolluese e tij zotërohet nga UNIQA Int.Bet.Ver (68.64 % e aksioneve), si dhe Albanian-American Enterprise Fund “AAEF” që zotëron 13.30 % të aksioneve, ndërsa pjesa tjetër e aksioneve zotërohet nga aksionarë shqiptarë..

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SHA (SIGMA), person juridik shqiptar, me seli në adresën: Rruga “Komuna e Parisit”, pallati “Lura”, kati.2, Tiranë. Shumica e aksioneve të kësaj ndërmarrjeje zotërohet nga VIENNA INSURANCE GROUP AG Wiener Versicherung Gruppe (87.01% të aksioneve), ndërsa pjesa tjetër e aksioneve zotërohet nga aksionarë shqiptarë.

ATLANTIK SHA, person juridik shqiptar, me seli në adresën: Rruga Themistokli Germenji, Nr. 3/1, Tiranë. Të gjitha aksionet e kësaj ndërmarrjeje (100%) zotërohen nga një aksionar shqiptar.

INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP SHA (INTERSIG), person juridik shqiptar, me seli në adresën: Rruga e Durrësit, godina INTERSIG, prane Pallatit të Sportit “A.Rusi”, Tiranë. Shumica e aksioneve të kësaj ndërmarrjeje zotërohen nga Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe (75 % e aksioneve), ndërsa pjesa tjetër zotërohet nga aksionarë shqiptarë.

INTERALBANIAN SHA, person juridik shqiptar, me seli në adresën: ZAYED

BUSINESS CENTER, Tiranë. Shumica e aksioneve të kësaj ndërmarrjeje zotërohen nga Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe (78.33% e aksioneve), ndërsa pjesa tjetër e aksioneve zotërohet nga aksionarë shqiptarë.

ALB - SIGURACION SHA (ALBSIG), person juridik shqiptar, me seli në adresën: Rruga “George W.Bush”, Tiranë. Aksionet e kësaj shoqërie zotërohen nga disa aksionarë shqiptarë (100% e aksioneve).

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHA (INSIG), person juridik shqiptar, me seli në adresën: Rruga e DIBRËS Nr. 91, Tiranë. Kjo ndërmarrje është me kapital 100% shtetëtor të cilat zotërohen nga Ministria e Financave.

EUROSIG SHA, person juridik shqiptar, me seli në adresën: Rruga Papa Gjon Pali II, Vila Nr. 5, Tiranë. Aksionet e kësaj ndërmarrjeje zotërohen nga disa aksionarë shqiptarë (100% e aksioneve).

III. TREGU PERKATES

14. Bazuar në Ligjin Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe udhëzimin Nr.76, datë 07.04.2008 të Komisionit të Konkurrencës “Për përcaktimin e tregut përkatës”, konkretisht përcaktohet se: *“Tregu përkatës janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët, ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen, ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”*

Tregu përkatës përfshin:

- Tregun përkatës të produktit
- Tregun përkatës gjeografik

III.1 Tregu përkatës i produktit

15. Me “sigurim”, kuptohet transferimi i një rreziku të mundshëm, të një humbjeje financiare ose të një dëmi material nga i siguruari te siguruesi, sipas një kontrate sigurimi. Sigurimi ndahet në “sigurim të detyruar”, i cili nënkupton sigurimin, për të cilin ekziston një detyrim ligjor; dhe në “sigurimin vullnetar”, i cili nënkupton sigurimin, për të cilin nuk ekziston një detyrim ligjor¹.
16. Produkti i sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit (MTPL e brendshme) është një kontratë e lidhur midis siguruesit (Shoqëritë e Sigurimit) dhe pronarit të mjetit motorik, i cili pranon kushtet e siguruesit. Kushtet e sigurimit janë pjesë e pandashme e kontratës së sigurimit, të cilat miratohen nga AMF-ja. Ky produkt hyn në klasën e sigurimeve të detyrueshme dhe është unik në llojin e vet, pra nuk ka zëvendësues.
17. Sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit përfshin:
 - a) sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik;
 - b) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, të përdoruesit të avionit, të përdoruesit të mjetit lundrues, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;

¹ Sipas nenit 3 I Ligjit nr 9267 date 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe endërmjetesimit në sigurime dhe risigurime, ndryshuar me ligjin nr 9338 datë 16.12.2004 dhe ligjin nr 9685 date 26.02.2007”

18. Produkti i MTPL-së ndahet në klasa sipas fuqisë së mjeteve motorike dhe ofrohet nga 8 kompani sigurimesh dhe përkatësisht (Insig, Sigal, Sigma, Intersig, Albsig, Atlantik, Eurosig, Interbanian). Produkti MTPL e brendshme për vetë karakteristikat që ai mbart ka një zëvendësueshmëri të lartë nga ana e kërkesës si edhe ofertës. Për sa i përket kërkesës, produkti MTPL e brendshme, cilësitë, karakteristikat si edhe detyrimi ligjor që poseduesit e mbajtësve të policës kanë, bëjnë që zëvendësueshmëria të jetë e plotë për MTPL që ofrojnë kompanitë e sigurimit.
19. Në rastin e këtij produkti, duke patur si karakteristikë kryesore sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta (pra jo vetë poseduesit e policës së sigurimit), çmimi mbetet edhe kriteri kryesor që përcakton zëvendësueshmërinë. Bazuar në udhëzimin e tregut përkatës zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës ndodh sepse një rritje çmimesh e bën një produkt më pak të pëlqyer nga konsumatorët, të cilët vendosin që të blejnë më pak nga ai dhe më shumë nga produktet alternative zëvendësuese. Në rastin e MTPL së brendshme konstatojmë se ky produkt përballet me një elasticitet të lartë kërkesë duke bërë që në raste të rritjes së çmimit nga një kompani ose të mbajtjes së çmimit të pandryshuar, kur kompanitë e tjera ndërmarrin ulje, kompania me çmim më të lartë të përballet me rënie të shitjeve.
20. Edhe nga ana e ofertës ekziston zëvendësueshmëria, të 8 kompanitë e ofrojnë produktin MTPL e brendshme me karakteristikat, çmimin dhe cilësitë që e bëjnë atë plotësisht të zëvendësueshëm për klientët. Ndërkohë që nuk ka ndonjë kufizim ligjor për sa i përket futjes së kompanive të reja në tregun e MTPL së brendshme në Shqipëri dhe në këto kushte duke konsideruar se një konkurent potencial mund të hyjë në këtë treg, në një periudhë afatshkurtër kohore, mund të themi se ekziston edhe zëvendësueshmëria nga ana e ofertës.
21. Për sa i përket karakteristikave dhe cilësive të tjera të produktit MTPL e brendshme mund të themi se: Një përdorues mjeti motorik, apo një tjetër individ që është përfshirë në një aksident ku është shkaktuar një dëm, është i lidhur me karakteristikat (kompaninë, cilësinë e shërbimit që ajo ofron, shpejtësinë dhe masën, mënyrën e vlerësimit të dëmit, etj) e produktit të sigurimit të detyrueshëm për mjetin që është shkaktar i dëmit dhe jo për cilësitë/karakteristikat e MTPL-së brendshme që ai zotëron për mjetin që ai ka në pronësi apo përdorim. Pra, çmimi i policës së sigurimit mbetet faktori përcaktues për zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës në rastin e produktit MTPL e brendshme, produkt i cili është i detyrueshëm për përdoruesit e mjeteve motorike.
22. Si konkluzion, në bazë të udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës dhe duke u bazuar në karakteristikat e produktit, **MTPL e brendshme përbën tregun përkatës të produktit**. Pra, është e qartë se ky produkt nuk mund të zëvendësohet me një produkt tjetër që ofrojnë ndërmarrjet e sigurimeve, për shkak edhe të detyrimit ligjor specifik që i kërkohet poseduesit të mjetit motorik për ta patur të detyrueshëm.

II. 2 Tregu gjeografik

23. Tregu gjeografik në këtë rast është Republika e Shqipërisë, pasi ky produkt është i vlefshëm vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

IV. KARAKTERISTIKAT E TREGUT

24. Në tregun e produktit MTPL-së e brendshme, gjatë periudhës objekt hetimi kanë operuar tetë kompani. Ky treg është treg i rregulluar në bazë të ligjit Nr 10076 datë

12.02.2009 “Për sigurimin në sektorin e transportit” i ndryshuar, dhe enti rregulltor përkatës është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

25. Mbi bazën e korrepondencës² me AMF-në bëhemi me dije se në bazë të nenit 10 të Ligjit nr 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin në sektorin e transportit” i ndryshuar, AMF-ja miratoi Rregulloren Nr 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, si dhe miratoi tabelat e primeve të rrezikut për përlllogaritjen e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm MTPL. Gjithashtu AMF-ja bën me dije se sipas dispozitave të Ligjit Nr 10076 datë 12.02.2012 “Për sigurimin në sektorin e transportit”, i ndryshuar, shoqëritë përcaktojnë vetë tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm (çmimin e shitjes) sipas kushteve të tregut dhe se shpenzimet që i shtohen primit të rrezikut, nuk përcaktohet nga ky autoritet.
26. Në nenin 7 të Rregullores nr 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, përcaktohet se Drejtoria e Administrimit të Rrezikut të AMF-së pasi shqyrton e këshillohet me materialet e Shoqatës së Aktuarëve, harton tabelat e primit të rrezikut për produktet e sigurimit të detyrueshëm dhe Bordi i AMF i miraton ato.
27. Shoqata e Aktuarëve, e cili përbëhet nga 8 përfaqësues të kompanive të sigurimit dhe një përfaqësues i AMF, gjatë muajit korrik të vitit 2011 ka miratuar tabelën e primeve të rrezikut për sigurimin e detyrueshëm MTPL e brendshme. Gjatë përcaktimit të primit të rrezikut për MTPL-në e brendshme kompanitë e sigurimit përdorin informacion individual të çdo kompanie mbi dëmet, frekuencën e dëmeve, shpenzimet për trajtimin e dëmeve, dëmet e paguara, dëmet pezull, dëmin mesatar, etj.
28. Pra, AMF-ja miraton primin e rrezikut, i cili mundëson krijimin e provigjoneve të domosdoshme për të përballuar dëmet. Primit të rrezikut i shtohen shpenzimet të cilat njihen me termin “ngarkesa mbi primin e rrezikut”, që përmbajnë: shpenzimet operative dhe fitimin e shoqërisë; dhe mbi vlerën totale aplikohet TVSH (20%). Këto janë pjesët përbërëse të primit të shijes. Ky informacion mbetet një informacion konfidencial dhe në të drejtë të kompanisë për të përcaktuar primin e shitjes së produktit MTPL-së së brendshme.

V. SJELLJA E NDËRMAREJVE NË TREG

29. Gjatë periudha 1 Janar 2011-Shtator 2011, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bazuar në Ligjin për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” (i ndryshuar), miratonte paraprakisht tarifat e primit për produktin e sigurimit të detyrueshëm motorrik. Në këtë periudhë konstatohet se çmimet e shitjes të aplikuara nga ndërmarrjet nuk ishin të liberalizuar dhe primi i sigurimit miratohej paraprakisht nga AMF-ja, dhe për këtë arsye çmimet ishin pothuajse të njëjta për të gjitha klasat e MTPL-së së brendshme.
30. Shoqëritë e sigurimit, pas liberalizimit të tregut në muajin Gusht 2011, kanë paraqitur pranë AMF-së primet e shitjes për të gjitha klasat e MTPL-së së brendshme të ndryshme sipas ndërmarrjeve. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr 10455 datë 21.07.2011 (i ndryshuar) primi i sigurimit përcaktohet nga vetë ndërmarrjet e sigurimit. Në këtë mënyrë ligji krijoi mundësi për konkurrencë të lirë edhe në këtë treg specifik.
31. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vlerësoi se primet e shitjes që kompanitë aplikuan për MTPL-në e brendshme ishin në nivele 50-60% më të ulëta se primi i rrezikut³. Ky

2 Shkresa Nr 178/1 Datë 19.03.2012

3 Sipas të dhënave të Buletinit Statistikor për periudhën janar-prill 2012, AMF; www.amf.gov.al

fakt tregon se ndërmarrjet kanë qënë të lira dhe të pavaruara të vendosnin në mënyrë individuale çmimin fundor të produktit dhe për pasojë si dhe primin e rrezikut.

32. Për këtë arsye AMF-ja kërkoi në vijim që shoqëritë e sigurimeve të zbatojnë rregullat e përgjithshme që dikton ligji, që në rastin e primeve të shitjes nën primin e rrezikut kërkohet zbatimi i provigjionimit teknik për primin e pafiturar dhe njëkohësisht paraqitjen e planit të ri të biznesit për të ardhurat nga të cilat do mbulohen këto provigjone.

Primet e sigurimit për produktin MTPL e brendshme Shkurt 2012

33. Nga evidencat e grumbulluara gjatë hetimit rezulton se nga data 1 Shkurt deri në datën 8 Shkurt 2012 ndërmarrjet kanë rritur dhe fiksuar primet e shitjes së produktit MTPL e brendshme për të gjitha klasat e sigurimit.
34. Sikurse paraqitet në tabelën e mëposhtme kategoritë dhe klasat që zënë përqindjen më të madhe janë kategoria B1 (klasa B1/1 dhe B1/2) dhe kategoria D1, D2 (klasat D1/1 dhe D2/1). Kategoria B1 përfaqëson rreth 76% për vitin 2010 (përkatsisht; B1/1 25.39% dhe B1/2 50.54) dhe kategoritë D1 dhe D2 përfaqësojnë rreth 14.43%.

Tabela 1: Primet e shitjes së MTPL-së së brendshme sipas ndërmarrjeve dhe klasave për periudhën 1 Shkurt 2012⁴

KATEG	Klasa	Tipet	Sigal	Interalb	Insig	Atlantik	Sigma	Intersig	Eurosig	Albsig
A 1		Motorcikleta								
	A1/1 -150	deri 150 cm ³	4,100	0	0	4,100	4,100	4,100	4,100	0
	A1/2	mbi 150 cm ³	7,000	0	0	0	7,000	0	0	0
B 1		Autovetura								
	B1/1	deri 1600 cm ³	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000
	B1/2	Mbi 1600 cm ³	14,600	14,600	14,600	14,600	14,600	14,600	14,600	14,600
B 2		Furg, Mikrobuz								
	B2/1	nga 5-8 vende	20,300	0	20,300	20,300	20,300	20,300	20,300	20,300
	B2/2	Mbi 8-15 vende	12,000	27,900	0	0	0	12,100	0	0
C 1	C1/1	Autob. mbi 15 vende	20,000	44,400	20,000	44,400	0	16,000	0	0
D1	D1/1	Kamioncina	19,500	19,500	19,500	19,500	19,500	19,500	19,500	19,500
D2	D2/1	Kamione	32,600	32,600	32,600	32,600	32,600	32,600	32,600	32,600
E	E1/1	Rimorkjo	9,400	9,400	9,400	0	9,400	9,400	9,400	0
F	F	Mjete Bujqesore	7,300	0	0	7,300	0	7,300	7,300	0
G	G	Zjarrfikse	0	16,800	0	0	0	0	0	0

35. Sipas informacionit të disponuar nga AMF-ja rregullatori vetëm në datën 8.02.2012 u kërkoi shoqërive që të zbatojnë nenin 9 të Rregullores Nr 110, datë 28.07.2012 ku citon :”...Autoriteti do të konsiderojë si njoftim tarifat që keni filluar të zbatoni më datë 01.01.2012 . Në këtë mënyrë AMF-ja formalizoi cmimet që shoqëritë kishin aplikuar që në datën 1 shkurt 2012.
36. Referuar rregullores “Për percaktimin e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” shoqëritë e sigurimit duhet të kishin njoftuar AMF-në 10 ditë para fillimit të zbatimit të tarifave të primeve të sigurimit të

4 Burimi i kësaj table janë shkresat Nr.Prot 343/1, Dt 17.05.2012 dërguar nga “Intersig Vienna Insurance Group”, Nr.Prot 346/1, Dt 18.05.2012 dërguar nga “Albsig” Sh.a; Nr.Prot 344/1, Dt 18.05.2012 dërguar nga “Eurosig” Sh.a; Nr.Prot 345/1, Dt 22.05.2012 dërguar nga “Insig” Sh.a Nr.Prot 342/1, Dt 22.05.2012 dërguar nga “Atlantik” Sh.a, Nr.Prot 340/1, Dt 01.06.2012 dërguar nga “Sigma Vienna Insurance Group”; Nr.Prot 339/1, Dt 16.05.2012 dërguar nga “Sigal Uniqa Group Austria”; Nr.Prot 341/1, Dt 15.05.2012 dërguar nga “Interalbani Vienna Insurance Group”

detyrueshem në sektorin e transportit.

37. Ky fakt është pasqyruar në tabelën e mëposhtme, në të cilën shikohet që ndërmarrja INSIG sha për klasën B1/1 dhe C1/1 nuk ka aplikuar të njëjtin prim të shitjes me ndërmarrjet e tjera që operojnë në tregun përkatës. Table 2 policat e MTPL te leshuara nga ndermarrjet per periudhen 1-8 Shkurt 2012⁵

Tabela 2: Primet e shitjes së MTPL-së së brendshme sipas ndermarrjeve dhe klasave për periudhen 1-8 Shkurt 2012⁶

KATEG	Klasa	Tipet	Sigal	Interalb	Insig	Atlantik	Sigma	Intersig	Eurosig	Albsig
A 1		Motorcikleta								
	A1/1-150	deri 150 cm3	4,100	4,100	4,100	4,100	4,100	4,100	4,100	4,100
	A1/2	mbi 150 cm 3	7,000	7,000	7,000	0	7,000	7,000	7,000	7,000
B 1		Autovetura								
	B1/1	deri 1600 cm 3	14,000	14,000	10,000	14,000	14,000	14,000	14,000	14,000
	B1/2	Mbi 1600 cm3	14,600	14,600	14,600	14,600	14,600	14,600	14,600	14,600
B 2		Furg, Mikrobuz	0	0	0	0	0	0	0	0
	B2/1	nga 5-8 vende	20,300	20,300	20,300	20,300	20,300	20,300	20,300	20,300
	B2/2	Mbi 8-15 vende	27,900	27,900	27,900	27,900	0	27,900	27,900	27,900
C 1	C1/1	Autob. mbi 15 vende	44,400	44,400	20,000	44,400	44,000	44,400	44,400	44,400
D1	D1/1	Kamioncina	19,500	19,500	19,500	19,500	19,500	19,500	19,500	19,500
D2	D2/1	Kamione	32,600	32,600	32,600	32,600	32,600	32,600	32,600	32,600
E	E1/1	Rimorkjo	9,400	9,400	9,400	9,400	9,400	9,400	9,400	9,400
F	F	Mjete Bujqesore	7,300	0	7,300	7,300	7,300	7,300	7,300	7,300
G	G	Zjarrfikse	0	16,800	0	0	0	0	0	0

Si konkluzion:

38. Tregu i MTPL-së së brendshme është një treg i liberalizuar dhe i rregulluar nga AMF-ja për përcaktimin vetëm të primit të rrezikut, ndërsa për çmimin final të produktit, shoqëritë e sigurimit përcaktojnë individualisht se cili do të jetë tarifa e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorrik.
39. Duke realizuar një analizë të primeve të sigurimit post-liberalizim, për periudhën Shtator 2011-Janar 2012, tregu i MTPL së brendshme shfaq dy karakteristika kryesore: a) shoqëritë e sigurimit kanë njoftuar pranë AMF-së dhe kanë aplikuar prime rreth 50%-60% nën primet e riskut; si dhe b) primet e shitjes janë të ndryshme midis ndërmarrjeve objekt hetimi.
40. Ndërsa për periudhën 1-8 Shkurt 2012, shoqëritë e sigurimit kanë rritur primet e shitjes së MTPL-së, si dhe i kanë fiksuar ato në nivele të njëta sipas klasave duke humbur individualitetin e ndërmarrjes në përcaktimin e shpenzimeve operative. Duke u sjellë

5 Burimi i kësaj table janë shkresat Nr.Prot 343/1, Dt 17.05.2012 dërguar nga “Intersig Vienna Insurance Group”, Nr.Prot 346/1, Dt 18.05.2012 dërguar nga “Albsig” Sh.a; Nr.Prot 344/1, Dt 18.05.2012 dërguar nga “Eurosig” Sh.a; Nr.Prot 345/1, Dt 22.05.2012 dërguar nga “Insig” Sh.a Nr.Prot 342/1, Dt 22.05.2012 dërguar nga “Atlantik” Sh.a, Nr.Prot 340/1, Dt 01.06.2012 dërguar nga “Sigma Vienna Insurance Group”; Nr.Prot 339/1, Dt 16.05.2012 dërguar nga “Sigal Uniqa Group Austria”; Nr.Prot 341/1, Dt 15.05.2012 dërguar nga “Interalbanian Vienna Insurance Group”

6 Burimi i kësaj table janë shkresat Nr.Prot 343/1, Dt 17.05.2012 dërguar nga “Intersig Vienna Insurance Group”, Nr.Prot 346/1, Dt 18.05.2012 dërguar nga “Albsig” Sh.a; Nr.Prot 344/1, Dt 18.05.2012 dërguar nga “Eurosig” Sh.a; Nr.Prot 345/1, Dt 22.05.2012 dërguar nga “Insig” Sh.a Nr.Prot 342/1, Dt 22.05.2012 dërguar nga “Atlantik” Sh.a, Nr.Prot 340/1, Dt 01.06.2012 dërguar nga “Sigma Vienna Insurance Group”; Nr.Prot 339/1, Dt 16.05.2012 dërguar nga “Sigal Uniqa Group Austria”; Nr.Prot 341/1, Dt 15.05.2012 dërguar nga “Interalbanian Vienna Insurance Group”

në mënyrë të bashkërenduar ndërmarrjet objekt hetimi kanë kufizuar konkurrencën midis tyre duke zvogëluar në këtë mënyrë mundësinë e zgjedhjes konsumatore.

Referuar analizës së mësipërme, rezulton se ndërmarrjet objekt hetimi që ushtrojnë veprimtari në tregun e MTPL-së së brendshme, duke filluar nga data 1 shkurt 2012 deri në datë 8 shkurt 2012, kanë rritur në mënyrë të njëkohshme dhe kanë fiksuar primin e sigurimit për të gjitha klasat e produktit MTPL e brendshme me përjashtim të ndërmarrjes INSIG SHA për klasën B1/1. Kjo sjellje **përbën një praktikë të bashkërenduar, e cila në kuptim të nenit 3, pika 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” konsiderohet marrëveshje, si dhe në bazë të nenit 4, pika 1 gërma a është marrëveshje e ndaluar, dhe në kuptim të Ligjit konsiderohet shkelje e rëndë e konkurrencës.**

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, pika 1, gërma a), nenit 24, shkronja d), nenit 45, pika 1, nenin 74, pika 1, gërma “a” dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V E N D O S I:

- I. Mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL) ndaj ndërmarrjeve: “SIGAL UNIQA GROUP SHA (SIGAL)”, “SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SHA (SIGMA)”, “ATLANTIK SHA”, “INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP SHA (INTERSIG)”, “INTERALBANIAN SHA”, “ALB - SIGURACION SHA (ALBSIG)”, “INSTITUTI I SIGURIMEVE SHA (INSIG)”, dhe “EUROSIG SHA”, pjesëmarrëse në marrëveshjen e ndaluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik.
- II. Të gjobisë për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar:
 1. Ndërmarrjen “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SHA (SIGAL)”, në shumën prej 22.496.193 (njëzetedymilion e katërqind e nëntëdhjetegjashtëmijë e njëqind e nentëdhjete e tre) Lekë;
 2. Ndërmarrjen “SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SHA (SIGMA)”, në shumën prej 14.050.348 (katërmëdhjetëmilion e pesëdhjetëmijë e treqind e dyzetetë) Lekë;
 3. Ndërmarrjen “ATLANTIK SHA”, në shumën prej 11.141.914 (njëmbëdhjetëmilion e njëqind e dyzetënjëmijë e nentëqind e katërmëdhjetë) Lekë;
 4. Ndërmarrjen “INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP SHA (INTERSIG)”, në shumën prej 12.213.514 (dymbëdhjetëmilion e dyqindetrembëdhjetmijë e pesëqindekatërmëdhjete) Lekë;
 5. Ndërmarrjen “INTERALBANIAN SHA”, në shumën prej 7.271.207 (shtatëmilion e dyqindeshtatëdhjetënjëmijë e dyqindeshtatë) Lekë;
 6. Ndërmarrjen “ALB - SIGURACION SHA (ALBSIG)”, në shumën prej 9,362,548 (nëntëmilion e treqindegjashtëdhjetedymijë e pesëqindedyzetetë) Lekë;

7. Ndërmarrjen “INSTITUTI I SIGURIMEVE SHA (INSIG)”, në shumën prej 3,257,583 (tremilion e dyqindpesëdhjetëeshtatë mijë e pesëqindetëdhjetë) Lekë;
 8. Ndërmarrjen “EUROSIG SHA”, në shumën prej 9,151,357 (nëntë milion e njëqindpesëdhjetë mijë e treqindpesëdhjetëeshtatë) Lekë;
- III.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për komunikimin e tij ndërmarrjeve të mësipërme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 247, datë 09. 10. 2012

“Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjet e tij të datës 4.10.2012 dhe 9.10.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e marrëveshjes së ndaluar për fiksimin e çmimit në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL).

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.; Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999; “Kodi i procedurave administrative”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL), të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës dhe Relacionit të Sekretares së Përgjithshme;
- Diskutimeve të trajtuara në tryezën e rrumbullakët me Autortetin e Mbikqyrjes Financiare, datë 24.09.2012.

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 222, datë 11.04.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm

motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”, vendosi hapjen e hetimit të thelluar në këtë treg për periudhën kohore nga 01.01.2011 deri në 30.04.2012.

2. Produkti i sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit (MTPL e brendshme) është një kontratë e lidhur midis siguruesit (Shoqëritë e Sigurimit) dhe pronarit të mjetit motorik, i cili pranon kushtet e siguruesit. Kushtet e sigurimit janë pjesë e pandashme e kontratës së sigurimit, të cilat miratohen nga AMF-ja. Ky produkt hyn në klasën e sigurimeve të detyrueshme dhe është unik në llojin e vet, pra nuk ka zëvendësues.
3. Primi i shitjes (çmimi përfundimtar) së policës së sigurimit mbetet faktori përcaktues për zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës në rastin e produktit MTPL e brendshme, produkt i cili është i detyrueshëm për përdoruesit e mjeteve motorrike.
4. AMF-ja miraton rregullat për përcaktimin e kushteve të përgjithshme të sigurimit të detyrueshëm dhe nivelin e rezervave teknike dhe provigjoneve. Shoqëria e sigurimit përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, dhe fillon t’i zbatojë ato, pasi njofton zyrtarisht AMF-në. Kur AMF-ja vëren se kushtet e përgjithshme të sigurimit nuk janë në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore, miraton vendime, të cilat trajtojnë mënyrën, sipas së cilës shoqëria e sigurimit duhet t’i përputhë ato.
5. Me ndryshimet e ndodhura në nenin 10 të Ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, kompetencën për miratimin e primit të sigurimit të detyrueshëm, e kanë vetë shoqëritë të sigurimit, të cilat kishin vetëm detyrimin për ta njoftuar paraprakisht AMF-në për tarifën që do të aplikonin.
6. Por në zbatimin praktik, me Vendimin e Bordit Nr.111, datë 28.07.2011(pra pas miratimit të Ligjit Nr. 10455, datë 21.07.2011 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10076), AMF-ja ka miratuar tabelën e primit të rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorrik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti. Këto tabela janë të hartuara nga Shoqata e Aktuarëve ku vihet re një bashkëveprim mes konkurrentëve për të përcaktuar primin e rrezikut.
7. Në zbatim të nenit të mësipërm (neni 10) AMF-ja me Vendimin e Bordit Nr.110, datë 28.07.2011, miratoi Rregulloren “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e cila shfuqizoi rregulloren e mëparshme Nr. 75, datë 28.08.2009, “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.
8. Referuar nenit 1 të kësaj Rregulloreje, objekti i saj është përcaktimi i nivelit të provigjoneve teknike, përmbajtjes së bazës teknike të të dhënave, metodikave për përlllogaritjen e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
9. Referuar, nenit 4 të Rregullores së mësipërme, AMF-ja përcakton primin e rrezikut për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorrik jo më pak se 1 (një) herë në vit, mbi bazën e të cilit llogaritet provigjoni teknik i primit të pafituar.
10. Në zbatim të nenit 8 të Rregullores, Shoqëritë e sigurimit njoftojnë AMF-në 10 ditë përpara fillimit të zbatimit të tarifave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, së bashku me njoftimin depozitojnë dhe bazat teknike të

përdorura, metodikën e përdorur për llogaritjen e primit të sigurimit për produktet e sigurimit të detyrueshëm, si dhe materiale mbështetëse.

11. Kur shoqëria e sigurimit zbaton tarifa të primit të sigurimit të detyrueshëm, më të ulëta se primi i rrezikut i përcaktuar nga tabelat e Autoritetit, ose të tilla që produkti rezulton me humbje, atëherë shoqëria duhet të depozitojë në AMF së bashku me tarifat dhe një plan biznesi, i cili ndër të tjera duhet të përmbajë mënyrën dhe kohën e kompensimit të humbjes.
12. Në pikën 3 të nenit 9 të Rregullores së mësipërme, është përcaktuar kushti që shoqëria e sigurimit mund të ndryshojë tarifat e primeve për sigurimin e detyrueshëm, por jo më shpesh se 1 (një) herë në 6 muaj.
13. Referuar pikës së mësipërme, pika 3 e nenit 9 të Rregullores “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, nuk është në një frymë me nenin 10 të Ligjit 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar, në bazë të të cilit është hartuar kjo rregullore. Sipas nenit 10 të këtij Ligji, shoqëria e sigurimit e përcakton vetë tarifën e primit të sigurimit sipas kushteve të tregut. Duke patur parasysh se kushtet e tregut ndryshojnë, në bazë të këtij neni çmimet janë të liberalizuara, shoqëria duhet të jetë e lirë që të ndërveprojë me çmime të ndryshme në çdo kohë, pra mos të ketë kufizime kohore për ndryshim çmimi.
14. Me anë të kësaj rregulloreje të nxjerrë nga ana e AMF kompanitë e sigurimit mund të kenë vetëm 2 çmime në harkun kohor të një viti, duke sjellë në këto kushte një ngurtësim dhe pamundësi të kompanive të sigurimit për të operuar në një treg konkurrencial, i cili ka në themelin e tij kërkesën dhe ofertën, që përcaktojnë edhe çmimin e produktit në treg. Në këto kushte, kur 8 kompani të sigurimeve të jo jetës nuk kanë fuqi mbi çmimin për një periudhë 6 mujore, çmimi i produktit MTPL e brendshme nuk vendoset mbi bazën e kërkesës dhe ofertës, pra mekanizmi i tregut është i bllokuar duke mos lejuar konkurrencën midis kompanive ku çmimi në rastin e MTPL-së është edhe faktori përcaktues.
15. Dispozita e mësipërme e Rregullores, (pika 3 e nenit 9) ul fleksibilitetin e këtij tregu, për një periudhë 6 mujore pavarësisht kushteve të tregut të cilat mund të ndryshojnë vazhdimisht.
16. Ndërkohë në vendet e zhvilluara, primi i sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive ndaj palëve të treta përcaktohet në bazë të sistemit BONUS-MALUS. Vendosja e këtij sistemi i jep mundësi çdo kompanie që të aplikojë një prim shitje për produktin MTPL e brendshme mbi bazën e dëmeve të shkaktuara nga mbajtësi i policës, përvojës së drejtuesit të mjetit motorrik, moshës së drejtuesit të mjetit, fuqisë motorike, etj. Nga ana tjetër ky sistem i jep mundësi kompanisë që të jetë e lidhur në mënyrë direkte me mbajtësin e policës së sigurimit, i cili në rast aksidenti, pavarësisht në është fajtor apo jo, përfiton nga ana e kompanisë së tij dëmshpërblim për dëmet shëndetësore individuale.
17. Sistemi Bonus-Malus në thelbin e vet jo vetëm rrit konkurrencën duke i dhënë mundësi që kompania të ketë një çmim të diversifikuar për çdo klient dhe tregu të operojë në tërësinë e vet me çmime konkurrenciale, por nga ana tjetër edhe penalizon drejtuesit e mjeteve që paraqesin rrezikshmëri të lartë në rrugë, duke ndikuar pozitivisht në uljen e numrit të aksidenteve.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:**I. T’i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:**

- I.1. Ndryshimin e pikës 3, të nenit 9 të Rregullores Nr. 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, duke ulur afatin minimal për ndryshimin e primit të sigurimit.
- I.2. Implementimin në një kohë sa më të afërt të sistemit *bonus-malus*, i cili do të krijonte mundësi për një diversitet dhe aplikim të primeve të ndryshme për çdo policë sigurimi të detyrueshëm motorik, duke rritur në këtë mënyrë konkurrencën midis kompanive që operojnë në këtë treg.
- I.3. Të shmanget bashkëveprimi i aktuarëve të kompanive të sigurimit me njëri tjetrin në procesin e përlogarritjeve të primeve të rrezikut dhe ky proces të realizohet nga AMF mbështetur në të dhënat e siguruara në mënyrë të pavarur nga shoqëritë e sigurimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()

()

()

()

Zv/Kryetare

Anëtare

Anëtar

Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 248, datë 11. 10. 2012

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.10.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e shkeljes së konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.
Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

KONSTATOI:

I. PROCEDURA E NDJEKUR:

1. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 218, datë 23.02.2012 vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës, për të parë nëse ka ose jo, shenja të pengimit, kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës.
2. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, grupi i punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion Drejtorisë së Përgjithshme Detare, agjencisë detare “Gerveni Travel” dhe agjencisë detare “Marina Lines”, si dhe ka kryer inspektime pranë këtyre ndërmarrjeve.
3. Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit paraprak të hetimit në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës, vërejtë se në tregun përkatës, në transportin detar të pasagjerëve dhe mallrave Vlorë-Brindisi gjatë periudhës hetimore, kanë ndodhur ndryshime strukturore, pasi njëri nga konkurrentët, “FLANMARE LINES” INC, nuk e ushtron aktivitetin për shkak të pezullimit nga autoritetet italiane dhe në këtë mënyrë struktura e tregut ndryshon nga duopol në monopol. Ardhja e sezonit të verës (“peak”) e gjen tregun përkatës me një operator të vetëm në kushtet kur kërkesa ka rritje të fortë dhe fuqia kundërvepruese e blerësve në tregun përkatës është e ulët.
4. Për arsyet e mësipërme, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr.232, datë 16.07.2012 “Për një ndryshim në vendimin Nr. 218, datë 23.02.2012 “Mbi hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës”, vendosi zgjatjen e afatit të hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës.

II. NDËRMARRJET NËN HETIM

5. Në Portin e Vlorës ushtrojnë veprimtarinë e transportit detar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve nga Porti i Vlorës në Portin e Brindisit në Itali dhe anasjelltas 2 (dy) ndërmarrje “FLANMARE LINES SA” dhe NORTH BAY LDA”, me anë të trageteve të tyre RED STAR 1 dhe IONIAN SPIRIT. Këto 2 (dy) ndërmarrje meqenëse janë pronarë të mjetit lundrues (tragetit) dhe nuk janë të regjistruara në Shqipëri, në bazë të nenit 2, pika 9 të Udhëzimit nr. 10, datë 23.06.2008 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve të operimit në fushat e transportit detar”, nuk mund të kryejnë shërbimin e agjentit detar për anijen e tyre. Për këtë arsye këto 2 ndërmarrje kanë lidhur kontrata me 2 (dy) agjenci detare që ushtrojnë veprimtari në portin e Vlorës, përkatësisht agjencinë detare “MARINA LINES” dhe agjencinë detare “GERVENI TRAVEL”, për t’i përfaqësuar në marrëdhëniet e tyre me autoritetet shtetërore dhe të shërbimeve në port.

II.1. “FLANMARE LINES” INC

6. Referuar Licencës Nr. 1, datë 29.03.2012, të lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, ndërmarrjes “FLANMARE LINES” INC i është dhënë leja për të operuar në linjën ndërkombëtare Vlorë – Brindisi – Vlorë me afat deri më

31.12.2012. Gjithashtu kjo ndërmarrje është e detyruar të zbatojë itinerarin e linjës, oraret dhe tarifatat të cilat janë bashkëlidhur licencës. Sipas licencës, kjo ndërmarrje operon në këtë linjë ndërkombëtare 5 herë në javë me anë të tragetit “IONIAN SPIRIT”, përkatësisht ditën e hënë, të mërkurë, të premte, të shtunë dhe të diele.

7. Referuar informacionit të ardhur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga SHA “Porti Detar” Vlorë, midis ndërmarrjes “FLANMARE LINES” INC dhe ndërmarrjes “MARINA LINES” SHPK ekzistojnë disa marrëveshje, sipas të cilave ndërmarrja “FLANMARE LINES” INC cakton si agjent portual të saj në Portin e Vlorës ndërmarrjen “MARINA LINES” SHPK. Agjenti sipas kësaj marrëveshjeje do të mbulojë shitjen e biletave dhe faturave të ankorimit për tragetin IONIAN SPIRIT për linjën Vlorë – Brindisi. Në këto marrëveshje caktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me objektin e kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu përcaktohet dhe përqindja që përfiton agjenti nga shitja e biletave. Ndërmarrja “FLANMARE LINES” INC i siguron agjentit të gjitha materialet, si biletat, broshurat dhe materiale të tjera publiciteti për promovimin e biznesit.

II.2. “NORTHBAY” LDA

8. Referuar Licencës Nr. 2, datë 29.03.2012, të lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, e cila është vënë në dispozicion nga MPPT në përgjigje të kërkesës për informacion, ndërmarrjes “NORTHBAY” LDA i është dhënë leja për të operuar në linjën ndërkombëtare Vlorë – Brindisi – Vlorë me afat deri më 31.12.2012. Gjithashtu kjo ndërmarrje është e detyruar të zbatojë itinerarin e linjës, oraret dhe tarifatat të cilat janë bashkëlidhur licencës. Sipas licencës, kjo ndërmarrje operon në këtë linjë ndërkombëtare 5 herë në javë me anë të tragetit “RED STAR 1”, përkatësisht ditën e hënë, të martë, të enjte, të premte dhe të shtunë.
9. Referuar informacionit të ardhur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga SHA “Porti Detar” Vlorë, si dhe dokumenteve të gjetura gjatë inspektimit në ambientet e ndërmarrjes “GERVENI TRAVEL” SHPK, midis ndërmarrjes “NORTHBAY” LDA dhe ndërmarrjes “GERVENI TRAVEL” SHPK ekzistojnë disa marrëveshje agjencie (Agency Agreement), sipas të cilave ndërmarrja “NORTHBAY” LDA cakton si agjent portual të saj në Portin e Vlorës ndërmarrjen “GERVENI TRAVEL” SHPK. Agjenti sipas këtyre marrëveshjeve ka për detyrë të merret me të gjitha marrëdhëniet me autoritetet portuale, përfshirë dhe praktikatat e ardhjes dhe të nisjes për tragetin “RED STAR 1” për linjën Vlorë – Brindisi. Në këto marrëveshje caktohen në mënyrë më specifike shërbimet që kryen agjenti (“GERVENI TRAVEL” SHPK).
10. Nga SHA “Porti Detar” Vlorë janë dërguar dhe kontratat e përpunimit të tragetit datë 05.01.2010, datë 25.01.2011 dhe datë 14.12.2011, të lidhura midis SHA “Porti Detar” Vlorë dhe ndërmarrjes “NORTHBAY” LDA me seli në Madera-Portugali, përfaqësuar nga agjencia detare “GERVENI TRAVEL” SHPK, e cila, referuar udhëzimit nr. 10, datë 23.06.2008 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve të operimit në fushat e transportit detar”, është e detyrueshme të paraqitet pranë MPPT-së për marrjen e lejes për të operuar në linjë të rregullt ndërkombëtare detare për transport automjetesh dhe udhëtarësh.
11. Në këto kontrata janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve, pagesat për shërbimet që përfiton ndërmarrja nga Porti Vlorë, si dhe sanksionet përkatëse për shkeljen e dispozitave të kontratës.

12. Nga kontratat e lidhura nga dy ndërmarrjet “FLANMARE LINES” INC dhe “NORTHBAY” LDA me agjentët përkatës rezulton se këto dy ndërmarrje kanë të drejta të plota për sa i përket politikës së çmimeve dhe aktivitetit në tërësi për shërbimin e transportit detar në Portin e Vlorës. Por, pavarësisht se këto dy ndërmarrje nuk janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, ato referuar nenit 2, pika 1, germa (b) të Ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” janë subjekt i këtij Ligji dhe veprimtaria e tyre duhet të jetë në përputhje me këtë Ligj.

III. ANALIZA E KONKURRENCËS

III.1 Tregu përkatës

13. Bazuar në udhëzimin e tregut përkatës, tregu përkatës i produktit është shërbimi i transportit të automjeteve dhe udhëtarëve në linjën Vlorë-Brindizi-Vlorë nga Porti i Vlorës. Shërbimi i transportit të automjeteve dhe udhëtarëve në Portin e Vlorës ofrohet nga ndërmarrjet “FLANMARE LINES SA” dhe NORTH BAY LDA”, të përfaqësuara përsa i përket marrëdhënieve me autoritetet shtetërore dhe të shërbimeve portuale nga agjencitë detare “Marina Lines” dhe agjensia “Gerverni Travel”

III.2 Pjesët e tregut, konkurrentet dhe treguesit e përqendrimit

III.2.1 Pjesët e tregut dhe konkurrentët

14. Për te vlerësuar madhësinë totale të tregut dhe pjesët e tregut të ndërmarrjeve është përpunuar informacioni mbi te ardhurat e realizuara, numri i pasagjereve dhe numri i automjeteve për periudhën 2010-Prill 2012 i sjelle nga dy agjencitë Gerverni Travel dhe Marina Lines përfaqësuese te ndërmarrjeve “NORTHBAY” dhe “FLANMARE LINES”
15. Madhësia totale e tregut për nga treguesi i të ardhurave të realizuara në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010 ka rënë me 2.6%, ndërsa tregu ka pësuar një rritje me rreth 17% për sa i përket numrit të udhëtarëve. Sipas të ardhurave të realizuara ndërmarrja “Northbay” për vitin 2010 zotëron një pjesë tregu prej 65.5%, në vitin 2011 ul pjesën e tregut duke arritur ne 49.6% dhe në 4 mujorin 2012 pjesa e tregut rritet përsëri në 69.9%. Ndërsa ndërmarrja “FLANMARE LINES” rrit pjesën e tregut nga 34.5 në vitin 2010 në 50.4 në vitin 2011, duke rënë përsëri në 30.1% në periudhën Janar-Prill të vitit 2012.
16. Për përcaktimin e pjesëve të tregut përkatës për një reflektim të pozicionit relativ dhe fuqisë së çdo ofruesi, përveç të ardhurave nga shitja e shërbimit është vlerësuar edhe numri i pasagjerëve dhe numri i automjeteve.
17. Ndërmarrja me pjese me te madhe tregu për sa i përket numrit të pasagjerëve është ndërmarrja “NORTHBAY”, e cila ka ulur pjesën e tregut me 8% për vitin 2011 dhe për 4 mujorin e parë ka rritur ndjeshëm pjesën e tregut duke arritur në 72%. Ndërmarrja “FLANMARE LINES ka rritur pjesën e tregut me 8% në vitin 2011 dhe ka ulur ndjeshëm këtë pjesë për 4 mujorin 2012. Ndërmarrjet kanë rritur ofertën totale lidhur me numrin e pasagjerëve nga 80 850 ne vitin 2010 në 97 432 në vitin 2011, ose 20.5% më shumë, ofertë e cila ka ardhur kryesisht nga rritja e numrit të pasagjerëve të ndërmarrjes në pjesë më të vogël në treg.

18. Sipas numrit të automjeteve ndërmarrja “NORTHBAY” ka ulur pjesën e tregut me 4% në vitin 2011 dhe 9% në 4 muajorin 2012, duke e rritur këtë pjesë ndërmarrja “FLANMARE LINES”. Numri i automjeteve në total ndonëse është ulur në krahasim me vitin 2010, ndërmarrja me pjesë më të vogël “FLANMARE LINES” ka rritur këtë pjesë në vitin 2011 me 4% në krahasim me vitin 2010.
19. Duke vlerësuar pjesën e tregut nga të ardhurat e realizuara, numri i pasagjerëve dhe numri i automjeteve rezulton se ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu ka ulur pjesën e tregut për vitin 2011 në krahasim me vitin 2010 dhe e ka rritur këtë pjesë për 4 muajorin 2012. Ndonëse numri i pasagjerëve në total është rritur gjatë vitit 2011 të ardhurat e realizuara janë ulur në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010. Për sa më lart, pjesët e ndryshme të tregut të ndërmarrjeve në vite, ulja e të ardhurave të realizuara nga shërbimi i transportit detar të udhëtarëve dhe automjeteve për vitin 2011 krahasuar me vitin 2010 në një kohë që numri i udhëtarëve është rritur, tregon se nuk kemi të bëjmë me një rritje mesatare të çmimit të biletave në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010.

III.2.2 Kufizimet në kapacitete

20. Trageti Red Star ka një kapacitet të mjeteve motorike prej 130 automjete në ditë dhe 680 pasagjerë, ndërsa trageti tjetër Ionian Spirit prej 780 pasagjerë dhe 250 automjete.
21. Nga të dhëna e mbledhura konstatohet se tragetet udhëtojnë nën kapacitet. Pra përjashtojnë periudhat e pikut (Gusht-Shtator dhe Dhjetor-Janar), muajt e tjerë kanë një mesatare të numrit për udhëtim tepër të vogël. Ky numër i vogël i pasagjerëve dhe i makinave sjellin kosto shtesë për operatorët e kësaj linje.

III.3. Kufizimet e mundshme të konkurrencës

22. Analiza e kufizimit të mundshëm të konkurrencës në tregun përkatës është mbështetur në dy pistat kryesore që përcakton Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës”, abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese (nisur nga pjesët e tregut, barrierat e hyrjes në treg dhe faktorë të tjerë) dhe marrëveshjet potenciale të ndaluara.

III.3.1 Abuzimi i mundshëm me pozitën dominuese

23. Bazuar në kriterin e pjesës së tregut sipas të ardhurave, shohim se pjesët e tregut të ndërmarrjes “NORTHBAY” e cila ka në pronësi tragetin “Red Star 1”, janë ulur në vitin 2011 në 49.6% nga 65.5% që kishte kjo ndërmarrje në vitin 2010. Ndërsa ndërmarrja tjetër FLANMARE LINES, e cila ka në pronësi tragetin Ionian Spirit ka rritur pjesën e saj të tregut nga 34.5% në 50.4%. Nga pjesët e tregut që zotërojnë individualisht këto dy ndërmarrje, konkludon se jemi përpara një dominancë kolektive, treg duo-pol ku ndërmarrjet zotërojnë fuqi përsa i përket strukturës së tregut.

III.3.2. Ekzistenca ose jo e marrëveshjeve të ndaluara (praktika e bashkërenduar)

24. Për të parë nëse ndërmarrjet që operojnë në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës koordinojnë

sjelljet e tyre në tregun përkatës janë realizuar inspektime të formës *dawn raids*, ku nga inspektimi nuk u gjet asnjë evidencë direkte e bashkëpunimit midis 2 (dy) ndërmarrjeve.

25. Duke qenë se nuk u gjetën evidenca direkte të bashkëpunimit, si dhe nga analiza e tregut përkatës rezultoi një shkallë e lartë përqendrimi, është analizuar, nëse kjo fuqi tregu vjen si rezultat i koordinimit të sjelljeve të ndërmarrjeve në tregun përkatës nëpërmjet evidencave indirekte të bashkëpunimit.

III.3.2.1 Sjellja ne lidhje me tarifat

26. Bashkëlidhur. licencës së MPPT¹ operatorët në tregun e transportit detar ne qytetin e Vlorës kanë miratuar tarifat (tavan) të udhëtimit për pasagjerët dhe për mjetet, ku miratimi i tyre përfshin: Biletën e udhëtimit për linjën Vlorë-Brindisi dhe anasjelltas e cila është e ndryshme për cilësi të ndryshme akomodimi; dhe tarifën për imbarkimin e mjeteve të udhëtimit për linjën Vlorë-Brindisi dhe anasjelltas. □
27. Nga analiza e çmimeve të biletave të aplikuara nga ndërmarrjet, rezulton se tarifat e aplikuara nga ato janë poshtë tavanit të miratuar nga MPPT dhe ofrojnë përgjithësisht tarifa të ndryshme. Ulja e tarifave për ndërmarrjen me pjesë më të vogël ka çuar në rritjen e numrit të pasagjerëve, automjeteve, duke e ulur pjesën e tregut të ndërmarrjes më të madhe.

III.3.2.2 Ndarja e tregut

28. Nga analiza e pjesëve të tregut në 2 vite të ndërmarrjeve rezulton se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës, pjesët e tregut i kanë në lëvizje duke mos patur një qëndrueshmëri në vite, por edhe në periudha më të shkurtra disa mujore. Kështu, sipas të ardhurave ndërmarrja “North Bay Lda” në vitin 2011 ka ulur pjesën e tregut rreth 15%, ndërsa sipas numrit të pasagjerëve, ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu ka ulur pjesën e tregut me 8% dhe ndërmarrja me pjesë më të vogël të tregut ka rritur pjesën e tregut me 8%, ndërsa sipas numrit të automjeteve ndërmarrja më e madhe ka ulur pjesën e tregut me 4% duke e rritur këtë pjesë ndërmarrja më e vogël. Gjithashtu ndërmarrjet kanë rritur ofertën totale lidhur me numrin e pasagjerëve nga 80 850 në vitin 2010 në 97 432 në vitin 2011 ose 17% më shumë, ofertë e cila ka ardhur kryesisht nga rritja e numrit të pasagjerëve të ndërmarrjes më të vogël.
29. Si përfundim, referuar gjetjeve gjatë kryerjes së inspektimeve të befasishme (Dawn Raids) pranë agjencive detare, si dhe nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit detar të automjeteve dhe udhëtarëve në Portin e Vlorës, për sa i përket analizës së tarifave të shitjes së shërbimit të transportit detar, ndarjes së tregut, kufizimit të ofertës, rezulton se nuk janë gjetur evidenca direkte dhe indirekte të bashkëpunimit midis dy ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun përkatës, duke mos patur një marrëveshje, apo praktikë të bashkërenduar midis tyre.

1 Burimi shkresa nr 227/1 datë 16.04.2012

Sa më lart, nga hetimi paraprak nuk provohet se ka shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës sa i përket abuzimit me pozitën dominuese, apo marrëveshjeve të ndaluara në tregun përkatës të shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve dhe automjeteve nga dhe drejt qytetit të Vlorës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit për palët nën hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

(_____)

(_____)

(_____)

(_____)

Zv/Kryetare

Anëtare

Anëtar

Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 249, datë 09. 11. 2012

**“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit,
prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 9.11.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Bazuar në ankesën mbi rritjen e çmimit të vajit vegjetal në mënyrë abuzive nga disa ndërmarrje si dhe fiksimin e tij, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të

Konkurrencës me anë të Urdhrit nr. 105, datë 20.09.2012 ngriti grupin e punës për monitorimin e tregut të prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal.

2. Në vijim të procedurës, Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të monitorimit të tregut të importit të vajit vegjetal, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar) me anë të Vendimit Nr. 245, datë 02.10.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.
3. Periudha objekt hetimi, e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në vendimin e mësipërm është Janar – Tetor 2012.
4. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nenit 22 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” vendimit nr. 245, datë 02.10.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, me anë të Urdhrit Nr. 108, datë 02.10.2012 “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.
5. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, grupi i punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga Instituti i Statistikës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe nga ndërmarrjet “TEUTA” SHPK, “ERBIRON” SHPK, “OLIM” SHA, “BOMIRA” SHPK, “CRYSTAL” SHPK dhe “VAJRA BIMORE”, në përgjigje të të cilave është administruar dhe informacioni përkatës.
6. Në bazë të nenit 36 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 598/2, datë 02.10.2012 “Autorizim Inspektorësh”, grupi i punës gjatë periudhës së hetimit procedoi me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal.
7. Inspektimet e kryera pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në këtë treg ishin të befasishme (Down Raids) dhe u kryen njëkohësisht në të 3 (tre) ndërmarrjet që përmendeshin në ankesën e ardhur pranë Autoritetit të Konkurrencës. Më datë 03.10.2012 janë inspektuar ndërmarrjet: “OLIM” SHA, “TEUTA DURRE” SHPK dhe “ERBIRON” SHPK, ku u mbajtën dhe procesverbalet përkatëse, si dhe në datë 08.10.2012 ndaj operatoreve të tjere në këtë treg.

II. TREGU PËRKATËS

8. Në zbatim të Udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës, vlerësohen dy dimensionet e tregut përkatës:
 - 1) Tregun e produkteve
 - 2) Tregun gjeografik.

9. Bazuar në Vendimin nr. 245 të Komisionit të Konkurrencës, datë 02.10.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, tregu përkatës i produktit përfshin:
- ☐ ***Tregun e importit të vajit vegjetal***
 - ☐ ***Tregun e prodhimit të vajit vegjetal***
 - ☐ ***Tregun e shitjes me shumicë të vajit vegjetal;***
10. Kërkesat për vaj në tregun shqiptar sigurohen nga tregu vendas dhe nga importi. Vaji që sigurohet nga importi mund të jetë vaj i rafinuar (i përpunuar) dhe vaj i parafinuar (i papërpunuar). Vaji i rafinuar që importohet është i llojeve të ndryshme si: vaj luledielli, vaj kikiriku, vaj ulliri, vaj misri, vaj soje, vaj industrial, vaj ëmbëlsirash, etj. Vaji vegjetal përfshin: vaj luledielli, vaj kikiriku dhe vaj misri, etj (me përjashtim të vajit të ullirit)¹.
11. Për prodhimin e vajit në vend, si lëndë e parë shërben vaji i papërpunuar që importohet. Vaji i papërpunuar që importohet është vetëm vaj luledielli. Pra, tregu përkatës i prodhimit përfshin vajin vegjetal të prodhuar në vend.
12. Nevojat konsumatore për vaj vegjetal mbulohen si nga vaji vegjetal i importuar ashtu dhe vaji vegjetal i prodhuar në vend. Pra, tregu përkatës i shitjes me shumicë është vaji vegjetal i importuar dhe ai i prodhuar në vend. Sipas të dhënave të deritanishme importi i vajit rezulton se vaji i importuar zë rreth 65% të konsumit, tregues ky pothuajse i njëjte me atë të vitit të kaluar, gjë e cila tregon për një rritje të prodhimi dhe tregtimit të produktit vendas.
13. Në tregun e importit dhe të shitjes me shumicë të vajit vegjetal operojnë shumë ndërmarrje, ndërsa në tregun e prodhimit operojnë vetëm dy ndërmarrje. Ndërmarrjet dalin në treg me një shumëllojshmëri markash si: Olim me markën Olim, Vajra Bimore me markën Fiol, Erbiron me markën Floriol, Crystal me markën Crystal, Bomira me markën Bomira, Ferra&Co me markën Bimal, etj. Ekzistenca e shumë markave në treg bën që të ketë shumëllojshmëri zgjedhjeje për konsumatorët.
14. Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës, për nga përdorimi, vaji i lulediellit ka përdorim më të gjerë në familje si për gatim, skuqje dhe sallatë. Vaji industrial dhe vaji i ëmbëlsirave janë përjashtuar nga tregu përkatës, sepse i pari përdoret për pajisje pune, ndërsa i dyti përdoret në punishtet e ëmbëlsirave, pra të dy këto lloje vajrash nuk kanë përdorim familjar. Vaji i sojës përdoret për gatim dhe ka vlera të larta ushqyese dhe kuruese (omega 3), por përdoret nga një kategori e caktuar, kryesisht nga personat mbi moshën 50 vjeç dhe ka një çmim shumë më të lartë se vaji i lulediellit. Vaji i misrit ka vlera të larta ushqyese, përdoret për gatim dhe skuqje, por për shkak të çmimit më të lartë, nuk përfshihet në tregun përkatës (megjithëse është një nga llojet e vajit vegjetal). Nga ana e ofertës produktet janë të zëvendësueshme, sepse ndërmarrjet importuese janë të lira të zgjedhin llojin e vajit që duan të importojnë. Pra, tregu përkatës i importit përfshin vajin e lulediellit.
15. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre në të gjithë territorin e Shqipërisë. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofrimi, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
16. Si konkluzion tregu përkatës përbëhet nga vaji i lulediellit në tregun gjeografik në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

1 Nr. 604, datë 17.11.2000 “Për Etiketimin e Produkteve Ushqimore”

III. Karakteristikat e tregut përkatës

1.1.1 Tregu i importit të vajit të lulediellit

17. Nga analiza e strukture së tregut të importit të vajit vegjetal, rezulton se ky treg ka karakteristikat e një tregu oligopolistik ku indeksi i përqendrimit është shumë i lartë, ku tre ndërmarrjet kryesore në treg zotërojnë 83.5% të tregut dhe shumë ndërmarrje të tjera kanë 1-2% të tregut. Me përjashtim të ndërmarrjes Erbiron e cila importon vaj të ambalazhuar nga Hungaria, të gjitha ndërmarrjet e tjera kanë ndryshuar burimet e furnizimit.
18. Çmimi i importit të vajit gjatë 2012 ka ardhur në rritje ku vlera më e lartë i përket muajit shtator 2012 me rreth 8% me shumë se muaji paraardhës dhe rreth 19.3% krahasuar me çmimin më të ulët të vitit (shkurt 2012).

1.1.2 Tregu i prodhimit të vajit vegjetal luledielli

Tregu i prodhimit të vajit vegjetal përbëhet nga dy ndërmarrje që kryejnë përpunimin e vajit të papërpunuar që merret nga importi, të cilat janë Olim dhe Vajra Bimore. Si lëndë e parë për prodhimin e vajit në vend shërben vaji i papërpunuar që importohet. Për këtë arsye kemi analizuar dhe ndërmarrjet importuese të vajit të papërpunuar. Vaji i papërpunuar që importohet i nënshtrohet proceseve të neutralizimit, de-kolorimit dhe de-odorimit. Pas këtij procesi vaji që prodhohet pakëtohet në shishe 1, 2, 3, 4 dhe 5 litërshe. Krahas kostonë së importit ku përfshihet edhe akciza ka kosto prodhimi, marketingu, etj.

19. Nga analiza e të dhënave të DPD ka rezultuar se ndërmarrjet nuk kanë bërë blerje të përbashkëta për të ndarë shpenzimet dhe kanë burime të ndryshme furnizimi.

1.1.3 Tregu i shitjes me shumicë të vajit vegjetal luledielli

20. Kërkesat për vaj vegjetal në tregun shqiptar sigurohen nga importi i vajit të rafinuar dhe nga prodhimi në vend i vajit vegjetal.

- Struktura e tregut të shitjes me shumicë të vajit për vitet 2011-shtator 2012

Ndermarrjet	Pjesa e tregut J-SH 2012	Pjesa e tregut 2011
ERBIRON	22%	23%
OLIM	22%	19%
CRYSTAL	21%	15%
Vajrat Bimore	14%	22%
BOMIRA	11%	9%
FERRA & CO	2%	1%
ELLEDII -SHPK	1%	1%
EQEREM - 934 - SHPK	1%	0%
KRIKET - 1	1%	1%
TEUTA E.B	1%	0%
DESINA BALLKAN-	1%	1%
ALMECCO - SHPK	1%	0%
E & B	0%	1%
BEJKO BUCI	0%	0%

VAKO-TREG	0%	1%
ROLF KEKA	0%	0%
DANINA -SHPK	0%	3%
ARG-MASHA	0%	1%
Te tjera	1%	2%
Totali	100%	100%

Burimi: Të dhënat e sjella nga ndërmarrjet dhe DPD si dhe përpunimet e grupit të punës

21. Tre ndërmarrjet më të mëdha në tregun e shitjes me shumicë të vajit vegjetal të lulediallit janë Crystal, Olim dhe Erbiron, të cilët kanë respektivisht afërsisht nga 21-22 % të tregut përkatës për periudhën objekt hetimi.

1.1.4 Mundësi bashkërendimi të sjelljes

22. Grupi i punës ka realizuar dawn raids në të njëjtën ditë dhe orë në të tre ndërmarrjet që përmenden në ankesë, për gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një marrëveshje bashkëpunimi të mundshëm midis konkurrentëve, ose të një praktike të bashkërenduar midis ndërmarrjeve. Gjatë inspektimeve dhe nëpërmjet kërkesave për informacion janë administruar materiale të nevojshme për hetimin, për të bërë të mundur analizën nëpërmjet vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në tregjet përkatëse si vlerësimi i strukturës së tregut, sjellja në lidhje me çmimin, sasinë etj.
23. Nga analiza e strukturës së tregut të shitjes me shumicë u konstatua se ky treg është në kufirin e sipërm të një shkalle të moderuar përqendrimi dhe se shkalla e përqendrimit është rritur krahasuar me vitin 2011.

1.1.4.0.1 Krahاسimi i trendit të çmimit të shitjes me shumicë

24. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në lidhje me çmimin e shitjes me shumicë ka për qëllim të vlerësojë nëse ndërmarrjet vendosin direkt apo indirekt çmimet e shitjes me shumicë gjatë periudhës objekt hetimi Janar 30 - Shtator 2012. Në vlerësimin e trendit të ndryshimit të çmimit mesatar të shitjes me shumicë është marrë në konsideratë krahasimi i çmimit mesatar mujor të shitjes me shumicë të vajit vegjetal² që ka rezultuar nga përpunimi i të dhënave të sjella nga ndërmarrjet.





1.1.4.0.2 Ritmet dhe masa e ndryshimit të çmimeve mesatare të shitjes me shumicë në raport me çmimet mesatare të doganës

25. Vlerësimi i ritmeve të ndryshimit të çmimeve të doganës në raport me çmimet e shitjes me shumicë është bërë me qëllim që të shikohet nëse ndërmarrjet vendosin çmime indirekte të shitjes me shumicë nëpërmjet skemave për vendosjen e të njëjtave ritme ndryshimi midis dy çmimeve dhe nëse rritja e çmimit është rezultat i rritjes së çmimit të blerjes, apo i ndonjë sjellje të ndërmarrjeve në treg. Për këtë qëllim është bërë krahasimi midis çmimit mesatar mujor të vajit vegjetal të importuar, të llogaritur sipas të dhënave të doganës³ me çmimin mesatar mujor të shitjes me shumicë⁴.

2 Çmimi është llogaritur mbi mesataren e ponderuar

3 Çmimi mesatar mujor i doganës është llogaritur mbi bazën e mesatares së ponderuar e llogaritur si raport i vlerës mujore të importit me sasinë e importuar (në litra).

4 Çmimi mesatar i shitjes me shumicë, është një çmim i llogaritur mbi një mesatare të ponderuar të çmimit mesatar mujor i ndërmarrjeve të shumicës. Çmimi mesatar mujor i shitjes për çdo ndërmarrje është llogaritur si raport i vlerës së shitjeve mujore me sasinë përkatëse.



26. Referuar analizës së mësipërme, rezulton se ndërmarrjet Erbiron, Olim dhe Crystal, të cilat janë tre konkurrentët kryesorë në këtë treg, me pjesë tregu të përafërt (rreth 22 %) kanë aplikuar çmime të shitjes me shumicë të cilat:

- Nuk reflektojnë me çmimet në tregun ndërkombëtar në rastet kur ka ulje të çmimit në tregun ndërkombëtar;
- Konvergojnë në trendet e rritjes së çmimit për periudhën objekt hetimi

shenja këto që tregojnë se mund të ketë një sjellje të bashkërenduar të këtyre ndërmarrjeve, e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 dhe nenin 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit ndaj ndërmarrjeve Erbiron, Olim dhe Crystal.
- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga janari-tetor 2012.
- III. Procedura e hetimit të thelluar dhe përgatitja e raportit të përfundojë jo më vonë se data 30 Janar 2013.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()
Zv/Kryetare

()
Anëtare

()
Anëtar

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 250, datë 20. 11. 2012

“Mbi hapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit si rezultat i transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë Viloil Sh.a, nga shoqëria City Investment Holding S.A, tek aksioneret z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.11.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit si rezultat i transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë Viloil Sh.a, nga shoqëria City Investment Holding S.A, tek aksioneret z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti neni 59 “Procedura në mungesë njoftimi”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe informacionit të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut, në lidhje me transferimin 70% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë Viloil Sh.a, nga shoqëria City Investment Holding S.A, tek aksioneret z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko,

V Ë R E N S E:

- Shoqëria City Investment Holding S.A dhe z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko

aksionerë të shoqërisë Viloil Sh.a në datën 4 Shkurt 2012, kanë nënshkruar një marrëveshje me objekt shit-blerjen e 70% të kapitalit aksionar të shoqërisë Viloil Sh.a.

- Ky transaksion, në kuptim të nenit 10, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar) konsiderohet përqendrim.
- Transaksioni përmbush edhe kriteret e përcaktuara në nenin 12, pika 1 e Ligjit dhe si rrjedhim duhet të njoftohet në Autoritetin e Konkurrencës, në afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
- Shoqëria Viloil Sh.a nuk ka respektuar procedurën e njoftimit të përqendrimit

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 59 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

VENDOSI:

1. Të hapë me nismën e vet procedurën e kontrollit si rezultat i transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë Viloil Sh.a, nga shoqëria City Investment Holding S.A, tek aksioneret z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 251, datë 20. 11. 2012

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.11.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i ankesës mbi prokurimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin Korçë.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një ankese nëpërmjet së cilës pretendohet se SHRSF-të: “Vaso-Security”; “Security-Vaso”; “Alben 2 Security”; “E-Security”; bashkëpunojnë gjatë pjesëmarrjes në prokurimet publike në qytetin e Korçës, kryesisht të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor “Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë”, duke u bërë pengesë për hyrjen e operatorëve të tjerë në këtë treg. Në ankesën e paraqitur përmendet edhe kallëzimi penal i bërë nga Sh.r.s.f “Vaso-Security” shpk në Prokurorinë e Rrethit

Gjyqësor Korçë për këtë çështje.

Autoriteti i Konkurrencës është njohur me vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë lidhur me kallëzimin e mësipërm, pasi vetë Prokuroria e këtij rrethi e ka paraqitur këtë vendim pranë Autoriteti të Konkurrencës.

Sipas vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë dokumentet e tenderit të datës 26.03.2012, zhvilluar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë, të sh.r.s.f-ve “Hoxha Security”, “Nisa Security” dhe “Korça Security” janë plotësuar nga i njëjti person, duke qenë përpara rastit të një marrëveshjeje paraprake të tre firmave pjesëmarrëse në tenderin e mësipërm, që në rastin konkret kanë përcaktuar fituesin dhe kanë plotësuar dokumentacionin në mënyrën e duhur, si dhe kanë caktuar një person në lidhje me plotësimin e këtij dokumentacioni.

Nga përpunimi i informacionit të administruar nga ana e Autoritetit të Konkurrencës rezulton se në ofertat e paraqitura nga ndërmarrjet “Vaso Security”, “Security Vaso”, “Alben 2 Security” ka shenja të ngjashme të bashkëpunimit për të zbatuar skemën e ofertës së mbuluar, duke paraqitur oferta shumë të afërta me fondin limit dhe diferenca të vogla të ofertave në raport me njëra-tjetrën.

Nga ana tjetër shrsf “Korça Security”, rezulton të jetë pjesëmarrës në një marrëveshje potencialisht të ndaluar me shrsf-të “Hoxha Security” dhe “Nisa Security” gjatë pjesëmarrjes së tyre në procedurat e prokurimit të zhvilluara po nga Autoriteti Kontraktor “Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë”, me datë zhvillimi 26.03.2012, për periudhën nga data 05.04.2012 deri më datë 30.04.2012.

Përveç procedurës me negociim pa shpallje të datës 26.03.2012, ku fitues është shpallur “Korça Security” Sh.p.k (vetëm për periudhën nga data 05.04.2012 deri më datë 30.04.2012), të gjithë tenderët e tjerë me negociim pa shpallje, si dhe tenderi “Kërkesë për propozim”, janë fituar nga “Vaso Security” Sh.p.k për periudha të njëpasnjëshme.

Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg; si dhe në Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, këto shenja tregojnë për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet marrëveshjeve në oferta midis operatorëve në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.

- II. Periudha e hetimit do të jetë Janar 2011 - Tetor 2012.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraparak jo më vonë se data 17.12.2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 252, datë 26. 11. 2012

**“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor
qytetas të udhëtarëve, në qytetin e Tiranës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.11.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i ankesës mbi shkeljen e konkurrencës në fushën e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve, në qytetin e Tiranës.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve, në qytetin e Tiranës”.

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, shoqëria “Alba-Trans” sh.p.k ka paraqitur një ankesë nëpërmjet së cilës pretendon se Shoqata Kombëtare e Transportuesve Qytetas (SHKTQ) e përbërë nga anëtarët e saj: “Tirana Urban Trans”, “Tirana Lines” dhe “Ferlut”, të cilët operojnë në fushën e transportit rrugor qytetas, ka shkelur Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

“Alba-Trans”, e cila ka nxjerrë në shitje pa kartona abonete e muajit tetor-nëntor, pretendon se është demtuar nga refuzimi i konkurrentëve, për të njohur abonete pa karton të tregëtuar nga ankimuesi. Ky veprim sipas ankimuesit ka ardhur pas terheqjes nga SHKTQ.

Sipas Udhëzimit të MF nr. 11, dt. 25.06.2007 “Për organizimin, shtypjen dhe emetimin e biletave në transportin rrugor”, aboneja është biletë udhëtimi, që emetohet dhe shpërndahet nga DPT-ja, modeli i së cilës përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Problematikat e shfaqura në këtë treg, mund të përbëjnë një kufizim të mundshëm të konkurrencës në tregun e transportit rrugor të shërbimit qytetas të udhëtarëve, në qytetin e Tiranës.

Sa më sipër, bazuar në nenin 4, pika 1 dhe nenin 9 të Ligjit Nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ankesa e paraqitur përmban shenja për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun e transportit rrugor të shërbimit qytetas të udhëtarëve, në Qytetin e Tiranës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve, në qytetin e Tiranës, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Periudha e hetimit do të jetë nga korriku 2012 deri në përfundim të këtij hetimi.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 21.12.2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()
Zv/Kryetare

()
Anëtare

()
Anëtar

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 253, datë 03. 12. 2012

**“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit,
importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të
paketuar”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2012, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos.

Baza ligjore: Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe ai 43, (pika 1) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Raportit të hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës dhe relacionit te Sekretarit të Përgjithshëm ,

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit, mori Vendimin Nr. 233, datë 16.07.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/Importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.
2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nenit 22 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me anë të Urdhrit Nr. 96, datë 19.07.2012 “Për ngritjen e grupit të punës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen e procedurave të këtij hetimi.
3. Në zbatim të këtij vendimi inspektorët e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës kanë kryer inspektime dhe kanë administruar informacionin nga ndërmarrjet që veprojnë në këtë treg.

II. TREGU PËRKATËS

4. Përcaktimi i tregut përkatës është realizuar në bazë të Udhëzimit nr.76 dt 07/06/2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, bazuar në dy dimensione:

- α) *Tregu përkatës i produktit*
- β) *Tregu përkatës gjeografik*

II.1 Tregu përkatës i produktit

5. Tregu përkatës i produktit është çimento gri me bazë 42.5 R rifuxho dhe e paketuar pasi ka një zëvendësueshmëri të ulët me kategoritë e tjera të çimentos për shkak të çmimit dhe të karakteristikave që ai mbart. Ky produkt nuk mund të zëvendësohet me një produkt tjetër që ofrojnë ndërmarrjet e prodhimit dhe të shitjes së çimentos, për shkak të karakteristikave specifike që mbart dhe që kërkohen gjatë ndërtimit të strukturave të ndryshme inxhinjerike.

II.2 Tregu përkatës gjeografik

6. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm. Tregu gjeografik përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë.

III. KUFIZIMI I MUNDSHËM I KONKURRENCËS

7. Tregu i prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të produktit përkatës paraqet strukturën e një tregu me shkallë të lartë përqendrimi. Në këtë treg operojnë 3 ndërmarrje që prodhojnë në vend ndërsa dy prej tyre janë ndërmarrje importuese. Për periudhën objekt hetimi Janar – Gusht 2012, ndarja e tregut është si vijon:
 - “Fushë Kruja Cement” zë rreth 36%,
 - Antea Cement zë një pjesë rreth 34% të tregut të brendshëm,
 - Elbasan Cement zë pjesën prej 13 % të tregut,
 - Eurotech zë rreth 12% të tregut
 - Colacem Albania zë pjesën prej 5% të tregut.

8. Nga analiza e informacioneve të siguruara gjatë hetimit paraprak si dhe e faturave, konstatohet se të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari, si në tregun e prodhimit ashtu edhe të importit të produktit çimento 42.5 (Rifuxho dhe të pakeluar), duke filluar nga data 22 shkurt 2012 (Ndërmarrjet prodhuese) deri në datën 2 Mars 2012 (Ndërmarrjet importuese), kanë rritur në mënyrë të njëkohshme dhe në një masë të konsiderueshme çmimin e tregtimit me shumicë të këtij produkti.
9. Këto shenja në kuptim të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjnë një kufizim, pengim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun përkatës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, (shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të pakeluar ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg dhe konkretisht: “ANTEA CEMENT” SHA, “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY” SHPK, “ELBASAN CEMENT FACTORY” SHPK, “EUROTECH CEMENT” SHPK dhe “COLACEM ALBANIA” SHPK.
- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 1.01. 2011 deri në 31.12.2012.
- III. Procedurat e hetimit të thelluar dhe përgatitja e raportit të përfundojnë jo më vonë se data 29.03.2013
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()

()

()

()

Zv/Kryetare

Anëtare

Anëtar

Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 254, datë 06. 12. 2012

“Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.12.2012, trajtoi çështjen me:

Objekt: Ankesa e shoqërisë « Sigal Uniqa Group Austria »Sh.A (Sigal) ndaj vendimit 142 dhe 151, datë 29.10.2012 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.; Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999; “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Ankeses se paraqitur nga SIGAL UNIQA GROUP SHA Nr. 653 Prot, datë 14.11.2012;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 204prot, date 03.12. 2012;

VËREN SE :

Shoqëria e sigurimeve SIGAL UNIQA GROUP SHA (Sigal) me shkresën Nr. 653 Prot, datë 14.11.2012 ka depozituar prane Autoritetit të Konkurrencës vendimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Nr. 151 datë 29.10.2012 “Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të

përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti”, duke shfuqizuar kështu dhe Vendimin Nr. 111 datë 28.07.2011.

Sipas shoqërisë Sigal, Autoriteti I Mbikëqyrjes Financiare i ka dërguar një tabelë primë rreziku unike për të gjitha shoqëritë e sigurimit ndërkohë që Sigal Uniqa gjykon se në bazë të nenit 10 të ligjit nr. 10076, datë 21.6.2011, AMF-ja ka të drejtë:

1. Të përcaktojë nivelin e provigjoneve për secilën shoqëri sigurimi sipas treguesve të saj;
2. Miraton rregullat, mënyrën dhe kriteret për përcaktimin e rrezikut për sigurimin e detyrueshëm;

Gjithashtu në këtë shkresë shoqëria Sigal pretendon se AMF-ja nuk mundet, në zbatim të parashikimeve të ligjit, të paracaktojë primin e sigurimit në mënyrë unike për të gjithë tregun, kështu që pas daljes së akteve të miratuara nga AMF-ja në datë 15.11.2012 i gjithë tregu i sigurimeve të detyrueshme do të jetë me të njëjtat prime (çmime) sigurimi.

Nga vlerësimi ligjor rezulton se:

1. Sipas Ligjit nr. 10455, datë 21.7.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në nenin 10, pika 2 përcaktohet se “Shoqëria e sigurimit përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, dhe fillon t’i zbatojë ato, pasi njofton zyrtarisht autoritetin”: për sigurimin e detyrueshëm MTPL e brendshme, për sigurimin e detyrueshëm ndaj palëve të treta për kontratat kufitare dhe për primin e sigurimit të detyrueshëm ndaj palëve të treta për kontratat e kartonit jeshil.
2. Sipas Rregullores “Për caktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit », miratuar me Vendim Bordi nr.110 , datë 28.07.2011, ndryshuar me Vendim Bordi nr. 142, datë 29.10.2012, në nenin 4, “Përcaktimi i nivelit të provigjionit teknik”, përcaktohet se: *“Autoriteti përcakton dhe publikon primin e rrezikut për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorrik brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, mbi bazën e të cilit do të llogaritet provigjoni teknik i primit të pafituar. Provigjoni teknik i primit të pafituar llogaritet për çdo policë sigurimi dhe nuk është më i ulët se pjesa proporcionale e këtij primi të rrezikut, për periudhën e paskaduar të policës së sigurimit”*.
3. Bazuar në rregulloren e mësipërme AMF-ja ka marrë Vendimin Nr. 151 datë 29.10.2012 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, “Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti”. Me anë të këtij vendimi është miratuar primin e sigurimit në mënyrë unike për të gjithë tregun.
4. Miratimi i të njëjtit prim rreziku për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit sjell pasoja për konkurrencën në treg pasi primet janë unike për të gjitha shoqëritë e sigurimeve.
5. Nga vlerësimi ligjor rezulton se në bazë të ligjit aplikimet e shoqërive të sigurimit për primet e rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm, duhet të llogariten më parë nga secila prej shoqërive në mënyrë individuale dhe më pas të miratohen nga AMF-ja në mënyrë individuale për secilën shoqëri që operon në treg.

Si konkluzion, neni 4 i Rregullorjes “Për caktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit », miratuar me Vendim Bordi nr.110 , datë 28.07.2011, ndryshuar me Vendim Bordi nr. 142, datë 29.10.2012, dhe vendimi Nr. 151 date 29.10.2012 te Bordit te Autoritetit te Mbikeqyrjes Financiare, “Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësishë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti”, kufizon konkurrencën në tregun e MTPL-ve. Nga ana tjetër në Ligjin nr. 10455, datë 21.7.2011 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” është synuar nxitja e konkurrencës në këtë treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

T’i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:

1. Revokimin e nenit 4 paragrafi 1, te Rregullores “Për caktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, miratuar me Vendimin e Bordit te AMF nr.110, date 28.07.2011 dhe ndryshuar me vendim bordi nr.142, date 29.10.2012
2. Revokimin e Vendimit Nr. 151, date 29.10.2012 te Bordit te Autoritetit te Mbikeqyrjes Financiare, “Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësishë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti”.
- 3.. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e Vendimit Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe shoqërisë ankimuese.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()

()

()

()

Zv/Kryetare

Anëtare

Anëtar

Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 255, datë 11. 12. 2012

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit (75% të aksioneve) të Eurobank Ergasias S.A nga National Bank of Greece S.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.12.2012, trajtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit (75% të aksioneve) të Eurobank Ergasias S.A nga National Bank of Greece S.A.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 13, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit ” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Natonal Bank of Greece S.A dhe Eurobank Ergasias S.A dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

- 1. Transaksioni dhe përqendrimi**

Transaksioni me objekt përftimin e pjesës prej 75% të kapitalit aksionar me të drejtë vote të Eurobank Ergasias S.A (Eurobank) nga Natonal Bank of Greece S.A (NBG), realizohet me anë të ‘Ofertës Publike Vullnetare nga Banka Kombëtare e Greqisë (*National Bank of Greece-NBG*) për të gjitha aksionet e përbashkëta të regjistruara të Eurobank Ergasias’ të datës 5 Tetor 2012.

Transaksioni realizohet në formën e përftimit të pjesës së 75% të kapitalit aksionar i cili në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (Ligji) është përqendrim, pasi sjell ndryshim të kontrollit në ndërmarrjen target (Eurobank) nëpërmjet përftimit të kontrollit të drejtëpëdrejtë të saj nga NBG.

Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1) në tregun e brendshëm dhe tregun ndërkombëtar.

2. Palët në transaksion

- 1.1. **NBG** është një shoqëri aksionere e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit grek me seli në adresë: 88 Aiolou Street, Athinë, Greqi.
NBG është prezent dhe për pasojë realizon xhiro në Shqipëri me anë të degës së saj **Banka NBG Albania**, e cila ka filluar aktivitetin që prej vitit 1996.
- 1.2. **Eurobank**, një bankë e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit grek, me seli në adresën: 8 Othos Str. 10557, Athinë, Greqi.

Xhiro për vitin 2011

- ☐ Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është XXX miliardë **Lekë**:
 - o **Banka Kombëtare e Greqisë** (NBG): 8 miliardë Euro = XXX miliardë Lekë
 - o **Eurobank** : XXX miliardë Euro = XXX miliardë Lekë
- ☐ Xhiro totale në **tregun e brendshëm** : është XXX miliard **Lekë**:
 - o **Banka Kombëtare e Greqisë**: XXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1, gërma a dhe b e Ligjit.

3. ANALIZA E KONKURRENCËS

3.3. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë

- I). tregu i produktit, dhe
- II). tregu gjeografik.

I. Tregu i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet ofrimi i shërbimeve bankare për individë (retail banking) dhe korporata (corporate banking), me konkretisht:

1. Depozita dhe shërbime për llogaritë (llogari kursimi, llogari rrjedhëse etj)

2. Kreditim (kredi personale, kredi konsumi, overdraft , kredi për binzese etj)
3. Bono thesari

II. Tregu gjeografik:

Pra palët e ushtrojnë aktivitetin në të njëjtin treg produkti por në tregje gjeografike të ndryshme.

Për analizimin e këtij rasti *treg gjeografik* do të konsiderohet tregu kombëtar, pra tregu i brendshëm.

3.4. Struktura e tregut (Tregu bankar ne Shqipëri)

Në tregun shqiptar ushtrojnë veprimtarinë e tyre në total 16 banka të nivelit të dytë, nga të cilat 13 banka janë me kapital privat tërësisht të huaj dhe 3 banka me kapital privat të huaj dhe vendas. Tregu karakterizohet nga ndryshime të shpejta përsa i takon shtrirjes gjeografike dhe ofrimit të produkteve të reja. Tendencat pozitive në zgjerimin e tregut bankar me degë dhe agjensi ka sjellë përmirësimin në mënyrë të dukshme të mbulimit dhe rritjes së cilësisë për produktet ekzistuese dhe atyre të reja.

Referuar të dhënave të Bankës Qëndrore, banka e cila rezulton të ketë mbulimin më të gjërë nëpërmjet degëve dhe agjensive të saj është Raiffeisen Bank me 103 degë, e ndjekur nga Banka Kombëtare Tregtare me 53 degë dhe 4 agjensi dhe Tirana Bank me 52 degë dhe 4 agjensi.

Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë ka 5 degë dhe 22 agjensi brenda vendit të shtrira në këto prefektura : Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë.

Sipas klasifikimit bazuar mbi kriterin e madhësisë së aktiveve, NBG renditet në grupin G2, grupin e bankave të mesme. Sipas të dhënave nga Banka e Shqiperise, Raiffeisen Bank ka përqindjen më të lartë të aktiveve me 28.7%, e ndjekur nga Banka Kombëtare Tregtare dhe Intesa Sanpaolo Bank me respektivisht 17.7% dhe 11.3%. NBG renditet si banka e nëntë me 3.5% të totalit të aktiveve.

3.5. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Pas realizimit të përqendrimit struktura në tregun bankar nuk ndryshon, si rrjedhojë përqendrimi i tregut sipas depozitave, kredisë dhe bonove të thesarit mbetet i njëjtë. Kjo pasi, Eurobank nuk është prezent në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonjë formë tjetër aktiviteti).

Nga transaksioni pritet të realizohen sinergji si rezultat i kombinimit të produkteve, të optimizimit të platformës së shërbimit (retail), prokurimit dhe eliminimit të dublikimit të disa funksioneve qendrore si dhe të krijojnë bazat për forcimin e fitimeve vjetore të NBG-Eurobank dhe forcimit të brendshëm të kapitalit dhe likuiditeteve, të cilat në mënyrë indirekte do të pasqyrohen edhe në tregun e brendshëm.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk sjell efekte në struktura të tregut bankar në territorin e Shqiperise, dhe për rrjedhojë nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Eurobank Ergasias S.A nga National Bank of Greece S.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()
Zv/Kryetare

()
Anëtare

()
Anëtar

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 256, datë 11. 12. 2012

“Për disa rekomandime ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.12.2012, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin i ankesës se ndërmarrjes “IMPERIAL Claims Service - Albania” ndaj rregullores se Byrose Shqiptare e Sigurimeve, nr 129, date 28.07.2012, “Per proceduren e miratimit te korrespondentit ne Shqiperi”.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.
Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me ankesën e ndërmarrjes “IMPERIAL Claims Service - Albania”

VËREN SE :

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja “IMPERIAL Claims Service - Albania”, ka paraqitur për dijeni një ankesë, i cili i drejtohet dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF).
2. Sipas ankuesit, Rregullorja Nr. 129, datë 28.07.2012 “Për procedurën e miratimit të

korrespondentit në Shqipëri” e miratuar nga Asambleja e anëtarëve të BSHS-së kufizon dhe vendos barriera artificiale për operatorët e tjerë që duan të punojnë në tregun e dëmeve të kartonit jeshil (siguracion ndërkombëtar), si dhe me anë të kësaj Rregulloreje, BSHS merr funksionin e entit mbikëqyrës dhe rregullator për funksionimin e këtij nëntregu brenda tregut të sigurimeve, kur organi i vetëm ligjor është AMF-ja.

I. KUADRI LIGJOR RREGULLATOR

3. Referuar Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar “Kartoni jeshil” është certifikata ndërkombëtare e sigurimit, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Kretës, e cila rregullon marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet zyrave kombëtare të vendeve anëtare të sistemit të kartonit jeshil.
4. Referuar nenit 42 të Ligjit nr. 10076, Byroja Shqiptare e Sigurimit është përfaqësuese kombëtare në këshillin e byrove dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e kartonit jeshil. BSHS-ja është person juridik, me seli në Tiranë, e krijuar jo për qëllime fitimi dhe anëtar i saj është çdo sigurues i licencuar, i cili nuk mund të ushtrojë veprimtari sigurimi të detyrueshëm pa qenë anëtar i BSHS-së dhe mbikëqyrret nga AMF-ja, e cila i përcakton me rregullore të veçantë rregullat dhe standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes.
5. Byroja autorizon anëtarin e saj për të lëshuar karton jeshil, pas përmbushjes prej tij të dispozitave ligjore, nënligjore dhe të të gjitha kritereve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve, në përputhje me rregullat e sistemit të kartonit jeshil.
6. Referuar nenit 44 të Ligjit të mësipërm, fondi i garancisë i kartonit jeshil administrohet nga Byroja dhe ka për qëllim garantimin e detyrimeve financiare, që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e kartonit jeshil. Çdo anëtar i Byrosë, i autorizuar për të lëshuar karton jeshil, duhet të depozitojë një garanci bankare pranë një banke të nivelit të dytë në Shqipëri, në favor të Byrosë, në shumën që përcaktohet nga Asambleja e anëtarëve, por jo më të vogël se 200 000 euro. Fondi i garancisë së kartonit jeshil përdoret:
 - α– në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve financiare të një anëtari të Byrosë, përgjegjës për pagesën e dëmshpërblimit, sipas rregullave të sistemit të kartonit jeshil;
 - β– për pagesën e dëmeve të ndodhura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në një vend anëtar të sistemit të kartonit jeshil, në rastin kur dëmi është shkaktuar nga mjeti motorik i regjistruar në Shqipëri, i pajisur me karton jeshil fals, për të cilin Byroja është përgjegjëse, sipas rregullave të sistemit të kartonit jeshil;
 - χ– kur fondi i garancisë mund të preket nga Byroja me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të anëtarëve.
7. Në zbatim të neneve të mësipërme të Ligjit nr. 10076 (42, 44 dhe 46), AMF-ja me Vendimin e Bordit nr. 21, datë 19.03.2010 ka miratuar Rregulloren “Mbi administrimin e fondit të garancisë dhe rregullat e trajtimit të dëmeve të kartonit jeshil”, e cila ka si objekt të përcaktojë rregullat mbi administrimin e fondit të garancisë së kartonit jeshil për të garantuar detyrimet financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e kartonit jeshil dhe kriteret bazë të pajisjes së anëtarëve me certifikatë ndërkombëtare sigurimi, në momentin e aplikimit dhe në vazhdim.

8. Referuar nenit 3 të Rregullores nr. 129 të BSHS, korrespondent mund të jetë:
- α) Një shoqëri sigurimi, që plotëson kriteret ligjore konform Ligjit Nr. 9267 “Për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, anëtare e BSHS-së, me të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë në sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit;
 - β) Një person juridik, i cili ka një marrëveshje fronting me një Shoqëri Sigurimi – anëtare të BSHS-së. Marrëveshja fronting parashikon garantuesin financiar, i cili në rast se korrespondenti e ka të pamundur pagesën e dëmeve në favor të të dëmtuarve konform akteve dhe parashikimeve të legjislacionit shqiptar, si dhe të parashikuara në kontratë, anëtari i BSHS-së që e mbështet këtë korrespondent paguan për llogari të BSHS-së çdo detyrim të korrespondentit.
9. Nëse krahasojmë dy dokumentet, rezulton se me Rregulloren e AMF-së nr. 21, neni 6 janë 3 (tre) grupet e subjekteve që mund të emërohen si korrespondentë, si:
- 1) një shoqëri sigurimi , anëtare e Byrosë Shqiptare të Sigurimit; ose
 - 2) një person juridik i cili ka një marrëveshje fronting me një shoqëri sigurimi – anëtare e BSHS-së, për të trajtuar dëmet për llogari të saj; ose
 - 3) një person juridik, i cili nuk ka një marrëveshje fronting sipas pikës më lart, por është i miratuar paraprakisht nga Asambleja e anëtarëve për të trajtuar dëmet, sipas kriterëve të përcaktuara.

Ndërkohë që Rregullorja e BSHS-së Nr. 129, e ka kufizuar në 2 numrin e subjekteve që mund të emërohen si korrespondentë, si:

- a) Një shoqëri sigurimi, që plotëson kriteret ligjore konform Ligjit nr. 9267 “Për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, anëtare e BSHS-së, me të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë në sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit;
- b) Një person juridik, i cili ka një marrëveshje fronting me një shoqëri sigurimi – anëtare të BSHS-së. Marrëveshja fronting parashikon garantuesin financiar, i cili në rast se korrespondenti e ka të pamundur pagesën e dëmeve në favor të të dëmtuarve, konform akteve dhe parashikimeve të Legjislacionit Shqiptar, si dhe të parashikuara në kontratë, anëtari i BSHS-së që e mbështet këtë korrespondent, paguan për llogari të BSHS-së çdo detyrim të korrespondentit;

Pra, BSHS ka hequr nga lista e subjekteve që mund të emërohen si korrespondentë grupin e subjekteve juridikë pa një marrëveshje fronting, por me miratimin paraprak nga Asambleja e BSHS-së.

10. Autoriteti i Konkurrencës i ka kërkuar AMF të shprehet lidhur me këtë ankesë, si organi mbikëqyrës i BSHS-së dhe i tregut të sigurimeve. AMF-ja sqaron se BSHS-ja është person juridik i krijuar jo për qëllime fitimi dhe referuar Ligjit Nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, ajo është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove dhe bazuar në Rregulloren e Brendshme të Këshillit të Byrove dhe Marrëveshjen Uniforme, është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia e Shqipërisë në sistemin e kartonit jeshil. Në bazë të nenit 4, pika 1 të “Rregullores së brendshme të Byrove”, përcaktimi i kushteve për aprovimin e korrespondentit është kompetencë e BSHS-së.

11. Lidhur me sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës shprehet se heqja e një grupi të subjekteve që mund të emërohen si korrespondentë nga Rregullorja e BSHS-së nr. 129, datë 28.07.2012 “Për procedurën e miratimit të korrespondentit në Shqipëri”, i cili është në Rregulloren e AMF-së nr. 21, datë 19.03.2010 “Mbi administrimin e fondit të garancisë dhe rregullat e trajtimit të dëmeve të kartonit jeshil”, kufizon konkurrencën, pasi kufizon trajtimin e dëmeve të kartonit jeshil vetëm tek shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së, apo tek personat juridikë të cilët kanë një marrëveshje fronting me këto shoqëri sigurimi, duke përjashtuar personat juridikë, të cilët nuk kanë një marrëveshje fronting, por janë miratuar paraprakisht nga Asambleja e Anëtarëve për të trajtuar dëmet, si është dhe rasti i ankuesit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I :

1. Në nenin 3 të Rregullore nr. 129, datë 28.07.2012 “Për procedurën e miratimit të korrespondentit në Shqipëri”, pas pikës (b), të shtohet dhe një pikë me këtë përmbajtje: ***“Një person juridik, i cili nuk ka një marrëveshje fronting sipas pikës më lart, por është i miratuar paraprakisht nga Asambleja e Anëtarëve për të trajtuar dëmet, sipas kritereve të përcaktuara.”***
2. Ky ndryshim të bëhet brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()

Zv/Kryetare

()

Anëtare

()

Anëtar

()

Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 257, datë 13. 12. 2012

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës, ndaj ndërmarrjeve: “Alben 2 Security”, “E-Security”, “Vaso Security”, “Security Vaso”, “Ernisa S”, “Nisa Security”, “Hoxha”, “Korça Security” dhe “Hoxha Security”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.12.2012, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe nenet 12 dhe 12/1 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës

VËREN SE:

Në bazë të ankesës së bërë nga Sh.r.s.f. “Korça Security”, Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 251, datë 20.11.2012 vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korcës. Në zbatim të këtij Vendimi, Sekretariati ka realizuar procedurat e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korcës si më poshtë vijon.

Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), nenit 22 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, nenit 4 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe Vendimit Nr. 251, datë 20.11.2012 të Komisionit të Konkurrencës, me anë të Urdhrit Nr. 120, datë 21.11.2012 ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.

Grupi i punës në zbatim të vendimit të mësipërm të Sekretarit të Përgjithshëm, përgatiti matricën e veprimeve për hetimin e paraprak në tregun e prokurimeve të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korcës, e cila u miratua nga Sekretari i Përgjithshëm.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, në zbatim të neneve 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Grupi i Punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga autoritetet kontraktore në procedurat e prokurimit të cilave kanë marrë pjesë ndërmarrjet që operojnë në tregun përkatës.

Në zbatim të neneve 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 669, datë 21.11.2012 “Autorizim Inspektorësh”, grupi i inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve që operojnë në tregun përkatës. Qëllimi i inspektimeve ishte grumbullimi i provave dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun përkatës.

Nga informacioni i administruar gjatë procedurës së hetimit paraprak, rezulton se ekzistojnë evidenca, në formë elektronike dhe shkresore, të bashkpunimit ndërmjet ndërmarrjeve: “Alben 2 Security”, “E-Security”, “Vaso Security”, “Security Vaso”, “Ernisa S”, “Nisa Security”, “Hoxha”, “Korça Security” dhe “Hoxha Security” për pjesëmarrjen në prokurimet publike, si: zyra, kompiutera dhe salla operative të përbashkëta; informacion i detajuar mbi pjesëmarrjen në prokurime të njëri-tjetrit etj, e cila mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në tregun përkatës.

Nga hetimi paraprak është konstatuar se dokumentet e gjetura gjatë inspektimit si dhe dokumentat e dorëzuara nga Autoriteti Kontraktor “Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë”, mbi ofertat e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik, bazuar edhe në metodologjinë “Për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike”, përmbajnë shenja të ngjashme si: gabime drejtshkimore; formularë të lëshuar në të njëjtën datë dhe numra serial te njepasnjeshem nga kompani sigurimi te njëjta; të njëjtën formulim, formatim në ofertën ekonomike etj. Këto shenja të evidentuara tregojnë që përgatitja e ofertave të paraqitura në procedurat e prokurimit është bërë nga një numër punonjësish të përbashkët, të cilët punojnë ngushtësisht me njëri-tjetër, karakteristikë kjo e marrëveshjeve në oferta.

Ndërmarrjet përdorin skemën e ofertave të mbuluara, duke pranuar për të ofertuar me lart se sa oferta e fituesit të zgjedhur.

Gjithashtu kjo gjë ka rezultuar edhe nga Vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, i datës 17.07.2012 për pushimin e çështjes penale nr. 466 të vitit 2012. Sipas këtij vendimi Prokuroria, për shkak të ngjashmërisë së shkrimeve në të tre formularët e deklarimit të ofertës, ka kryer dhe aktin e ekspertimit grafik me Nr. 149 datë 27.06.2012, nga ka rezultuar se të tre formularët e mësipërm, për të treja shoqëritë pjesëmarrëse në procedurën e tenderimit të datës 26.03.2012, janë shkruar nga i njëjti person. Gjithashtu me anë të akt ekspertimit Nr. 160, datë 09.07.2012, ka rezultuar e provuar se këto formularë, janë firmosur dhe vulosur nga administratorët e shoqërive “Hoxha Security”, “Nisa Security” dhe “Korça Security”

Rrezultatet e hetimit paraparak tregojnë për një bashkëpunim të mundshëm në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike në qytetin e Korçës ndërmjet ndërmarrjeve: “Alben 2 Security”, “E-Security”, “Vaso Security”, “Security Vaso”, “Ernisa S”, “Nisa Security”, “Hoxha”, “Korça Security” dhe “Hoxha Security”, sjellje të cilat mund të bien në kundërshtim me nenin 4, pika 1, germa a), të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (të ndryshuar).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 24, shkronja d) dhe 43, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenet 12 dhe 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës, ndaj ndërmarrjeve: “Alben 2 Security”, “E-Security”, “Vaso Security”, “Security Vaso”, “Ernisa S”, “Nisa Security”, “Hoxha”, “Korça Security” dhe “Hoxha Security”, me objekt ekzistencën ose jo të marrëveshjeve të ndaluar në oferta në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës.
 - II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore Janar 2011- Tetor 2012.
 - III. Hartimi i raportit përfundimtar të hetimit të thelluar të bëhet jo me vone se data 15 Shkurt 2013.
 - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()

Zv/Kryetare

Servete Gruda

()

Anëtare

Koço Broka

()

Anëtar

Iva Zajmi

()

Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 258, datë 21. 12. 2012

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.12.2012, me pjesëmarrjen e Znj. L. Lati (Milo), Znj. R. Konomi, Znj. S. Gruda dhe I. Zajmi, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e propozimit të Sekretariatit për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe Hetimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike, Procedurave dhe Hetimit;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi propozimin për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë me parapagim”;

VËREN SE:

Tregu i telefonisë celulare është një nga tregjet kryesorë që ndikon në zhvillimin e ekonomisë në tërësi. Autoriteti i Konkurrencës për mbikëqyrjen e këtij tregu të rregulluar

ka bashkëpunim në mënyrë të vazhdueshme me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare për të siguruar funksionimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Sipas dokumentit të AKEP "Tregues statistikorë dhe financiarë të tregut të komunikimeve elektronike për vitin 2011", rezulton se në tregun e telefonisë celulare janë gjeneruar gjithsej 39.2 miliardë lekë të ardhura nga 4 operatorët që ofrojnë shërbime të telefonisë celulare. Ky treg karakterizohet nga ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme me pakicë.

Bazuar në informacionet e depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës, në këtë treg kohet e fundit vihen re shenja sjelljeje potencialisht antikonkurruese të një/disa operatoreve, që mund të kenë si qëllim dhe/ose pasojë kufizimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë me parapagesë.
- II. Periudha e hetimit do të jetë nga Janari 2012 deri në Nëntor 2012.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 31. 01.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

()
Zv/Kryetare

Servete Gruda

()
Anëtare

Koço Broka

()
Anëtar

Iva Zajmi

()
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 259, datë 27. 12. 2012

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Emporiki Bank of Greece S.A nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit nga Credit Agricole S.A. tek Alpha Bank S.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Rezana Konomi Zv/Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Iva Zajmi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.12.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Emporiki Bank of Greece S.A nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit nga Credit Agricole S.A tek Alpha Bank S.A.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10, 11, 12, 13, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” (nenet 53-64), dhe neni 73, pika 1 germa dh.; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit ” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”, Rregullores “Për gjokat dhe lehtësimin prej tyre”

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Alpha Bank S.A dhe Emporiki Bank of Greece S.A dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjes për shitjen e aksioneve” të datës 16 Tetor 2012, e lidhur midis palëve Alpha Bank S.A. dhe Credit Agricole S.A. me objekt transferimin e 100% të kapitalit aksionar të Emporiki Bank of Greece S.A. nga Credit Agricole S.A. tek Alpha Bank S.A.

Transaksioni realizohet në formën e përfutimit të kontrollit ekskluziv, i cili në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (Ligji) është përqendrim, sjell ndryshim të kontrollit në ndërmarrjen target (Emporiki Bank of Greece SA.) nëpërmjet përfutimit të kontrollit ekskluziv të saj nga Alpha Bank S.A.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b) të Ligjit është ndryshim kontrolli në formën e përfutimit të kontrollit të vetëm ekskluziv. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit për sa i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

- **Alpha Bank S.A.**, (blerësi) është një shoqëri e themeluar në 1879 dhe që funksionon në bazë të legjislacionit grek me seli në adresën: 40 Stadiou Str, Athinë, Greqi. Ajo është një nga bankat më të mëdha të Greqisë me më shumë se 900 degë. Grupi Alpha Bank është gjithashtu aktiv edhe në tregun ndërkombëtar të bankave me prezencë në Qipro Rumani, Bullgari, Serbi, Ukrainë, Shqipëri, Maqedoni dhe Mbretëri e Bashkuar.

Alpha Bank është prezente dhe për pasojë realizon xhiro në Shqipëri me anë të degës së saj **Alpha Bank – Albania**, e cila ka filluar aktivitetin që prej vitit 1998.

- **Credit Agricole S.A.** (Shitësi) e cila zotëron 100% të aksioneve të Emporiki Bank of Greece SA. Credit Agricole është një nga grupet bankare më të mëdha në Europë, me 11.600 degë në të gjithë botën.¹

Kompania target e këtij përqendrimi është Emporiki Bank of Greece SA, një bankë e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit grek, që prej vitit 1907. Banka është e listuar në Bursën e Athinës dhe që në vitin 2000 ka hyrë në një marrëveshje strategjike bashkëpunimi me grupin Credit Agricole i cili fillimisht bleu 6.7%, duke rritur pjesën e saj të kapitalit aksionar dhe aktualisht zotëron 100% të kapitalit duke e kontrolluar atë ekskluzivisht.

3. Xhiro për vitin 2011

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXX miliard Lekë:
 - o **Alpha Bank S.A.** : XXX miliard Euro = XXX miliard Lekë
 - o **Emporiki Bank of Greece S.A.** : XXX miliard Euro = XXX miliard Lekë

¹ <http://www.credit-agricole.com/en/The-Group/About-Us/Credit-Agricole-a-leader-in-Europe>

- Xhiro totale në tregun e brendshëm : është XXX miliard Lekë:
 - o **Alpha Bank Albania SH.A. : XXXX Lekë**

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 e Ligjit.

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë :

- I) tregu i produktit, dhe
 - II) tregu gjeografik.
- I. **Tregu i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet ofrimi i shërbimeve bankare për individë (retail banking) dhe korporata (corporate banking).

Shërbime bankare për individë dhe korporata (Retail Banking dhe Corporate Banking)

1. Depozita dhe shërbime për llogaritë (llogari kursimi, llogari rrjedhëse etj)
2. Kreditim (kredi personale, kredi konsumi, overdraft , kredi për binzese etj)
3. Bono thesari

II. **Tregu gjeografik:**

Pra palët e ushtrojnë aktivitetin në të njëjtin treg produkti, por në tregje gjeografike të ndryshme.

Për analizimin e këtij rasti *treg gjeografik* do të konsiderohet tregu kombëtar pra tregu i brendshëm.

Struktura e tregut (Tregu bankar në Shqipëri)

Në tregun shqiptar ushtrojnë veprimtarinë e tyre në total 16 banka të nivelit të dytë, me kapital të huaj kryesisht me origjinë nga Bashkimi Europian. Tregu karakterizohet nga ndryshime të shpejta përsa i takon shtrirjes gjeografike dhe ofrimit të produkteve të reja. Tendencat pozitive në zgjerimin e tregut bankar me degë dhe agjenci ka sjellë përmirësimin në mënyrë të dukshme të mbulimit dhe rritjes së cilësisë për produktet ekzistuese dhe atyre të reja.

Konkurrentët në tregun kombëtar

Alpha Bank Albania SH.A operon me 46 degë në të gjithë vendin dhe rreth 58 ATM.

Emporiki Bank of Grece S.A. nuk është më prezente në tregun bankar shqiptar, pasi dega e kësaj banke në Shqipëri kontrollonhet 100 % nga grupi Credit Agricole S.A².

2 Sipas ekstraktit të QKR, Aksioner i vetëm i kësaj banke ka qenë Banka Tregtare e Greqisë SHA. Kjo Bankë ka kaluar në kontrollin e grupit Credit Agricole. Ky transaksion është miratuar nga Autoriteti i Konkurrencës me anë të vendimit Nr.40 Datë 25.09.2006. Në bazë të ekstraktit të QKR, në shtator të vitit 2012 është ndërruar aksioneri i kësaj Banke ku 100% të aksioneve i kanë kaluar IUB Holding që është pjesë e grupit Credit Agricole.

Pozicioni në treg pas përqendrimit

Përqendrimi nuk sjell ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri pasi, Emporiki Bank of Greece S.A nuk është prezent në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonjë formë tjetër aktiviteti). Transaksioni nuk përfshin Credit Agricole Shqipëri Sh.a., e cila aktualisht zotërohet dhe do të mbetet në zotërimin direkt të Credit Agricole S.A³

Përqendrimi përfaqëson një hap të rëndësishëm në ristrukturimin e sektorit bankar grek dhe siguron përfitime financiare dhe strategjike të rëndësishme për Alpha Bank S.A. Ky transaksion do të mundësojë krijimin e një propozimi vlerash bindëse për shërbimet bankare për korporatat, duke bashkuar dy prej institucioneve më të vjetra financiare në vend, me një fokus të qartë në segmentin e korporatave.

Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

1. Përqendrimi realizohet në formën e përfimit të kontrollit të vetëm ekskluziv të Emporiki Bank of Greece S.A nga Alpha Bank S.A, i cili në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit është përqendrim që sjell ndryshim të kontrollit.
2. Përqendrimi nuk sjell ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri pasi, Emporiki Bank of Greece S.A. nuk është prezent në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonjë formë tjetër aktiviteti).
3. Pas realizimit të përqendrimit pjesët e tregut të Alpha Bank Albania SH.A nuk ndryshojnë, si rrjedhojë përqendrimi i tregut sipas depozitave, kredisë dhe bonove të thesarit mbetet i njëjtë.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shkakton ndryshim të strukturave të tregut, pra shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese për shkak të përqendrimit ndërmjet shoqërive Alpha Bank S.A dhe Credit Agricole S.A.

Njoftimi i transaksionit

Njoftimi i përqendrimit me objekt përfitim të kontrollit të Emporiki Bank of Greece S.A. nga Alpha Bank S.A është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 700 prot. të datës 13 Dhjetor 2012. Ky njoftim është bërë jashtë afatit ligjor të parashikuar në nenin 12, pika 2 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar. Një sjellje e tillë përbën shkelje të lehtë të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), neni 73 pika 1, germa dh) “Masa e gjobës për shkeljet e lehta”.

Ky njoftim, sipas palës njoftuese është kryer pas mbarimit të afatit të parashikuar në nenin 12 të Ligjit. Sipas nenin 12 të kontratës për blerjen e aksioneve parashikohet se ‘Kontrata mund të zgjidhet dhe nuk është detyruese për palët deri sa Komisioni i Bashkimit Europian të njoftojë se transaksioni nuk përbën shkelje të rregulloreve mbi Ndihamën Shtetërore ose kushteve të parashikuara nga neni 10.6.10 i Kontratës. Ky miratim i është njoftuar palëve me datë 23 Nëntor 2012. Për këtë arsye, përpara se palët të vijonin me përmbushjen e detyrimeve kontraktuale një ndër të cilat ishte siguri i autorizimit nga Autoritetet përkatëse të Konkurrencës, kanë pritur njoftimin e Komisionit të Bashkimit Europian, në mungesë të të cilit kontrata do të zgjidhej.

3 Me anë të IUB Holding.

Ky përqendrim është realizuar për shkak të situatës së vështirësisë financiare (prag falimentimi) ku ndodhet ndërmarrja target Emporiki Bank of Grece SA. Përqendrimi nuk do të ketë ndikime në konkurrencën në Shqipëri duke pasur parasysh që transaskioni nuk përfshi Bankën Credit Agricole Shqipëri e cila aktualisht zotërohet dhe do të mbetet në zotërim direkt të grupit të shoqërive CASA (IUB Holding).

Rregullorja e AK “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre” parashikon në nenin 12 të saj mundësinë e vendosjes së një gjobe simbolike.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me shumice votash

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimi i kontrollit të vetëm të Emporiki Bank of Greece S.A. nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit nga Credit Agricole S.A tek Alpha Bank S.A.
2. Të vendosë masën e gjobës prej 100 lekë ndaj njoftuesit të transaksionit.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Rezana Konomi

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

()

()

()

()

Zv/Kryetare

Anëtare

Anëtar

Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E

MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr 259, datë 27.12.2012 ” **Mbi autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Emporiki Bank of Greece S.A nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit nga Credit Agricole S.A. tek Alpha Bank S.A.**”, kam mbajtur qëndrimin kundër, me arsyetimin e mëposhtëm :

1- Palanjoftuese Alpha Bank S.A. i ka plotësuar detyrimet e veta nga ana e saj, si nëpërmjet dokumentacionit të drejtpërdrejtë të vënë në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës (si Marrëveshja e blerjes së aksioneve, bilanci e saj, bilanci dhe Statutin e Banka Alpha Albania Sh.a., ndërmarrjes target Emporiki Bank Credit Agricole Group, Marrëveshjen e blerjes së aksioneve të kësaj të fundit me Credit Agricole S.A.(megjithse e pjeshme, por e pranueshme për përjashtimin e informacionit që nuk ka të bëjë me përqëndrimin etj) ashtu edhe nëpërmjet prokurës ndaj avokatisë KALO & ASSOCIATES, ku e autorizon atë :

-“Të përgatisë dhe depozitojë pranë Autoriteti të Konkurrencës në Shqipëri, me adresë Rruga “Sami Frashëri “, Nr 4, Kati IV, Tiranë, Shqipëri, për llogari të Alpha Bank formularin e njoftimit të miratuar nga Autoriteti i Konkurrencës në Shqipëri dhe **çdo njoftim tjetër paraprak, në qoftë se do të jetë e nevojshme në lidhje me Bashkimit;**

-Të marrë pjesë për llogari të palëve të Bashkimit në takime dhe seanca dëgjimore me Autoritetin e Konkurrencës në Shqipëri, të nënshkruajë çdo dokument tjetër dhe të ndërmarrë çdo veprim tjetër të lidhur me njoftimin e Bashkimit”.

Lidhur sa më sipër, kam shqyrtuar e vlerësuar, dosjen përkatse, dokumentacionin e drejtpërdrejtë vënë, në dispozicion, nga Alpha Bank S.A. dhe Credit Agricol. Ndërkohe jam njohur më parë edhe me njoftimin publik në Wikipedia lidhur me ndërmarrjen target, të këtij transaksioni sipas të cilit:”The Emporiki Bank is a Greek bank...It also has subsidiaries in Albania, Romania and Bulgaria, and branch in London that also manages a financing subsidiary...In August, 2006, the French Bank Credit Agricole, acquired 67 % of its capital and controlled Emporiki. However, in October 2012, Credit Agricole agreed to sell Emporiki to Alpha Bank for € 1(equivalent to \$ 1.31 at the time of purchase) in order to depart from its exposure to Greek economy...**In October 2012, Emporiki Bank was sold by Agricole to Alpha Bank € 1**”.

Pra në thelb ka një “përqëndrim” të ndodhur në Greqi me një çmim blerje vetëm prej € 1.

Në përputheje me kërkesën e Nenit 13, pika 2 të Ligjit Nr 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës, (ndryshuar), sipas të cilit “Komisioni nuk ndalon përqëndrimet, kur njëra nga ndërmarrjet pjesëmarrëse rrezikon seriozisht të falimentojë dhe nuk ka mundësi tjetër më pak antikonkurruese se realizimi i përqëndrimit në se:a) ndërmarrja ndodhet në një situatë të tillë që, pa përqëndrim, duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt;...” kam deklaruar se:

”**unë jam për autorizimin e këtij përqëndrimi**, për autorizimin e Marrëveshjes së blerjes së aksioneve, nga ana e Alpha Bank S.A ” . Por kjo nuk përjashton por presupozon analizën dhe shqyrtimin e plotë këtij përqëndrimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës, për efektet ndaj tregut bankar në përgjithësi, dhe degëve bankare të lidhura me të në Shqipëri, shqyrtim që mungon.

Pra në thelb, në vetvete kam qënë dhe jam plotësisht dakort edhe me përmbajtjen e pikës 1 të depozitimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës sipas të cilit” 1.Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetë të Emporiki Bank of Greece S.A, nëpërmjet transferimit të 100 % të aksioneve të kësaj të fundit nga Credit

Agricole S.A tek Alpha Bank S.A.” dhe **jam angazhuar që ky proces të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur, pa krijuar asnjë pengesë dhe vonesë artificiale administrative**, por pa neglizhuar detyrimet ligjore të Autoriteti të Konkurrencës, ndaj Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës. Por ky proces duhet realizuar në kohën e duhur.

Në se nga ana e Alpha Bank S.A, janë plotësuar në tërësi detyrimet ligjore për të dhënë informacionin e nevojshëm nuk mund të thuhet e njëta gjë, për Credit Agricol S.A (CASA).

2- Komisioni i Konkurrencës me Vendim Nr 40, datë 25.09.2006 “Për Përqëndrimin e Realizuar nëpërmjet blerjes 100% të aksioneve në Emporiki Bank (për pjesën prej 52.55 % të 1300 aksinerëve) nga shoqëria Credit Agricole S.A.” ka autorizuar përqëndrimin me përthithje të Emporiki Bank nga Credit Agricole S.A.(me procesin e mësipërm Credit Agricol S.A e shet atë në vitin 2012 vetëm me € 1, kur e ka blerë x milion Euro). Gjatë procesit të autorizimit të këtij përqëndrimi të ndodhur në Greqi, midis Emporiki Bank dhe Credit Agricole S.A, nga palët në transaksionin dhe nga avokati, që ka facilitur procesin e përqëndrimit, është vënë në dispozicion të Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, një informacion i mjaftueshëm për gjykim dhe vlerësim, si për dy palët në transaksion, **por dhe për ndërmarrjen e prekur në Shqipëri, Emporiki Bank Albania Sh.a.**, duke sqaruar detajet e nevojshme për pronësinë e kësaj dege të Emporiki Bank Greqi, para dhe pas transaksionit. Po kështu ishte vënë në dispozicion bilanci i Emporiki Bank Albania Sh.a.

Komisioni i Konkurrencës kishte në vitin 2006, pra gjithë informacionin e nevojshëm, për shqyrtimin e përqëndrimit, kalimin e paketës së kontrollit të aksioneve të Emporiki Bank në Greqi tek Credit Agricole S.A, dhe implikimet e saj në Emporiki Bank Albania Sh.a. në tregun përkatës të konkurrencës në Shqipëri.

Gjatë realizimit të procesit të përqëndrimit në vitin 2006, është për t’u evidentuar gjithashtu dhe një letër e Kryetares të Komisionit të Konkurrencës Prof.Asoc.Dr.Lindita Milo drejtuar znj Marlina Panajoti, Përfaqësuese Ligjore e Bankës Credit Agricole me nr Prot 421, datë 14.08.2006, me lëndë: “Për Përqëndrimin e Realizuar Nëpërmjet Blerjes së 71.9 % të Aksioneve të Emporiki Bank nga Banka Credit Agricole S.A.” Në këtë letër (të cilën nuk e gjykoj se është e nevojshme të citohet në mënyrë të plotë) nënvizohet sa më poshtë: a) “duke qënë se Emporiki Bank ka një degë në Shqipëri, në bazë të ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003, neni 10, pika b, ky transaksion konsiderohet përqëndrim dhe duke qënë se xhironja vjetore e Emporiki Bank Dega Shqipëri, tejkalon kufirin e parashikuar në nenin 12-të të këtij ligji, ky përqëndrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës për të marrë autorizimin”.

Pra qëndrimi i Komisionit të shprehur nëpërmjet letrës së Kryetares së Komisionit të Konkurrencës ishte dhe është i qartë, shqyrtimi i përqëndrimeve jashtë Shqiperisë, analizohet në funksion të efekteve që ka e mund të ketë në tregun shqiptar.

Por ndryshe nga sa më sipër, kjo praktikë e zakonshme për raste të tilla, nuk është mbajtur aspak parasysh dhe nuk është reflektuar gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit nga ana e punonjësve të sektorit të përqëndrimit në Sekretariatit e Autoritetit të Konkurrencës, duke mos siguruar as informacionin e domosdoshëm.

3- Në mbledhjen e Komisionit të Konkurrencës, të datës 24.12.2012 kur filloi shqyrtimi i çështjes të përqëndrimit në fjalë, ngrita problemin se informacioni i siguruar në dosje apo në draft vendimin e përgatitur nuk ishte i qartë. Kjo për faktin se materiali i përgatitur në dosjen përkatëse nga sektori i përqëndrimit dhe Sekretariati, prezantuar Komisionit të Konkurrencës, nga ana e grupit të punës nuk ishte një vlerësim dhe shqyrtim të plotë të dokumentacionit që kërkohet në të tilla raste, të realizuar qoftë dhe në rastin parardhës të tij në vitin 2006. Në fakt kishte vetëm një **copy paste** rutinë të

informacioni të prezantuar nga përfaqësuesi ligjor i palëve në transaksion, në formularin e thjeshtuar, nga punonjësit e sektorit të përqëndrimit dhe Sekretariatit. Por ndërkohë, **plotësimi i Formularit nga ana e përfaqësuesit ligjor të autorizuar, ishte dhe është i pasaktë, me gabime elementare dhe i paplotë, për të shqyrtuar rastin në fjalë dhe sidomos për efektet e këtij përqëndrimi në tregun përkatës në Shqipëri e sidomos për “Banka Credit Agricole Shqipëri SHA.”**

Dhe më konkretisht: Si në Formularin e plotësuar nga ana e përfaqësuesit ligjor, materialet e përgatitura nga sektori i përqëndrimit ashtu dhe në draft vendimin bashkshoqërues të prezantuar në Komisionin e Konkurrencës, palët në transaksion paraqiten si më poshtë:

“2. Palët në transaksion

□ **Alpha Bank**, është një shoqëri e themeluar në 1879 dhe që funksionon në bazë të legjislacionit grek me seli në adresën: 40 Stadiou Str, Athinë, Greqi. Ajo është një nga bankat më të mëdha të Greqisë me më shumë se 900 degë. Grupi Alpha Bank është gjithashtu aktiv edhe në tregun ndërkombëtar të bankave me prezencë në Qipro Rumani, Bullgari, Serbi, Ukrainë, Shqipëri, Maqedoni dhe Mbretëri e Bashkuar.

Alpha Bank është prezente dhe për pasojë realizon xhiro në Shqipëri me anë të degës së saj **Alpha Bank – Albania** e cila ka filluar aktivitetin që prej vitit 1998.

□ **Emporiki Bank of Greece**, një bankë e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit grek, që prej vitit 1907. Banka është e listuar në Bursën e Athinës dhe që në vitin 2000 ka hyrë në një marrëveshje startegjike bashëpunimi me grupin bankar ndërkombëtar Credit Agricole i cili fillimisht bleu 6.7% të kapitalit aksionar dhe aktualisht zotëron 100% të kapitalit duke e kontorlluar atë eksuzivisht.”

Kjo ndodh në një kohë kur nëse shihet drejtpërdrejt, **Marrëveshja e blerjes së aksioneve**, e cila pjesërisht ndodhet në dosje, shprehet qartë se kjo marrëveshje është midis palëve:

(1) CREDIT Agricole S.A...shoqëri aksionare e së drejtës franceze,... “CASA” dhe

(2) ALPHA BANK A.E, një shoqëri aksionare (anonymosetairea) e themeluar sipas legjislacionit grek, me seli në 40 Stadiou Stree, GR-102 52 Athinë; ndërsa Emporiki Bank of Greece është ndërmarrja target në këtë Marrëveshje

Kjo pasakësi që e ka burimin tek Formulari i mbushur nga avokati i autorizuar dhe i pranuar si i mirëqënë nga sektori i përqëndrimit dhe Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, **për gjykimin dhe vlerësimin tim si Komisioner i Konkurrencës është i papranueshëm dhe duhet riparuar, nga autorët e saj, duke ndryshuar Formularin e plotësuar nga ana e përfaqësuesit ligjor, para se të merret vendimarrja e Komisionit të Konkurrencës.**

Përveç kësaj, dokumentacioni i prezantuar nga përfaqësuesi ligjor i palëve në transaksion, **është i paplotë**, qoftë krahasuar me rastin paraardhës 2006 ashtu dhe për një informacion që unë e konsideroj të nevojshëm dhe të domosdoshëm për të dhënë gjykimin dhe vlerësimin tim mbi efektet e këtij transaksioni në ekonomine shqiptare, sektorin bankar shqiptar, dhe **degën e bankës ose ish degën e bankës Emporiki Bank Albania Sh.a.** sot **Banka Credit Agricole Shqipëri SHA**. Kujtoj se bëhet fjalë që ish banka e saj mëmë në Greqi, me paketë kontrolluese të zotëruar nga Credit Agrikol, ka patur probleme të mëdha financiare, në kushtet e krizës së madhe ekonomike, financiare, bankare greke. Megjithatë në dosjen e përgatitur nga Sekretariati i Konkurrencës, paraqitur Komisionit të Konkurrencës, mungon midis të tjerash bilanci përkatës i Emporiki Bank Albania Sh.a.(ndryshuar emri), bilanci i cili ka qënë në vitin 2006, dhe është kërkesë e çdo

shqyrtimi përqëndrimi, për të gjykuar dhe vlerësuar efektet e përqëndrimeve që ndodhin jashtë Shqipërisë , në Shqipëri.

Po kështu nuk është dhënë informacioni i nevojshëm mbi pronësinë aktuale i aksioneve Emporiki Bank Albania Sh.a (ndryshuar emri). Në Marrëveshjen e blerjes së aksioneve midis ALPHA BANK A.E, dhe CREDIT Agricole S.A. pika F jepet informacioni se “Midis 29 qershorit dhe 3 shtatorit 2012, CASA përvetësoi nga Emporiki të gjitha aksionet e zotëruara drejtpërdrejt ose tërthorazi nga Emporiki në Emporiki Bulgaria, Emporiki Romania dhe Emporiki Albania. Kopje të kontratave përkatse të blerjes së aksioneve i bashkëngjiten kësaj Kontrate si Shtojca F”.

Por në fakt Shtojca F, nuk i është bërë prezent Komisionit të Konkurrencës- ose mungon në dosje.

Ndërkohë, gjendja financiare Alpha Bank S.A. dhe deges së saj në Shqipëri, është në një situatë të tillë që kërkon shqyrtim dhe vlerësim objektiv mbi efektet e tij në Shqipëri, analizw dhe shqyrtim i cili mungon. Në këto kushte, **pa këto informacione të nevojshme unë si Komisioner e kam të vështirë dhe të pamundur të jap një vlerësimin objektiv dhe të plotë, a) mbi sjelljen e palës Credit Agricol, mbi detyrimet që ka ajo në bazë të Ligjit Shqiptar për Mbrojtjen e Konkurrencës, për të njoftuar mbi ndryshimin e aksionereve të Emporiki Albania, dhe b) të efekteve që kanë përqëndrimi i njoftuar dhe transaksionet e mësipërme mbi tregun bankar në Shqipëri dhe sidomos mbi degët Banka Credit Agricole Shqipëri SHA, apo dhe Alpha Bank-Albania (kjo e fundit kryesisht për shkak të mungesës së analizës nga sektori i përqëndrimit dhe Sekretariati i Autoriteti të Konkurrencës).**

Unë nuk mund të pranoj apriori, pretendimin e përfaqësuesit ligjor të palëve, të prezantuar dhe nga punonjësit e sektorit të përqëndrimit se “ Emporiki Bank of Greece S.A nuk është më prezente në tregun bankar shqiptar, pasi dega e kësaj banke në Shqipëri kontrollohet 100 % nga grupi Credit Agricole S.A. dhe që nga viti 2012 në tregun shqiptar njihet si Credit Agricole Shqipëri Sh.A Për këto arsye, përqëndrimi nuk do të ketë ndikime në konkurrencën në Shqipëri. “ , apo vetëm ajo që thuhet në vendimin e Komisionit të Konkurrencës se “Transaksioni nuk përfshin Agricole Shqiperi Sh.a., e cila aktualisht zotërohet dhe do të mbetet në zotërim direkt të Credit Agricol S.A.-me anë të IUB Holding”

Personalisht gjykoj se Komisioni i Konkurrencës duhet të sigurojë informacionin e nevojshëm mbi bazën dhe aq se e lejon dhe autorizon Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të japë vlerësimin objektiv, të mbështetur në prova dhe fakte, për gjithë transaksionet që kanë ndikuar në pronësinë e aksioneve në **Emporiki Bank Albania Sh.a. sot Banka Credit Agricole Shqipëri SHA.** për veprimet ose mosveprimet e Credit Agricol në përputhje me Ligjin Për Mbrojtjen e Konkurrencës në Shqipëri.

Unë nuk mund të shprehem në kushtet e një informacioni të pasaktë, të gabuar dhe të paplotë nga ana e përfaqësuesit ligjor që ka përfaqësuar palët në transaksion, dhe i u kërkoj kolegeve komisionere, të sigurohet fillimisht ky informacion i saktë dhe minimumi i domosdoshëm i këtij informacioni sidomos mbi efektet e mundshme të këtij njoftimi mbi ekonomine shqiptare, para se të merret vendimi në fjalë.

Ndërkohë në kushtet kur Njoftimi për përqëndrimin e ndodhur në Greqi, Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës është njoftuar më 13.12.2012, dhe hapësira kohore e zakonshme ligjore, për shqyrtimin e një përqëndrimi, pas njoftimit të plotë të tij, është dy muaj, nuk ka asnjë arsye për nxitim, pa analizw duke mos respektuar kërkesat dhe objektivat e Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Për sa më sipër dhashë Votën time Kundra.

Ndërkohë në kushtet kur në sistemin bankar që operon në Shqipëri vihen re nga njëra anë praktika e rënies së kredisë së re si për biznesin dhe individët, krahasuar me periudhën parardhëse, në kushtet e rritjes së fitimit të tyre, kur edhe sipas deklarimeve të Guvernatorit të Bankës Qëndrore në operimin e bankave ose degeve të bankave të huaja janë ndjerë efektet e sjelljes së bankave mëmë, dhe shtërngesa e tyre në kreditimin e biznesit dhe individëve në Shqipëri, dhe në publik janë rritur shqetësimet e specialistëve për mungesa të konkurrencës efektive në sistemin bankar, unë gjykoj se Komisioni i Konkurrencës e ka detyrimin ligjor të bëjë një analizë të plotë vlerësim objektiv mbi efektet e **përqëndrimit dhe transaksioneve të tjera** si dhe e transaksioneve të mësipërme që përfshihen në njoftim, mbi konkurrencën në tregun bankar në Shqipëri dhe ndaj Banka Credit Agricole Shqipëri SHA dhe **Alpha Bank -Albania**, gjatë shëyrtimit të këtij njoftimi për përqëndrim, vetëm duke u mbështetur në prova fakte dhe informacione të sakta dhe të plota.

4- Mbështetur sa më sipër, në kushtet e mospërkrahimit dhe saktësisht të informacioneve të mësipërme, unë dhashë votën kundër, vendimit të Komisionit të Konkurrencës. Për më tepër kur kjo praktikë nuk rezulton e vetme dhe e izoluar, distancohem në të njëjtën kohë edhe nga praktika të tjera të veprimit dhe mosveprimit të Komisionit të Konkurrencës, të ngjashme me sa më sipër.

Në këtë rrafsh e linjë distancohem dhe nga mosveprimet e Komisionit të Konkurrencës në funksion të mbrojtjes së konkurrencës në tregje të tjera si psh ai i energjisë elektrike. Në email-in e Shtatorit (datës 17.9.2012), drejtuar kolegeve Komisionere kam tërhequr vëmendjen se në këtë treg, ka çmim të ndryshëm blerje, ndaj HEC-eve të KESH, atij të Lanabregasit, Bistricës, Ulzës, Shkopetit, Importit, Hidrocentraleve të vjetër e të rinj. Siç dihet në këtë treg po bëhen shumë investime dhe natyrshëm cdo investitor do të dije sa është çmimi konkurrues i tregut? Në rast të kundërt investimet mund t'i shkojnë dëm. Cili është kriteri për përcaktimin e çmimit në këtë treg? A zbatohet e njëjta metodologji? Vendime dhe draft vendimet të ndryshme për Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike, nuk kanë ardhur dhe nuk vijnë në Autoritetin e Konkurrencës, megjithëse nenet 69-70-të parashikojnë këtë proces.

“Në këto kushte, jam shprehur në email, zor se mund të bëhet fjalë për konkurrencë dhe zbatim të Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” në këtë treg. Të paktën ky është mendimi dhe gjykimi Im. Sugjeroj që kjo situatë të trajtohet në një mbledhje të posaçme të Komisionit të Konkurrencës, me synim rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive dhe në këtë treg”

Megjithëse përgjigja nga ana Kryetares së Komisionit znj Lati ishte, “Ne lidhje me diskutimin në Komision të shqetësimeve në tregun e energjisë do të njoftoheni në kohë”, dhe se rregullorja e funksionimit parashikon rastet kur mund të realizohen mbledhje të Komisionit të thirrura qoftë edhe nga një Komisioner ky shqyrtim dhe kjo mbledhje nuk është zhvilluar ende.

Për sa më sipër jap votën time kundër.

Komisioner

Koço Broka

